



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

ANALIZA VJETORE 2021





PËRMBAJTJA

SHKURTIME	6
PËRKUFIZIME	7
1. HYRJE	8
1.1 ARRITJET KRYESORE GJATË VITIT 2021	8
2. TË DHËNA STATISTIKORE MBI SISTEMIN E PROKURIMIT PUBLIK NË SHQIPËRI	10
2.1 STATISTIKA NË LIDHJE ME REGJISTRAT E PARASHIKIMEVE TË KRIJUARA NË SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK PËR VITIN 2021	11
2.2 STATISTIKA NË LIDHJE ME NUMRIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK TË PUBLIKUARA GJATË VITIT 2021 NË SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK	14
2.3 STATISTIKA PËR PROCEDURAT KONKURRUESE TË PROKURIMIT, TË ZHVILLUARA NË SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK	16
2.3.1 STATISTIKA SIPAS TIPIT TË KONTRATËS	17
2.3.2 STATISTIKA SIPAS LLOJIT TË PROCEDURAVE	18
2.3.3 STATISTIKA PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT TË PUBLIKUARA DHE TË VAZHDUARA GJATË VITIT 2021, SIPAS 3 MUJORËVE	21
2.3.4 STATISTIKA MBI NUMRIN E NJOFTIMEVE TË KONTRATAVE PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT TË PUBLIKUARA GJATË VITIT 2021, KRAHASUAR ME VITIN 2020.	22
2.3.5 STATISTIKA SIPAS NJOFTIMEVE TË FITUESIT	27
2.3.6 STATISTIKA PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA	35
2.3.7 STATISTIKA MBI PËRQINDJEN E KURSYES NGA PROCEDURAT E KRYERA NË SISTEMIN ELEKTRONIK	41
2.3.8 STATISTIKA MBI NUMRIN E ANULLIMEVE TË PROCEDURAVE MBI KUFIRIN MONETAR PËR PROKURIMET ME VLERË TË VOGËL GJATË VITIT 2021	42
2.4 TË DHËNA MBI PROCEDURAT E PROKURIMIT ME NEGOCIM PA SHPALLJE PARAPRAKE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS	45
2.5 TË DHËNA MBI PROCEDURAT E PROKURIMIT TE KRYERA GJATE VITIT 2021 NË KUADËR TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR SHKAK TË TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019	49
2.6 MARRËVESHJET KUADËR	51
2.7 PROCEDURAT E PROKURIMIT ME VLERË TË VOGËL	55
2.8 STATISTIKA NË LIDHJE ME PROCEDURAT E KRIJUARA NË SISTEMIN ELEKTRONIK	57
2.9 SISTEMI DINAMIK BLERJE BILETA TRANSPORTI AJROR NDËRKOMBËTAR	59
2.10 STATISTIKA NË LIDHJE ME AUTORITETET KONTRAKTORE QË KANË KRIJUAR PROCEDURA NË SISTEMIN ELEKTRONIK DHE OPERATORËT EKONOMIKË FITUES	60
2.11 STATISTIKA NË LIDHJE ME OFERTAT E KRIJUARA NË SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK PËR VITIN 2021	63
2.11.1 TË DHËNA MBI NUMRIN MESATAR TË OFERTAVE TË DORËZUARA	63
2.11.2 TË DHËNA MBI PROCEDURAT E PROKURIMIT ME NJË OFERTË TË DORËZUAR	67
2.11 STATISTIKA NË LIDHJE ME NUMRIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES ME KONCESION/PPP GJATË VITIT 2021	68
2.12 STATISTIKA PËR PROKURIMET NË FUSHËN E MBROJTJES DHE SIGURISË GJATË VITIT 2021	69
2.12.1 STATISTIKA NË LIDHJE ME PROCEDURAT E ANKANDIT PUBLIK TË ZHVILLUARA GJATË VITIT 2021	69



3.	INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2021	71
3.1	AKTET E MIRATUARA	71
3.2	DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT	74
3.2.1	DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR PROKURIMET PUBLIKE	74
3.2.2	DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR PROKURIMET NË FUSHËN E MBROJTJES DHE SIGURISË	75
3.3	UDHËZIME, REKOMANDIME DHE NJOFTIME TË APP	75
4.	VEPRIMTARIA KËSHILLUESE DHE ASISTUESE E APP	78
4.1	VEPRIMTARIA ASISTUESE PËR AUTORITETET KONTRAKTORE	78
4.2	PRAKTIKAT E SHQYRTUARA PËR DHËNIE MENDIMESH, KËSHILLA APO UDHËZIMESH	84
5.	PËRJASHTIMI I OPERATORËVE EKONOMIKË	87
5.1	VENDIME PËR PËRJASHTIMIN E OPERATORËVE EKONOMIKË	88
5.2	VENDIME PËR MOSPËRJASHTIMIN E OPERATORËVE EKONOMIKË	89
5.3	PEZULLIMI I PROCEDIMEVE ADMINISTRATIVE	90
6.	TREGUES TË VEPRIMTARISË SË VERIFIKIMIT TË PROCEDURAVE	92
6.1	VERIFIKIMI I ZBATIMIT TË LIGJSHMËRISË	92
6.2	SHQYRTIMI I RAPORTEVE TË ORGANEVE AUDITUESE/VERIFIKIM I INDICIEVE NGA RAPORTET AUDITUESE	96
6.3	GJETJET DHE PROBLEMATIKAT E EVIDENTUARA GJATË PROCESIT TË VERIFIKIMIT	97
6.4	MASAT ADMINISTRATIVE DHE RAPORTIMI	101
6.4.1	MASAT ADMINISTRATIVE	101
6.4.2	RAPORTIMI I MASAVE	103
7.	PUBLIKIMI I VENDIMMARRJES	104
8.	PËRFAQËSIMI I APP NË PROCESET GJYQËSORE	105
9.	MONITORIMI I ZBATIMIT TË KONTRATAVE	109
9.1	TË DHËNA MBI ZBATIMIN E KONTRATAVE	109
10.	OBJEKTIVAT STRATEGJIKË, ZBATIMI DHE MONITORIMI I TYRE	115
10.1	MONITORIMI I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PROKURIMIN PUBLIK 2020-2023	115
10.2	STRATEGJITË NDËRSEKTORIALE	116
11.	INTEGRIMI EUROPIAN DHE BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E TJERA VENDASE DHE TË HUAJA	119
11.1	INTEGRIMI EUROPIAN	119
11.2	BASHKËPUNIMI I APP ME INSTITUCIONE TË HUAJA	119
11.3	BASHKËPUNIMI I APP ME INSTITUCIONE TË TJERA NË SHQIPËRI	120

12.	TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE DHE PUBLIKIMIN	123
12.1	VEPRIMTARIA E PUBLIKIMIT	123
12.1.1	PUBLIKIMI I NJOFTIME NË SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK	123
12.1.2	PUBLIKIMI I NJOFTIME PËR ANKANDE PUBLIKE NË BULETININ E NJOFTIMEVE PUBLIKE	124
12.1.3	NJOFTIME PËR KONCESIONE/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT DHE TË NJOFTIME TË TJERA	124
12.1.4	PUBLIKIMI I ELEMENTËVE TË REGJISTRIT NË SISTEM	124
12.1.5	PRAKTIKAT E SHQYRTUARA	124
12.2	ADMINISTRIMI I TË DHËNAVE NË SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK	125
12.2.1	OBJEKTIVAT E LIDHURA ME ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE DHE STATISTIKAVE	125
12.2.2	PRAKTIKAT E SHQYRTUARA NË KUADËR TË ADMINISTRIMIT TË TË DHËNAVE DHE STATISTIKAVE.	128
12.2.3	KRIJIMI I PËRDORUESVE TË RINJ PËR VITIN 2021	128
12.2.4	STATISTIKA TË TJERA NË LIDHJE ME PËRDORIMIN E SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK	131
12.2.4.1	AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS KLIKIMEVE, SHIKIMEVE DHE VIZITORËVE	132
12.2.4.2	AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS KLIKIMEVE, SHIKIMEVE DHE VIZITORËVE SIPAS 24 ORËVE.	133
12.2.4.3	AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS KLIKIMEVE, SHIKIMEVE DHE VIZITORËVE SIPAS DITËVE TË JAVËS.	134
12.2.4.4	AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS KLIKIMEVE, SHIKIMEVE DHE VIZITORËVE SIPAS MUAJVE TË VITIT.	135
12.2.4.5	AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS NDËRFAQEVE MË TË KLIKUARA NË PORTALIN E APP.	136
12.2.4.6	AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS FJALËVE KYÇ MË TË PËRDORURA PËR KËRKIMIN E PORTALIT TË APP.	138
12.2.4.7	AKSESIMI I SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK SIPAS SHFLETUESVE DHE SISTEMEVE OPERATIVE.	139
12.2.4.8	AKSESIMI I SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK SIPAS SISTEMEVE OPERATIVE DHE LLOJIT TË PAJSJEVE MË TË PËRDORURA NGA PËRDORUESIT	141
12.2.4.9	PËRDORIMI I APLIKACIONIT MOBILE	143
13.	MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCËS	145
13.1	MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE	145
13.2	AUTORITETI PËRGJEGJËS PER KONFLIKTIN E INTERESIT	145
13.3	KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT	145
13.4	AKTIVITETET NË DREJTIM TË FUQIZIMIT TË KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE TË STAFIT TË APP DHE SPECIALISTËVE TË PROKURIMIT PUBLIK PRANË AUTORITETEVE KONTRAKTORE	146
13.4.1	PJESËMARRJA E STAFIT TË APP NË AKTIVITETE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE	146
13.4.2	TRAJNIMET PËR LEGJISLACIONIN E PROKURIMIT PUBLIK	148
13.4.3	REALIZIMI I FONDEVE BUXHETORE	149
13.4.4	ANALIZA E ZËRAVE TË SHPENZIMEVE .	149
14.	PRIORITETET E AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2022	150



SHKURTIME:

AK - Autoritet Kontraktor

APP - Agjencia e Prokurimit Publik

ASPA - Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

ATRAKO - Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve

BB - Banka Botërore

BNJP - Buletini i Njoftimeve Publike

BOE – Bashkim i Operatorëve Ekonomikë

OE - Operator Ekonomik

ILDKPKI - Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit

KVO - Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

KPA - Kodi i Procedurave Administrative

KLSH - Kontrolli i Lartë i Shtetit

KM - Këshilli i Ministrave

KPP - Komisioni i Prokurimit Publik

LAP - Ligji për Ankandin Publik

LPP - Ligji i Prokurimit Publik

MK-Marrëveshje Kuadër

NJP- Njësi Prokurimi

OQB - Organi Qendror Blerës

PBB- Produkt i Brendshëm Bruto

PPP - Partneriteti Publik Privat

QKB - Qendra Kombëtare e Biznesit

SA - Strategjia Antikorrupsion.

SAE - Sistemi i Arkivës Elektronike

SMFP - Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike

SPE- Sistemi i Prokurimit Elektronik

PËRKUFIZIME:

Në funksion të interpretimit të kësaj analize, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

Fondi limit i prokuruar - Vlera pa TVSH, që përlogaritet nga autoriteti kontraktor në çastin e publikimit të njoftimit të kontratës ose në çastin e fillimit të procedurës së prokurimit, në rastet kur nuk kërkohet një publikim i tillë.

Vlera e fituar – Vlera e ofertës së shpallur fituese.

Fond i kursyer - Diferenca midis fondit limit të prokuruar dhe vlerës së fituar

Procedura të tjera - Procedura prokurimi të zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, pas publikimit të njoftimit të kontratës.

Procedurë prokurimi me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës – Lloj procedure e cila zhvillohet në rrugë elektronike dhe përdoret në rrethana të veçanta të parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik.

Procedura të papërfunduara (anulluara) - Procedura prokurimi që nuk janë finalizuar me njoftim fituesi

Pezullim - Ndërprerje e zhvillimit të procedurës së prokurimit në rastet kur ka ankesa në Autoritetin Kontraktor apo në Komisionin e Prokurimit Publik.

Asistim/koordinim- Proces i zhvilluar në kuadër të dhënies së asistencës autoriteteve kontraktore, të cilat ndërmarrin një procedurë prokurimi, sa i takon hartimit të dokumentave të tenderit.

Verifikim- Proces i zhvilluar pas përfundimit të procedurës së prokurimit me finalizimin e një kontrate për të verifikuar nëse procedura e prokurimit e zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor është kryer në përputhje me parashikimet ligjore.

Monitorim kontrate- Procesi i monitorimit të implementimit të kontratës së nënshkruar nga ana e autoriteteve kontraktore nëpërmjet raporteve të dërguara nga ana e tyre.

Procedura mbi kufirin monetar për prokurimet me vlerë të vogël-Për periudhën Janar-Maj 2021 ky term i referohet procedurave mbi 800,000 lek dhe për periudhën Qershor-Dhjetor 2021 procedurave mb 1,000,000 lek sipas kufijve të ri monetarë.



1. HYRJE

Ky raport pasqyron punën e Agjencisë së Prokurimit Publik (në vijim “APP”) dhe funksionimin e sistemit të prokurimit publik për periudhën nga 1 Janar 2021 deri në 31 Dhjetor 2021.

APP e ushtron veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Ligjit Nr. 125/2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”, Ligjit Nr. 9874/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar.

Raporti paraqet në mënyrë të detajuar edhe të dhëna statistikore në lidhje me funksionimin e sistemit të prokurimit publik në përgjithësi, përfshirë sistemin elektronik të prokurimit.

ARRITJET KRYESORE GJATË VITIT 2021

Viti 2021 ka qenë një vit intensiv pune për Agjencinë e Prokurimit Publik në drejtim të përmirësimit të sistemit të prokurimit. Angazhimi maksimal dhe rezultatet e arritura nga puna e APP gjatë këtij viti dhe jo vetëm, janë reflektuar edhe në vlerësimin pozitiv që Shqipëria ka marrë sa i takon fushës së Prokurimit Publik, në Raportin e Vlerësimit për Reformën në Administratën Publike për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë të përgatitur nga SIGMA. Në këtë Raport sistemi i prokurimit publik në Shqipëri, ka marrë vlerësimin maksimal 5/5 për 3 nga 5 indikatorë dhe vlerësimin 3/5 për 2 indikatorët e tjerë.

Konkretisht, Shqipëria është i vetmi vend në rajon që është vlerësuar maksimalisht në lidhje me kapacitetet institucionale në fushën e prokurimit publik në nivel qendror për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave në fushën e prokurimit në mënyrë efektive dhe efçente.

Një vlerësim i tillë lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me punën e Agjencisë së Prokurimit Publik (i) për hartimin e objektivave strategjike në fushën e prokurimit me qëllim garantimin e një sistemi prokurimi eficient dhe të qendrueshëm; (ii) për hartimin dhe miratimin e kuadrit të ri ligjor në fushën e prokurimit; dhe (iii) për monitorimin e vazhdueshëm për zbatimin e politikave dhe implementimin në mënyrën e duhur të legjislacionit të prokurimit.

Arritjet kryesore në këtë drejtim renditen në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

1. Plotësimi i kuadrit të ri ligjor të prokurimit publik:

Hyrja në fuqi e ligjit të ri të prokurimit 162/2020, intensifikoi punën e APP për të hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore me qëllim garantimin e implementimit të dispozitave të ligjit të ri. Në këtë kuadër janë hartuar dhe miratuar një sërë VKM, Udhëzimesh dhe disa sete të dokumentave standarde të tenderit për çdo procedurë dhe tip kontrate të parashikuar.

I gjithë legjislacioni është hartuar duke u bazuar në direktivat e BE-së në këtë fushë duke garantuar një shkallë të lartë të harmonizimit të legjislacionit.

2. Rritje e transparencës në lidhje me procedurat e prokurimit:

Sikurse rezulton nga të dhënat e pasqyruara në këtë raport, viti 2021 shënon numrin më të ulët të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës që nga viti 2010 me vetëm 143 procedura të tilla të realizuara.

Ulja e numrit të këtyre lloj procedurave është një tregues shumë i rëndësishëm për rritjen e transparencës në zhvillimin e procedurave të prokurimit duke qenë se autoritetet/entet kontraktore kanë preferuar të zhvillojnë procedura të cilat publikohen dhe janë lehtësisht të aksesueshme dhe të verifikueshme nga kushdo në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

3. Rritje e përdorimit të kriterit të vlerësimit ~oferta ekonomikisht më e favorshme~, bazuar në kosto:

Një arritje shumë e rëndësishme sikudër rezulton nga të dhënat, është rritja e përdorimit të kriterit të vlerësimit oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto duke synuar rritjes e cilësisë së kontratës të lidhur në fund të procesit të prokurimit.

Një rritje e tillë, vjen edhe si rezultat i legjislacionit të ri, i cili parashikon qartazi përdorimin nga ana e autoriteteve kontraktore të kriterëve që lidhen me cilësinë e produktit, kriteret mjedisore, sociale apo ciklin jetësor të tij duke garantuar efencë më të lartë dhe kosto më të ulët për autoritetin/entin kontraktor.

4. Trajnimi i punonjësve të prokurimit mbi risitë e ligjit:

Me qëllim garantimin e zbatimit të legjislacionit të ri nga Autoritetet/Entet kontraktore APP ka bashkëpunuar me OSBE dhe ASPA për të organizuar sesione informuese mbi risitë që sjell legjislacioni i ri dhe mënyrën e zbatimit të tyre.



2. TË DHËNA STATISTIKORE MBI SISTEMIN E PROKURIMIT PUBLIK NË SHQIPËRI

Prokurimi publik është një nga fushat kryesore të veprimtarisë shtetërore dhe një nga proceset më të rëndësishme në menaxhimin e financave publike. Sikundër tregohet edhe nga shifrat dhe të dhënat e përpunuara në këtë kuadër, fondi buxhetor i shpenzuar për prokurime publike në vendet e rajonit për vitin 2020 shkon mesatarisht nga 7.5-14.7% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Konkretisht sikundër paraqitet edhe në Grafikon nr. 1 më poshtë, sipas të dhënave të publikuara rezultojnë se:

- 1- **Kosova:** Sipas raportit të Komisionit Europian, bazuar në të dhëna paraprake, në vitin 2020, Prokurimi Publik arriti në 7.5% të PBB, me një ulje nga përqindja e vitit 2019, kur Prokurimi Publik zinte 10.7% të PBB. ¹
- 2- **Serbia:** Sipas raportit të Komisionit Europian, në vitin 2020, Prokurimi Publik arriti në rreth 6.88% të PBB, duke pësuar një ulje nga përqindja e vitit 2019, kur Prokurimi Publik zinte 8% të PBB. ²
- 3- **Mali i Zi:** Sipas raportit të Komisionit Europian, në vitin 2020, Prokurimi Publik zë 13.1% të PBB, duke pësuar një rritje të lehtë nga përqindja e vitit 2019, kur Prokurimi Publik zinte 12.4% të PBB. ³
- 4- **Maqedonia e Veriut:** Sipas raportit të Komisionit Europian, në vitin 2020, Prokurimi Publik, përfaqëson 8% të PBB, duke pësuar një rënie nga përqindja e vitit 2019, kur Prokurimi Publik zinte 11% të PBB. ⁴
- 5- **Shqipëria:** Sipas analizës vjetore të vitit 2020, publikuar nga APP, prokurimi publik për vitin 2020 zinte rreth 14.7% të PBB. ⁵

Grafiku 1



Burimi: Të dhëna të marra nga Raportet e Komisionit Europian për vendet e Rajonit dhe analiza vjetore e APP

1 European Commission (2021), Kosovo Report, pg. 62
https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en

2 European Commission (2021), Serbia Report, pg. 69
https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/serbia-report-2021_en

3 European Commission (2021), Montenegro Report, pg. 61
https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/montenegro-report-2021_en

4 European Commission (2021), North Macedonia Report, pg. 57
https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/north-macedonia-report-2021_en

5 Analiza Vjetore 2020, APP, pg. 8

Ndërkohë, nga përpunimi i të dhënave në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe bazuar në të dhënat paraprake të siguruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë⁶ mbi Produktin e Brendshëm Bruto (PBB), rezulton se, për vitin 2021 **fondi total limit i publikuar zë 8.9% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB)**.


Tabela dhe grafiku i mëposhtëm paraqesin të dhënat në lidhje me raportin fond total limit i publikuar-PBB:

Tabela 1

Treguesi makroekonomik	Vlera (në miliardë Lekë)
PBB- Produkti Brendshëm Bruto	1,682,600,000,000
Fondi total limit i publikuar në Republikën e Shqipërisë	149,320,420,249
Fondi total limit i publikuar në Republikën e Shqipërisë në raport me PBB (në %)	8.9%

Grafiku 2

Raporti Fondi Total Limit i Prokurimeve- PBB



Siç tregohet nga të dhënat e mësipërme, gjatë vitit 2021 ka një rënie të raportit të fondit total limit me PBB krahasuar me vitin 2020 kur ky raport ishte 14.7%.

2.1 STATISTIKA NË LIDHJE ME REGJISTRAT E PARASHIKIMEVE TË KRIJUARA NË SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK PËR VITIN 2021

Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistri i procedurave të prokurimit publik të realizuara përgatiten elektronikisht dhe publikohen në Sistemin e Prokurimit Elektronik, ku janë të aksesueshme pa pagesë nga çdo i interesuar dhe në çdo moment.

Automatizimi i këtyre dy regjistrave ka pasur një rëndësi shumë të madhe për rritjen e përgjegjësisë së Autoriteteve Kontraktore në planifikimin e nevojave që do të prokurojnë gjatë vitit në vijim si dhe për garantimin e informacionit për operatorët ekonomikë mbi të gjitha procedurat dhe fondet publike që do të prokurohen gjatë vitit në kohë reale i, duke rritur në mënyrë të dukshme transparencën në lidhje me përdorimin dhe menaxhimin e fondeve publike.

Gjithashtu, automatizimi i regjistrave i mundëson APP-së identifikimin e të dhënave për prokurimet e planifikuara për t'u kryer nga autoritetet kontraktore në kohë reale.

⁶ Sipas parashikimeve zyrtare paraprake për 2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (<https://financa.gov.al/kuadri-makroekonomik-dhe-fiskal-2/>) Produkti i Brendshëm Bruto për vitin 2021 është: 1,682,600,000,000.



Nga të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit për vitin 2021, rezulton se janë miratuar dhe publikuar 36926 elementë në regjistrat e parashikimit të prokurimeve (element të rinj dhe ndryshime).

Konkretisht, detajimi i elementëve në Regjistrin Kombëtar të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit është si më poshtë:


Tabela 2

Tipi i Kontratës	Lloji i procedurës së prokurimit	VITI 2021
Punë	Kontrata mbi kufirin monetar për prokurimet me vlerë të vogël	1866
	Prokurim me vlerë të vogël	615
	Negociim, pa shpallje paraprake	22
	Amendament për nevojat e fillim vitit	9
Mallra	Kontrata mbi kufirin monetar për prokurimet me vlerë të vogël	5401
	Prokurim me vlerë të vogël	7693
	Blerje nën vlerën 100 000 lekë	6680
	Amendament për nevojat e fillim vitit	9
	Negociim, pa shpallje paraprake	94
Shërbime	Kontrata mbi kufirin monetar për prokurimet me vlerë të vogël	2659
	Prokurim me vlerë të vogël	5135
	Blerje nën vlerën 100 000 lekë	6444
	Amendament për nevojat e fillim vitit	18
	Sistem Dinamik Blerje Bileta	214
	Negociim, pa shpallje paraprake	67
Totali Elementë të regjistrit të publikuar		36926

Nga monitorimi i Elementeve të Regjistrit të Parashikimeve dhe Realizimeve në SPE në vitin 2021, rezulton se janë **36926** elementë të parashikuar në regjistër, nga të cilët **32851** elementë ose 88,97% e totalit kanë vijuar me procedurat, ndërsa **4075** elemente ose 11,03% e totalit janë me statusin të anuluar.

Formë grafike, të dhënat paraqiten si më poshtë vijon:

Grafiku 3



Nga analizimi i elementeve në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik, të cilët kanë vijuar me shpalljen e procedurave nga autoritetet kontraktore rezulton se 5302 elementë janë me ndryshime. Ndryshimet në regjistrin e parashikimeve, janë tregues i performancës së Regjistrit të Parashikimeve.

Nëse do analizojmë vetëm Performancën e Regjistrit të Parashikimeve të shprehur në përqindje si raport i elementëve të ndryshuara ndaj totalit të elementëve me statusin të pa anuluar ($5302/32851 \times 100$), rezulton se ato paraqiten në masën **16.1 %**.

Tabela 3

Performanca e Regjistrave të Parashikimit	
Janar-Dhjetor 2021	Numri i Elementeve
Total Numri i elementeve të Rregjistrave të Parashikimit te pa anuluar	32851
Numri i elementeve të Rregjistrave të Parashikimit të Ndryshuara	53602
Performanca ose % e elementeve të Ndryshuara ($5302/32851 \times 100$)	16.1%


Siç vërehet më lart, rreth 83.9% e elementeve që janë Elemente të Regjistrit të publikuara (të parashikuara e të realizuara, si dhe në proces realizimi) janë pa ndryshime.

Krahasur me vitin 2020 ku përqindja e zërave të rregjistrave që kanë pasur ndryshime ishte 19.3%, në vitin 2021 vërehet një ulje e kësaj përqindje në masën 16.1%, duke treguar një performancë më të mirë krahasuar me vitin 2020.

Në diagramën e mëposhtme paraqitet performanca e elementeve të regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit për vitin 2021.



Grafiku 4



2.2 STATISTIKA NË LIDHJE ME NUMRIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK TË PUBLIKUARA GJATË VITIT 2021 NË SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK

Në këtë seksion paraqiten të dhënat e detajuara, lidhur me procedurat e prokurimit publik, përfshirë procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, procedurat me vlerë të vogël dhe sistemin dinamik të zhvilluara në Republikën e Shqipërisë, gjatë vitit 2021.

Në mënyrë të përmblodhur, të dhënat kryesore për procedurat konkurruese me vlerë mbi kufirin monetar **për prokurimet me vlerë të vogël** dhe procedurat negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, si dhe raportet në përqindje dhe fondi i kursyer në total, për vitin 2021, paraqiten si më poshtë:

Tabela 4

Prokurime elektronike dhe Procedura me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit te Publikuara për Periudhën Janar-Dhjetor 2021	
Nr.Total i Procedurave/Loteve të shpallura ne SPE	5079
Fondi limit total i shpallur në SPE	149,320,420,249
Nr.Total i Procedurave/Loteve të shpallura në SPE dhe të anuluar	1042
Fondi limit i Procedurave/Loteve të shpallura në SPE dhe të anuluar	18,620,051,244
Nr.Total i Procedurave/Loteve të shpallura në SPE dhe të vazhduara	4037
Fondi limit i Procedurave/Loteve të shpallura në SPE dhe të vazhduara	130,700,369,005
Numri Total i Procedurave të përfunduara me fitues	4078
Fondi total limit i procedurave të përfunduara me fitues (vlera në lekë)	189,155,455,459
Nr. Total i Procedurave të fituara Negocim pa shpallje	143
Fondi limit total për procedurat me negocim pa shpallje	6,512,211,253
% që zë nr Total i procedurave me negocim pa shpallje paraprake ndaj nr total të procedurave të përfunduara me fitues (procedura të tjera+negocim pa shpallje)	3.4%
% që zë fondi total limit për procedurat me negocim pa shpallje ndaj fondit total limit të procedurave të përfunduara me fitues (procedura të tjera+negocim pa shpallje)	3,3%
KURSIMI TOTAL	
% që zë Vlera totale e fituar ndaj Fondit total limit të prokuruar	94.5%
Vlera totale e kursyer në lekë pa TVSH	10,781,993,256
% që zë Vlera totale e Kursyer ndaj Fondit total limit të prokuruar	5.5%

Sikurse tregohet nga tabela e mësipërme, përsa i përket numrit të procedurave me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, për periudhën Janar–Dhjetor 2021 janë zhvilluar gjithsej 143 procedura nga të cilat,

Krahasuar me numrin total të procedurave të përfundura me fitues (konkurrese + negocim pa shpallje), procedurat me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës përbëjnë **3.4% të tyre**.

Në çdo rast, sikundër rezulton nga të dhënat e mësipërme, fondi limit i publikuar për këtë lloj procedure (**6,512,211,253** lekë) është shumë më i ulët, krahasuar me fondin limit total të procedurave të përfunduara me fitues (elektronik+negocim pa shpallje) (195,667,666,712 lekë) duke zënë vetëm 3.3 % të fondit total të procedurave të përfundura me fitues.

Ndërkohë, nga tabela e mësipërme vërehet se numri i procedurave të përfundura me fitues është më i madh se numri i procedurave të vazhduara, gjë që shpjegohet me publikimin e procedurave për qëllim të mbulimit të nevojave të vitit 2021 në fund të vitit 2020, të cilat kanë përfunduar me fitues në fillim të vitit 2021.



2.3 STATISTIKA PËR PROCEDURAT KONKURRUESE TË PROKURIMIT, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik

Në këtë pjesë të analizës vjetore, do të pasqyrohen dhe interpretohen të dhënat mbi numrin e procedurave konkurruese të prokurimit publik mbi kufirin monetar për prokurimet me vlerë të vogël, të cilat janë shpallur për t'u zhvilluar në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Gjithashtu, në këtë pjesë do të pasqyrohen të dhënat respektive për numrin e njoftimeve të fituesve dhe numrin e njoftimeve të kontratave të nënshkuara dhe do të bëhet analiza e këtyre të dhënave.

Për shkak të miratimit të legjislacionit të ri të prokurimit, për vitin 2021 ka pasur ndryshime të rëndësishme sa i takon procedurave të prokurimit, konkretisht:

- Procedura “Kërkesë për propozim” është zëvendësuar me procedurën “E hapur e thjeshtuar”, e cila ka filluar të përdoret që prej muajit Qershor. Për këtë arsye, në këtë analizë do të pasqyrohen të dhëna për të dy këto procedura.
- Kufijtë monetarë kanë ndryshuar për t'u harmonizuar me kufijtë monetarë të përdorur në BE. Kjo ka sjellë një ulje të konsiderueshme të kufirit të lartë monetar, e cila rezulton me rritje të numrit të procedurave mbi këtë kufi në krahasim me vitet e mëparshme.

2.3.1 STATISTIKA SIPAS TIPIT të kontratës

Numri total i njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2021 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas tipit të kontratës, shërbim, mall, punë, është 5079 (1361 më pak se në vitin 2020 ku janë shpallur 6440 procedura konkurruese).

Konkretisht, numri i procedurave sipas kontratave paraqitet si më poshtë:

Tabela 5

Njoftime Procedurash Viti 2021					
Shërbime		Mallra		Punë publike	
Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve procedurave
Procedurë e hapur	344	Procedurë e hapur	672	Procedurë e hapur	436
E hapur mbi kufirin e lartë monetar	61	E hapur mbi kufirin e lartë monetar	205	E hapur mbi kufirin e lartë monetar	14
Kërkesë për Propozim	401	Kërkesë për Propozim	702	Kërkesë për Propozim	237
E Hapur e Thjeshtuar	449	E Hapur e Thjeshtuar	995	E Hapur e Thjeshtuar	314
Shërbim Konsulence e Konkurs Projektimi	98	Shërbim Konsulence e Konkurs Projektimi	0	Shërbim Konsulence e Konkurs Projektimi	0
E kufizuar (JO Rindërtim)	2	E kufizuar (JO Rindërtim)	-	E kufizuar (JO Rindërtim)	4
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar (JO Rindërtim)	-	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar (JO Rindërtim)	-	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar (JO Rindërtim)	-
E kufizuar per Rindërtimin	66	E kufizuar Lokal per Rindërtimin	-	E kufizuar Lokal per Rindërtimin	76
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	-	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	1	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	2
TOTALI	1,421	TOTALI	2,575	TOTALI	1,083

Nga analizimi i të dhënave për vitin 2021 vërehet se, numrin më të madh të procedurave të shpallura e zënë procedurat për prokurimin e mallrave me 2575 procedura të shpallura në total ose 51% të procedurave të shpallura, duke vijuar me procedurat për shërbimet me 1421 procedura të shpallura në total ose 28 % dhe procedurat për punë civile me 1083 procedura të shpallura në total ose 21 %.

Gjithashtu, rezulton se në numër të lartë janë procedurat “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” me 280 procedura të shpallura ose 5,5% të totalit të procedurave të shpallura, me fond limit 60,320,831,429 lekë që përbën një vlerë të konsiderueshme krahasuar me fondin limit të shpallur në vitin 2020 me këtë lloj procedure.



Ritja e numrit dhe vlerave përkatëse të këtyre lloj procedurave shpjegohet me ndryshimin e kufijve monetarë nga legjislacioni i ri i prokurimit duke ulur vlerën e kufirit të lartë monetar në mënyrë të konsiderueshme. Për pasojë, një pjesë e mirë e procedurave të cilat në vitet e mëparshme janë konsideruar si procedura nën kufirin e lartë monetar, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021 janë klasifikuar si procedura mbi kufirin e lartë monetar.

Vlen të theksohet se, në këto procedura afati i pritjes së ofertave është më i gjatë dhe dokumentat standarte të tenderit publikohen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, duke aplikuar kështu rregulla procedural të njëjta me ato që parashikohen në Direktivën përkatëse të BE-së.

2.3.2 STATISTIKA SIPAS LLOJIT TË PROCEDURAVE

Të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurës, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2021 dhe fondet limite përkatëse, janë si më poshtë:

Tabela 6

Numri total i procedurave të shpallura të ndarë sipas llojit të procedurave për Periudhën Janar - Dhjetor 2021	
Numri Total i Procedurave të shpallura	5,079
Fondi total limit i procedurave të shpallura (vlera në lekë pa TVSH)	149,320,420,249
Numri i procedurave Shërbim konsulence dhe konkurs projektimi	98
Fondi limit i procedurat Shërbim konsulence dhe konkurs projektimi (vlera në lekë)	3,356,417,307
Numri i procedurave E hapur mbi kufirin e lartë monetar	280
Fondi limiti procedurat E hapur mbi kufirin e lartë monetar (vlera në lekë)	60,320,831,429
Numri i Procedurave E hapur	1,452
Fondi limit i Procedurave E hapur (vlera në lekë)	56,079,357,875
Numri i procedurave Kërkesë për propozim	1,340
Fondi limit i procedurave Kërkesë për propozim (vlera në lekë)	3,975,850,520
Numri i procedurave E hapur e Thjeshtuar	1,758
Fondi limit i procedurave E hapur e Thjeshtuar (vlera në lekë)	5,438,168,128
Numri i procedurave E Kufizuar pa përfshirë Rindërtimin	6
Fondi limit i procedurave E Kufizuar (vlera në lekë) pa përfshirë Rindërtimin	770,879,530
Numri i procedurave E kufizuar mbi Kufirin e lartë pa përfshirë Rindërtimin	0
Fondi limit i procedurave E kufizuar mbi Kufirin e lartë (vlera në lekë) pa përfshirë Rindërtimin	0
Numri i procedurave E Kufizuar (vetëm Rindërtimi)	142
Fondi limit i procedurave E Kufizuar (vlera në lekë) (vetëm Rindërtimi)	15,767,419,365
Numri i procedurave E kufizuar mbi kufirin e lartë (vetëm Rindërtimi)	3
Fondi limit i procedurave E kufizuar mbi kufirin e lartë (vlera në lekë vetëm Rindërtimi)	3,611,496,095

Grafiku i mëposhtëm paraqet, përqindjen e numrit të procedurave të prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurës, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2021:

Grafiku 6



Sikurse vërehet në të dhënat e mësipërme numrin më të madh të procedurave e zë procedura “**Kërkesë për propozim dhe e Hapur e Thjeshtuar**” me 3098 procedura të shpallura ose 61% të numrit total të procedurave të shpallura.

Gjithashtu, sa i takon llojeve të tjera të procedurave rezultojnë se procedura “E hapur” përbën 28,9% të numrit total me 1452 procedura të publikuara, procedura “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” zë 5% të numrit total me 280 procedura të publikuara, procedura “Shërbim Konsulencë” zë 2% të numrit total me 98 procedura të publikuara, procedura “E kufizuar përfshirë Rindërtimin” zë 3% të numrit total me 148 procedura të publikuara dhe procedura “E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar” zë vetëm 0,1% të numrit total me 3 procedura të publikuara .



Tabela e mëposhtme paraqet, përqindjen e Fondit Limit të procedurave të prokurimit publik të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2021, detajuar sipas llojit:

Tabela 7

Lloji i procedurës	Fondi limit sipas llojit të procedurave	% e Fondi limit të procedurave sipas llojit ndaj totalit
E Hapur	56,079,357,875	38.0%
E Hapur mbi Kufirin e lartë monetar	60,320,831,429	40.3%
Kërkesë për Propozim	3,975,850,520	2.5%
E Hapur e Thjeshtuar	5,438,168,128	3.6%
Shërbim Konsulence + Konk.Projekt	3,356,417,307	2.2%
E kufizuar (JO Rindërtimi)	770,879,530	0,5%
E kufizuar (Vetëm Rindërtimi)	15,767,419,365	10.5%
E kufizuar mbi kufirin e lartë (JO Rindërtimi)	0	0.0%
E kufizuar mbi kufirin e lartë (vetëm Rindërtimi)	3,611,496,095	2,4%
TOTALI	149,320,420,249	100,0%

Sa i takon Fondit Limit të procedurave të prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurave të zhvilluara për vitin 2021, sikur vërehet në të dhënat e mësipërme, përqindjen më të madhe e zë procedura “E Hapur mbi kufirin e lartë monetar” me fond limit 60,320,831,429 lekë pa TVSH, ose 40.3% të Fondit Limit total të procedurave të shpallura, ndërkohë që numrin më të madh të procedurave e zë procedura “**Kërkesë për Propozim së bashku me E Hapur e Thjeshtuar**” me 3098 procedura.

Krahasuar me vitin 2020 ku procedura “E Hapur mbi Kufirin e lartë monetar” ka pasur Fondin Limit 47,780,228,294 lekë pa TVSH, sikurse e theksuam edhe më sipër,rezulton se fondi limit i procedurës “E Hapur mbi Kufirin e lartë monetar” (60,320,831,429 lekë) publikuar në vitin 2021 është 24% më i madh se në vitin 2020.

Sikurse analizuam më sipër, ky fakt ka ndodhur për shkak të ndryshimeve të kufijve monetarë, duke bërë që të prokurohen më shumë fonde se çdo vit tjetër me procedura konkurruese mbi kufijtë e lartë monetarë.

2.3.3 STATISTIKA PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT TË PUBLIKUARA DHE TË VAZHDUARA GJATË VITIT 2021, SIPAS 3 MUJORËVE

Në formë tabelore, të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik, të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2021 dhe fondet limite përkatëse, sipas 3 mujorëve janë si më poshtë:

Tabela 8

Statistika Publikime Procedura Prokurimi të vazhduara sipas 3 mujoreve Viti 2021					
Nr.	Emërtimi	Nr. Procedura / Lote Publikuara	Fondi limit Lekë pa TVSH	% Numrit të procedurave/ loteve të 3 mujorit ndaj totalit	% e Fondit Limit të 3 mujorit ndaj totalit
1	Publikime Procedura Prokurimi në SPE 3 mujori I-rë viti 2021	1423	39,397,630,318	35,2%	30,2%
2	Publikime Procedura Prokurimi në SPE 3 mujori II-të viti 2021	736	37,338,801,216	18,2%	28,6%
3	Publikime Procedura Prokurimi në SPE 3 mujori III-të viti 2021	752	25,950,005,826	18,6%	19,8%
4	Publikime Procedura Prokurimi në SPE 3 mujori IV-t viti 2021	1126	28,013,931,645	28,0%	21,4%
5	TOTALI	4037	130,700,369,005	100%	100%

Sikurse vërehet nga të dhënat e mësipërme, në tremujorin e I-rë dhe të IV-të kemi numrin më të madh të procedurave të shpallura dhe të vazhduara që zënë 63,2 % të totalit. Po kështu, edhe fondit limit i procedurave të shpallura e të vazhduara në tremujorin e I-rë dhe të II-të ka zënë 58,8 % të totalit.

Numri më i madh të procedurave të shpallura në tremujorin e I-rë dhe të IV-të shpjegohet me faktin se në tremujorin e I-rë hapen procedurat e reja për vitin 2021, ndërsa në tremujorin e IV-t hapen dhe procedurat e reja për vitin e ardhshëm buxhetor.



2.3.4 STATISTIKA MBI NUMRIN E NJOFTIMEVE TË KONTRATAVE PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT TË PUBLIKUARA GJATË VITIT 2021, KRAHASUAR ME VITIN 2020.

Përsa i përket, numrit të njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të publikuara, sipas tipit të kontratës për vitin 2021, krahasuar me vitin 2020 paraqitet si më poshtë:

Tabela 9

Krahase Publike Procedura Konkurruese Viti 2020 me Vitin 2021 sipas Tipit të kontratës		
Viti	2020	2021
Shërbime	1,571	1,421
Mallra	3,780	2,575
Punë	1,089	1,083
Numri Total i Procedurave	6,440	5,079
Vlera totale Fondi limit	264,072,258,684	149,320,420,249

Përsa i përket, numrit të njoftimeve për procedurat e prokurimit për vitin 2021, sipas llojit të procedurës krahasuar me vitin 2020 paraqitet si më poshtë:

Tabela 10

Numri i njoftimeve të procedurave Konkurruese krahasimore viti 2020 me vitin 2021, sipas llojit të procedurës së prokurimit		
Lloji i procedurës	Viti 2020	Viti 2021
Procedurë e Hapur	1954	1452
E Hapur mbi Kufirin e lartë monetar	332	280
Kërkesë për Propozim	3842	1340
E Hapur e Thjeshtuar	0	1758
Shërbim Konsulencë+Konk.Projekt	142	98
E kufizuar (Jo Rindërtimi)	3	6
E kufizuar për Rindërtimin	110	142
E kufizuar mbi kufirin e lartë (Jo Rindërtimi)	40	0
E kufizuar mbi kufirin e lartë (Ndërkombëtar për Rindërtimin)	17	3
Numri i Procedurave	6440	5079
Vlera totale Fondi limit	264,072,258,684	149,320,420,249

Ajo që vërehet nga të dhënat e kësaj table, është fakti se për vitin 2021 rezultojnë të shpallura një numër më i vogël i procedurave (5079), krahasuar me vitin 2020 ku janë shpallur (6440).


Gjithashtu, fondi limit i procedurave të shpallura për vitin 2020 (264,072,258,684 lekë pa TVSH), është konsiderueshëm më i lartë se fondi limit i procedurave të shpallura për vitin 2021 (149,320,420,249 lekë pa TVSH).

Ulja e konsiderueshme e fondit të shpallur për prokurim gjatë vitit 2021 reflekton uljen e nevojës për zhvillimin e procedurave që lidhen me përballimin e pasojave të tërmetit të Nëntorit 2019 dhe pandemisë Covid-19, të cilat kanë qenë të konsiderueshme gjatë vitit 2020.

Në vitin 2021 rezultojnë të shpallura 145 procedura “E Kufizuar” dhe “E Kufizuar mbi kufirin e lartë monetar” me fond limit total prej 19,378,915,460 lekë, por këto procedura kanë pasur si objekt kryesisht shërbimet e mbikqyrjes apo të kolaudimit të punimeve që zhvillohen në kuadër të procesit të rindërtimit.

Në grafikun e mëposhtëm, paraqiten me grafik numri i procedurave të publikuara në mënyrë krahasimore sipas llojit të procedurës, respektivisht në vitin 2020 dhe 2021.

Grafiku 7



Përsa i përket të dhënave mbi vlerat e fondit limit për procedurat e shpallura në vitin 2021 krahasuar me vlerat e fondit limit për procedurat e shpallura në vitin 2020, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 11


Vlerat e Fondit Limit të njoftimeve të procedurave Konkurruese Krahasime viti 2020 me vitin 2021, sipas llojit të procedurës së prokurimit		
Lloji i procedurës	Viti 2020	Viti 2021
Procedure e Hapur	123,247,664,809	56,079,357,875
E Hapur mbi Kufirin e lartë	47,780,228,294	60,320,831,429
Kërkesë për Propozim	8,235,601,242	3,975,850,520
E Hapur e Thjeshtuar	0	5,438,168,128
Shërbim Konsulencë + Konk.Projekt	2,870,217,730	3,356,417,307
E kufizuar (Jo Rindërtimi)	186,289,623	770,879,530
E kufizuar për Rindërtimin	8,914,808,768	15,767,419,365
E kufizuar mbi Kufirin e lartë (Jo Rindërtimi)	10,419,821,448	0
E kufizuar mbi Kufirin e lartë për Rindërtimin	62,417,626,770	3,611,496,095
Vlera totale Fondi limit	264,072,258,684	149,320,420,249

Nga analiza e vlerave krahasuese të paraqitura në tabelën e mësipërme, vërehet se ka një ulje të vlerës së prokuruar në vitin 2021, krahasuar me atë të prokuruar në vitin 2020. Duhet theksuar se, kjo ulje e vlerës së prokuruar, përveç perballimit të situatës së rindërtimit nga termeti dhe pandemisë në vitin 2020, shpjegohet me ndikimin që ka përdorimi i ndjeshëm edhe i një numri të madh të Marrëveshjeve Kuadër, më shumë se 1 vjeçare.

Në grafikun e mëposhtëm, paraqiten numri i procedurave të publikuara në mënyrë krahasimore dhe vlerat e fondit limit, respektivisht për vitin 2020 dhe 2021.



Grafiku 8




Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, paraqitet numri i procedurave të publikuara në mënyrë të detajuar, respektivisht në periudhën Janar – Dhjetor 2020 dhe Janar – Dhjetor 2021, sipas muajve.

Tabela 12


Krahasim Numri i procedurave të shpallura në Sistemin e Prokurimit Elektronik viti 2020 me vitin 2021		
Viti	2020	2021
Janar	194	291
Shkurt	600	629
Mars	633	794
Prill	377	249
Maj	362	327
Qershor	716	339
Korrik	729	314
Gusht	634	390
Shtator	583	381
Tetor	666	427
Nentor	419	521
Dhjetor	527	417
Totali	6440	5079

Grafiku i mëposhtëm paraqet, përqindjen e publikimit të procedurave të prokurimit publik në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2021, sipas 3 mujorëve:

Grafiku 9



Grafiku 10





Nga grafikët e mësipërm vërehet se ka një rritje të efikasitetit të procesit ku shpërndarja e procedurave sipas muajve është kthyer në normalitet, duke avancuar numrin më të madh të tyre në 6 mujin e I-të të vitit, në ndryshim nga situata e paqartë gjatë vitit 2020, ku për shkak të pandemisë zhvillimi i procedurave u spostua në 6 mujin e II-të 2020.

Kjo tregon përmirësim të planifikimit dhe realizimit në kohë të procedurave të cilat zhvillohen në 6 mujin e parë dhe në 3 mujin e katërt të vitit, me qëllim mbulimin e nevojave për vitin në vijim.

Vlen të theksohet se, në evidentimin e këtyre numrave kanë ndikuar edhe faktorë të tjerë si Informatizimi i regjistrit të parashikimeve, ku autoritetet kanë detyrimin që në elementët përkatës të parashikojnë kohën e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e këtij planifikimi, duke shmangur ndryshimet e shpeshta në regjistrë.

2.3.5 STATISTIKA SIPAS NJOFTIMEVE TË FITUESIT

Në këtë pjesë të raportit, do të pasqyrohen të dhënat respektive në lidhje me publikimin e njoftimeve të fituesve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe do të bëhet analiza e këtyre të dhënave.

Numri total i njoftimeve të fituesit të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2021 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas tipit të kontratave, shërbim, mall, punë, është 4078 (490 më pak se në vitin 2020 ku u shpallën fitues 4568 procedura).

Numri më i ulët i njoftimeve të fituesit është i lidhur edhe me numrin më të ulët të shpalljeve të procedurave gjatë vitit 2021 (ku u shpallën 5079 procedura), në krahasim me shpalljet e procedurave në vitin 2020 (ku u shpallën 6440 procedura) .

Gjithashtu, kjo rënie e numrit të procedurave të finalizuara me njoftim fituesi reflekton edhe efektet pozitive që ka sjellë përdorimi i “Marrëveshjes Kuadër” me afate kohore disa vjeçare për objektet (mall/punë/shërbim) të parashikuara.

2.3.5.1 STATISTIKA MBI NUMRIN E NJOFTIMEVE TË FITUESVE TË PUBLIKUARA GJATË VITIT 2021, SIPAS TIPIT TË KONTRATËS

Në formë tabelore, të dhënat për procedurat e prokurimit elektronik, të ndara sipas tipit të kontratës të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues në sistem gjatë vitit 2021, janë si më poshtë:

Tabela 13

Numri i njoftimeve të fituesve të publikuara sipas tipit të kontratës Viti 2021					
Shërbime		Mallra		Punë publike	
Lloji i Procedurës	N u m r i njoftime fituesi	Lloji i Procedurës	N u m r i njoftime fituesi	Lloji i Procedurës	N u m r i njoftime fituesi
Procedure e Hapur	343	Procedure e Hapur	590	Procedure e Hapur	486
E hapur mbi kufirin e lartë	41	E hapur mbi kufirin e lartë	54	E hapur mbi kufirin e lartë	10
Kërkesë për Propozim	397	Kërkesë për Propozim	628	Kërkesë për Propozim	234
E Hapur e Thjeshtuar	307	E Hapur e Thjeshtuar	530	E Hapur e Thjeshtuar	216
Shërbim Konsulence e Konkurs Projektimi	107	Shërbim Konsulence e Konkurs Projektimi	0	Shërbim Konsulence e Konkurs Projektimi	0
E kufizuar (JO Rindërtim)	1	E kufizuar (JO Rindërtim)	0	E kufizuar (JO Rindërtim)	0
E kufizuar mbi Kufirin e lartë (JO Rindërtim)	65	E kufizuar mbi Kufirin e lartë (JO Rindërtim)	0	E kufizuar mbi Kufirin e lartë (JO Rindërtim)	57
E kufizuar (Rindërtimi)	8	E kufizuar (Rindërtimi)	0	E kufizuar (Rindërtimi)	0
E kufizuar mbi Kufirin e lartë (Rindërtimi)	0	E kufizuar mbi Kufirin e lartë (Rindërtimi)	1	E kufizuar mbi Kufirin e lartë (Rindërtimi)	3
TOTALI	1,269	TOTALI	1,803	TOTALI	1,006

Nga të dhënat e tabelës rezulton se numri më i lartë i fituesve është për kontratat e mallrave me 1,803 fitues ose 44.2 % të totalit të fituesve, më tej “Shërbime”, me 1,269 fitues ose 31.1 % të totalit të fituesve, si dhe “Punë publike”, me 1,006 fitues ose 24.7 % të totalit të fituesve.



2.3.5.2 STATISTIKA MBI NUMRIN E NJOFTIMEVE TË FITUESVE TË PUBLIKUARA GJATË VITIT 2021, SIPAS LLOJIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT

Njoftimet e fituesit sipas llojit të procedurës, fondit limit të prokuruar dhe vlerës së fituar për procedurat e vitit 2021 paraqiten si më poshtë:

Tabela 14

Të dhëna për procedurat e prokurimit të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues Janar -Dhjetor 2021						
Llojet e procedurave	Numri Total i Procedurave	Fondi limit total i publikuar (vlera në Lekë)	Vlera totale e ofruar (Fituar) (vlera në Lekë)	% që ze fondi i ofruar ndaj fondit limit të publikuar	Fondi total i kursyer (vlera në Lekë)	% që ze fondi i kursyer ndaj fondit limit të publikuar
Procedure e Hapur	1,419	78,903,907,592	73,378,365,847	93,0%	5,525,541,745	7,0%
E hapur mbi kufirin e lartë monetar	105	52,740,866,198	48,779,720,655	92,5%	3,961,145,545	7,5%
Kërkesë për Propozim	1,259	3,948,061,497	3,499,873,325	88,7%	448,188,172	11,3%
E Hapur e Thjesh-tuar	1,053	3,578,344,587	3,132,362,411	87,4%	445,982,176	12,6%
Shërbim Kon-sulence dhe Konkurs Projektimi	107	2,832,628,446	2,582,739,645	91,2%	249,888,800	8,8%
E Kufizuar (JO Rindërtim)	1	48,826,042	48,826,042	0	0	0
E Kufizuar (Vetëm Rindërtim)	122	13,942,536,181	13,840,337,658	99,3%	102,198,523	0,7%
E Kufizuar mbi Kufirin e lartë (JO Rindërtim)	8	5,155,131,012	5,155,131,012	0	0	0
E Kufizuar mbi Kufirin e lartë (Vetëm Rindërtim)	4	28,005,153,903	28,005,153,903	0	0	0
TOTAL	4,078	189,155,455,459	178,422,510,498	94,3%	10,732,944,961	5,7%


Sikundër vërehet nga të dhënat e mësipërme, vlera më e lartë e kursimit ndaj fondit limit të publikuar, është tek “Procedura e Hapur”, që zë edhe përqindjen më të madhe prej 51% të vlerës totale të kursyer për procedurat konkurruese mbi kufirin monetar për prokurime me vlerë të vogël.

Sa i takon përqindjes së ulët të kursimit të fondit limit të evidentuar tek procedura “E Kufizuar” dhe “E Kufizuar mbi Kufirin e lartë monetar”, duhet theksuar se nëpërmjet këtyre procedurave janë prokuruar kryesisht Marrëveshje Kuadër me kohëzgjatje më shumë se një vit për implementimin e të cilave është e nevojshme zhvillimi i minikonkurseve nga ana e AK përgjegjëse në varësi të nevojave që ka gjatë gjithë kohëzgjatjes së MK.

Në këtë kuptim, vlera reale e marrëveshjes kuadër nuk mund të matet me të dhënat e një viti, por mund të përlllogaritet vetëm në përfundim të afatit të saj të vlefshmërisë, duke përlllogaritur edhe fondin e kursyer pas nënshkrimit të minikontratave.

Diagrama e mëposhtme paraqet, raportin në përqindje të numrit të njoftimeve të fituesve në procedurat e prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurës, zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik për 2021.

Grafiku 11



Sa i takon numrit të njoftimeve të fituesve të shpallura për vitin 2021, sikur vërehet në të dhënat e mësipërme numrin më të madh të procedurave e zë procedura “**Kërkesë për propozim dhe e Hapur e Thjeshtuar**” me 2312 njoftime fituesish të publikuar ose 56,6% të numrit total të fituesve të shpallur.

Ndërkohë, sikurse tregohet në tabelën e mësipërme, vlera më e madhe e fituar është në procedurën e hapur duke u pasuar nga procedura e hapur mbi kufirin e lartë monetar dhe e kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin



2.3.5.3 STATISTIKA MBI NUMRIN E NJOFTIMEVE TË FITUESVE TË PUBLIKUARA GJATË VITIT 2021, KRAHASUAR ME VITIN 2020


Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, jepen të dhënat statistikore në lidhje me njoftimet e fituesve të 2021 krahasuar me 2020.

Tabela 15

Krahase Numri i Njoftimeve të Fituesve të publikuar në SPE për vitin 2020 me vitin 2021		
Viti	2020	2021
Numri i Procedurave	4,568	4078
Vlera totale Fondi limit	160,563,346,248	189,155,455,459
Vlera totale e Prokuruar	147,745,950,000	178,422,510,498

Në grafikun e mëposhtëm, jepen të dhënat statistikore në lidhje me njoftimet e fituesve të 2021 krahasuar me 2020.

Grafiku 12




Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, paraqiten numri i njoftimeve të fituesve të publikuara Sistemin e Prokurimit Elektronik, në mënyrë të detajuar, respektivisht në periudhën Janar – Dhjetor 2021 dhe Janar – Dhjetor 2020, sipas muajve.

Tabela 16

Krahasime Numri i njoftim fituesve te publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik Viti 2020 me Vitin 2021		
Viti	2020	2021
Janar	186	298
Shkurt	166	316
Mars	248	430
Prill	296	595
Maj	451	406
Qershor	457	346
Korrik	432	247
Gusht	418	246
Shtator	457	278
Tetor	497	267
Nentor	451	298
Dhjetor	509	351
Totali	4568	4,078

Grafiku 13





Grafiku 14



Sikurse vërehet nga të dhënat e mësipërme, gjatë vitit 2021 numri më i madh i njoftimeve të fituesve është publikuar gjatë 6 muorit të I-rë të vitit. Kjo lidhet me rritjen e numrit të njoftimeve të kontratave të publikuara në fund të vitit 2020 për të plotësuar nevojat e vitit 2021. Këto të dhëna janë tregues në rritje të performancës së sistemit të prokurimit në përgjithësi, që reflekton përmirësim të planifikimit të procedurave dhe realizimit të tyre në kohë.

2.3.5.4 STATISTIKA MBI KRITERET E PARASHIKUARA NGA LIGJI PËR VLERËSIMIN E OFERTËS FITUESE PËR PROCEDURAT TË FINALIZUARA ME NJOFTIM FITUESIT GJATË 2021

Miratimi i legjislacionit të ri të prokurimit solli një ndryshim të rëndësishëm sa i takon kriterit të vlerësimit, duke përcaktuar si kriter bazë ofertën ekonomikisht më të favorshme, e cila mund të identifikohet në bazë të çmimit (çmimi më i ulët) ose në bazë të kostos (bazuar në raportin çmim-cilësi).

APP ka analizuar përdorimin e kriterit të mësipërm për vlerësimin e ofertës fituese gjatë vitit 2021 të dhënat e kësaj analize pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 17

Statistika Procedura fituar me oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto Viti 2021							
Nr.	Emërtimi	Nr. Procedura / Lote	Fondi limit Leke pa TVSH	Fondi Prokuruar Leke pa TVSH	% Numrit të procedurave përkatëse ndaj totalit	% Fondit Limit përkatës ndaj totalit	% e vlerës përkatëse të fituar ndaj totalit
1	Procedura te fituara me oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto viti 2021	242	87,740,789,642	83,762,521,783	5,9%	46,4%	46,9%
2	Procedura te fituara me oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët viti 2021	3836	101,414,665,817	94,659,988,715	94,1%	53,6%	53,1%
	TOTALI	4078	189,155,455,459	178,422,510,498	100%	100%	100%

Sikurse vërehet nga të dhënat e mësipërme, sa i takon numrit të procedurave të fituara për të cilat është përdorur oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto, kemi një rritje krahasuar me vitet e mëparshme, por gjithsesi, këto përbëjnë vetëm 5.9% të numrit total të procedurave të fituara.

Nga ana tjetër, në vlerë, në raport me fondin total të prokuruar këto procedura përbëjnë 46.4% të procedurave të fituara duke treguar se ky kriter është përdorur më tepër dukshëm në procedurat e prokurimit me vlera të konsiderueshme. Vlen të theksohet se në bazë të ligjeve në fuqi në procedurat që lidhen me procesin e rindërtimit dhe në disa procedura të tjera prokurimi është i detyrueshëm përdorimi i këtij lloji kriteri.

Tabela18

Lloji i procedurave me oferta ekonomikisht më të favorshme për vitin 2021	
Lloji i procedurës	Numri i procedurave
Sherbim konsulence	80
Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	2
E hapur mbi kufirin e lartë monetar	20
E hapur	16
E hapur e thjeshtuar	1
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	3
E kufizuar	120

Sikurse vërehet në tabelën e mësipërme numrin më të lartë të procedurave në të cilat si metodë vlerësimi është zgjedhur “Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto” e përbëjnë procedurat “E kufizuar” dhe “Shërbim konsulence”.




Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, paraqitet krahasimi i numrave dhe vlerat e fondit limit dhe të fituesve për procedurat e fituara me oferta ekonomisht më të favorshme, respektivisht në periudhën Janar – Dhjetor 2021 dhe Janar – Dhjetor 2020.

Tabela 19

Krahasime Procedura të fituara me oferta ekonomisht më të favorshme viti 2020 me vitin 2021		
Viti	2020	2021
Numri i Procedurave	100	242
Vlera totale Fondi limit	9,651,675,070	87,740,789,642
Vlera totale e Prokuruar	9,606,241,187	83,762,521,783

Grafiku 15



Krahasuar me vitin 2020, vihet re një rritje e përdorimit të kriterit të vlerësimit oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në kosto, e cila në vlerë është e konsiderueshme.

Konkretisht, në vitin 2021, numri i procedurave të fituara me oferta ekonomisht më të favorshme bazuar në kosto është 242 ose 5,9% ndaj totalit të procedurave të përfunduara me fitues, ndërsa në vitin 2020 numri i procedurave të fituara me oferta ekonomisht më të favorshme ishte 100 ose 2,18% ndaj totalit të procedurave të përfunduara me fitues.

Sa i takon vlerës, në vitin 2021, vlera e procedurave të fituara me oferta ekonomisht më të favorshme bazuar në kosto është 83,762,521,783 lekë ose 46,9% ndaj vlerës totale të shpallur fituese, ndërsa në vitin 2020 vlera e procedurave të fituara me oferta ekonomisht më të favorshme, ishte 9,606,241,187 lekë ose 6,50 % ndaj vlerës totale të shpallur fituese.

Një rritje e tillë vjen edhe si rezultat i ndryshimeve ligjore dhe përcaktimit në ligj të detyrimit të autoriteteve kontraktore për të përdorur ofertën ekonomisht më të favorshme si edhe për të përdorur, aty ku është e mundur, kritere që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, ciklin jetësor të produkteve etj duke i bërë ata më të ndërgjegjshëm për përfitimet që sjell përdorimi i këtij kriteri.

2.3.6 STATISTIKA PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA

Në këtë pjesë të raportit, do të pasqyrohen të dhënat respektive në lidhje me publikimin e njoftimeve të Kontratave të Nënshkruara dhe Marrëveshjet Kuadër në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe do të bëhet analiza e këtyre të dhënave.

Numri total i njoftimeve të kontratave të nënshkruara dhe marrëveshjet kuadër të procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2021 në sistemin e prokurimit elektronik publikuar në faqen zyrtare të APP është 4185 (742 kontrata më shumë se në vitin 2020 ku ishin 3443 kontratave të nënshkruara).

2.3.6.1 STATISTIKA MBI NUMRIN E NJOFTIMEVE TË KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA DHE MARRËVESHJEVE KUADËR GJATË VITIT 2021, SIPAS TIPIT TË KONTRATËS

Njoftimet e kontratave të nënshkruara dhe marrëveshjet kuadër sipas llojit të procedurave dhe tipit të kontratave paraqiten si më poshtë:


Tabela 20

Njoftime Kontratash të nënshkruara për Periudhën Janar-Dhjetor 2021					
Shërbime		Mallra		Punë publike	
Lloji i Procedurës	Numri kontrata të nënshkruara	Lloji i Procedurës	Numri kontrata të nënshkruara	Lloji i Procedurës	Numri kontrata të nënshkruara
Procedurë e Hapur	339	Procedurë e Hapur	596	Procedurë e Hapur	508
E hapur mbi kufirin e lartë monetar	41	E hapur mbi kufirin e lartë monetar	197	E hapur mbi kufirin e lartë monetar	10
Kërkesë për Propozim	438	Kërkesë për Propozim	717	Kërkesë për Propozim	251
E hapur e Thjesh-tuar	249	E hapur e Thjesh-tuar	406	E hapur e Thjesh-tuar	191
Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	96	Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	0	Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	0
E kufizuar (JO Rindërtim)	2	E kufizuar (JO Rindërtim)	0	E kufizuar (JO Rindërtim)	0
E kufizuar (Vetëm Rindërtim)	65	E kufizuar (Vetëm Rindërtim)	0	E kufizuar (Vetëm Rindërtim)	57
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar (JO Rindërtim)	18	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar (JO Rindërtim)	0	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar (JO Rindërtim)	0
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar (Vetëm Rindërtim)	0	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar (Vetëm Rindërtim)	1	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar (Vetëm Rindërtim)	3
TOTALI	1,248	TOTALI	1,917	TOTALI	1,020



Në diagramën e mëposhtme paraqitet, në %numri i njoftimeve të kontratave të nënshkruaradhe marrëveshjeve kuadër të ndara sipas tipit të kontratës, të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik për vitin 2021.

Grafiku 16



Nga të dhënat e pasqyruara më sipër, rezulton se numri më lartë i kontratave të nënshkruara dhe marrëveshjet kuadër deri më tani është tipi Mall me 1,917 kontrata ose 45.8 % të kontratave në total, më tej “Shërbime”, me 1,248 kontrata ose 29.8 % të totalit, si dhe “Punë publike”, me 1,020 kontrata ose 24.4 % të totalit.

2.3.6.2 STATISTIKA MBI NUMRIN E NJOFTIMEVE TË KONTRATAVE DHE MARRËVESHJEVE KUADËR TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2021, SIPAS LLOJIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT

Njoftimet e kontratave dhe marrëveshjeve kuadër të nënshkruara sipas vlerës totale dhe llojit të procedurës paraqiten si më poshtë:

Tabela 21

Të dhëna për procedurat e prokurimit të përfunduara me Kontrata të nënshkruara Viti 2021						
Llojet e procedurave	Numri i kontratave të nënshkruara	Fondi limittotal i prokuruar (vlera ne Leke pa TVSH)	Vlera totale e fituar (Kontraktuar) (vlera ne Leke pa TVSH)	% që ze vlera e fituar ndaj fondit limit të prokuruar	Fondi total i kursyer (vlera ne Lekepa TVSH)	% që ze fondi i kursyer ndaj fondit limit të prokuruar
Procedurë e Hapur	1,443	84,734,029,718	79,038,695,869	93,3%	5,695,333,849	6,7%
E hapur mbi kufirin e lartë monetar	248	58,602,455,429	54,338,125,398	92,7%	4,264,330,031	7,3%
Kërkesë për Propozim	1,406	4,234,912,270	3,764,584,840	88,9%	470,327,430	11,1%
E hapur e Thjeshtuar	846	2,857,293,390	2,518,909,247	88,2%	338,384,143	11,8%
Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	96	1,254,549,790	1,215,696,086	97,0%	38,853,704	3,0%
E kufizuar (JO Rindërtim)	2	197,649,165	197,649,165	-	-	-
E kufizuar (Vetëm Rindërtim)	122	13,942,536,181	13,840,337,658	99,3%	102,198,523	0,7%
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar (JO Rindërtim)	18	6,579,363,603	6,579,363,603	-	-	-
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar (Vetëm Rindërtim)	4	28,005,153,903	28,005,153,903	-	-	-
TOTAL	4,185	200,407,943,449	189,498,515,769	94,6%	10,909,427,680	5,4%

Siç vërehet nga të dhënat e analizuara në tabelat e mësipërme rezulton se, numri i kontratave dhe marrëveshjeve kuadër të nënshkruara , 4185 në total, është më i madh se numri i njoftimeve të fituesve 4078 në total, me një diferencë midis tyre prej 107 njoftimesh.



Fakti që numri i kontratave dhe marrëveshjeve kuadër të nënshkuara në vitin 2021 është më i madh se numri i njoftimeve të fituesve shpjegohet me faktin se shumë kontrata të shpallura fituese në vitin 2020, janë finalizuar me nënshkrim kontrate në vitin pasardhës 2021, sepse afati kohor nga ystem i shpalljes së fituesit deri në lidhjen e kontratës është 60 ditë dhe nga nënshkrimi i kontratës në hedhjen në ystem të njoftimit të kontratës së nënshkruar është 5 ditë.

Në tabelat e mëposhtme pasqyrohen të dhënat për numrin kontratave dhe marrëveshjeve kuadër të nënshkuara në vitin 2021, fondin limit përkatës, vlerat e kontraktuara dhe kursimi në vlerë absolute dhe në përqindje.

Tabela 22

Statistika Total të Kontratave dhe Marrëveshjeve Kuadër të Nënshkuara SPE Janar - Dhjetor 2021	
Nr.Total i Proç. te fituara	4185
Fondi total limit	200,407,943,449
Fondi total i prokuruar	189,498,515,769
% qe ze Fondi i prokuruar ndaj Fondit limit	94,6
Fondi total i kursyer	10,909,427,680
% qe ze Fondi i kursyer ndaj Fondit limit	5,4
TE DETAJUARA	
<u>Statistika per Marreveshjet Kuader te Nenshkuara Janar - Dhjetor 2021</u>	
Nr.Total i Proç.te fituara	1132
Fondi total limit	52,686,609,638
Fondi total i prokuruar	51,217,876,345
% qe ze Fondi i prokuruar ndaj Fondit limit	97,2
Fondi total i kursyer	1,468,733,293
% qe ze Fondi i kursyer ndaj Fondit limit	2,8
<u>Statistika vetem Kontrata Nenshkuara Janar - Dhjetor 2021</u>	
Nr.Total i Proç.te fituara	3053
Fondi total limit	147,721,333,812
Fondi total i prokuruar	138,280,639,424
% qe ze Fondi i prokuruar ndaj Fondit limit	93,6
Fondi total i kursyer	9,440,694,388
% qe ze Fondi i kursyer ndaj Fondit limit	6,4

Në një vështrim të përgjithshëm konstatojmë se Fondi i Kursyer për Marrëveshjet Kuadër në vlerën 1,468,733,293 lekë ose 2,8 % ndaj fondit limit të Marrëveshjeve Kuadër, është më i ulët se Fondi i Kursyer për kontratat e nënshkuara që janë në vlerën 9,440,694,388 lekë ose 6,4 % ndaj fondit limit për këto kontrata.

Nisur nga këto përqindje të kursimit të krijohet ideja se për kontratat e nënshkuara ka kursim mbi 2 herë më të lartë se Marrëveshjet Kuadër (2,8%).

Në fakt duhet të vemë në dukje se, në Marrëveshjet Kuadër, veçanërisht për ato me kohëzgjatje mbi 1 vit, për efekte statistikore, vlera e prokuruar njehsohet me fondin limit. Kjo ndodh sepse për 1(një) Marrëveshje Kuadër gjatë zbatimit të saj nënshkruhen disa minikontrata dhe vlera e saktë e Marrëveshjes Kuadër përllogaritet në fund të afatit përfundimtar që mund të jetë nga 1(një) në 4(katër) vjet.

Nga ana tjetër, në lidhje me kursimin, përdorimi i Marrëveshjeve Kuadër ka avantazh, sepse duke përdorur minikontratat, Autoritetet Kontraktore shmangin stoqet dhe skadimin e produkteve, si në rastin e medikamenteve, përcaktohen me saktësi materialet që përdoren në riparime e mirëmbajtje si edhe garantojnë cilësi të lartë në furnizimet e mallrave dhe shërbimeve.


2.3.6.3 STATISTIKA MBI NUMRIN E NJOFTIMEVE TË KONTRATAVE DHE MK TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2021, KRAHASUAR ME VITIN 2020

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, jepen të dhënat statistikore në lidhje me njoftimet e kontratave të nënshkruara dhe marrëveshjet kuadër për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.

Tabela 23

Krahasime Njoftime Kontrata të Nënshkruara Viti 2020 me Vitin 2021		
Viti	2020	2021
Numri i Kontratave	3,443	4185
Vlera totale Fondi limit	111,036,805,434	200,407,943,449
Vlera totale e Prokuruar	99,777,519,978	189,498,515,769

Grafiku 17



Sa më sipër, vlen të theksohet fakti se në vitin 2021 janë nënshkruar 742 kontrata dhe marrëveshje kuadër më shumë se në vitin 2020. Gjithashtu fondi limit dhe vlera e kontratave të nënshkruara dhe marrëveshjet kuadër në vitin 2021 është shumë më e lartë se në vitin 2020.

Rritja e numrit dhe e vlerës së kontratave dhe marrëveshjeve kuadër të nënshkruara në vitin 2021 shpjegohet me faktin se shumë kontrata të procedurave të filluara në vitin 2020, janë finalizuar me nënshkrim kontrate në vitin pasardhës 2021, sepse afati kohor nga momenti i shpalljes së fituesit deri në lidhjen e kontratës është 60 ditë.



Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, paraqiten krahasimi i numrit të njoftimeve të kontratave dhe marrëveshjeve kuadër të nënshkuara, të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik, në mënyrë të detajuar, respektivisht për periudhën Janar-Dhjetor, viti 2020 me vitin 2021.


Tabela 24

Krahasime Numri i njoftim i lidhjes së kontratës të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik Viti 2020 me Vitin 2021		
Viti	2020	2021
Janar	236	381
Shkurt	151	487
Mars	142	384
Prill	206	499
Maj	255	456
Qershor	310	428
Korrik	319	245
Gusht	278	207
Shtator	333	250
Tetor	383	265
Nentor	386	265
Dhjetor	444	318
Totali	3443	4185

Grafiku 18



Grafiku 19



Sikundër në rastin e njoftimeve të fituesit, edhe në rastin e kontratave dhe MK të nënshkruara, rezulton se numri më i madh i njoftimeve për lidhjen e kontratës është publikuar në 6 mujorin e parë të vitit, kjo për arsye të rritjes së numrit të publikimeve në fund të vitit 2020, duke konfirmuar edhe njëherë përmirësimin e sistemit të prokurimit dhe rritjen e performancës së sistemit të prokurimit publik në përgjithësi.

2.3.7 STATISTIKA MBI PËRQINDJEN E KURSYES NGA PROCEDURAT E KRYERA NË SISTEMIN ELEKTRONIK

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik të zhvilluara në sistemin elektronik (pa përfshirë negociimet pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës) gjatë vitit 2021, fondin limit përkatës, numrin e procedurave të anuluar, numrin e procedurave të vazhduara, numrin e procedurave të fituara me fondin limit dhe fondin e ofruar përkatës, si dhe kursimin në përqindje.

Tabela 25

Procedura prokurimi të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik në periudhën VITI 2021	
Numri Total i procedurave të publikuara	5079
Fondi total limiti procedurave të publikuara (vlera në lekë)	149,320,420,249
Numri Total i procedurave të papërfundura (anulluar, etj)	1042
Fondi total limiti i procedurave të papërfundura (anulluar, etj) (vlera në lekë)	18,620,051,244
Numri Total i procedurave të cilat kanë vazhduar	4037
Fondi total limiti i procedurave të cilat kanë vazhduar (vlera në lekë)	130,700,369,005
Numri Total i Procedurave të fituara	4078
Fondi total limiti i procedurave të fituara (vlera në lekë)	189,155,455,459
Vlera totale e fituar (vlera në lekë)	178,422,510,498
% që zë Vlera totale e fituar ndaj Fondit total limit të procedurave të fituara	94.3%
Fondi total i kursyer (vlera në lekë)	10,732,944,961
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit total limit të procedurave të fituara	5.7%

Sqarojmë se numri dhe fondi limit i procedurave të fituara në vitin 2021 është më e lartë se numri dhe fondi limit i procedurave të publikuara dhe të vazhduara, për faktin se në vitin 2021 ka vazhduar shpallja e fituesve për procedurat e publikuara në vitin 2020.




2.3.8 STATISTIKA MBI NUMRIN E ANULLIMEVE TË PROCEDURAVE MBI KUFIRIN MONETAR PËR PROKURIMET ME VLERË TË VOGËL GJATË VITIT 2021

Nga të dhënat e pasqyruara më sipër, rezulton se në vitin 2021, nga 5079 procedura të shpallura për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, 1042 janë anuluar me vlerë 18,620,051,244 lekë, ndërkohë që në vitin 2020 numri total i procedurave të anuluar ishte 1490 procedura me vlerë 24,952,656,712 lekë.

Pra, siç vërehet numri dhe vlera e procedurave të anuluar në vitin 2021 është më i ulët se numri dhe vlera e procedurave të anuluar në vitin 2020. E shprehur kjo në përqindje rezulton se në vitin 2021 numri i procedurave të anuluar është 30% më pak se në vitin 2020.

Grafiku 20




Nga analizimi i të dhënave rezulton se 395 procedura të anuluar janë lote, të cilat zënë në total 38% të anulimeve të procedurave të shpallura. Përqindja që zënë procedurat e anuluar në raport me publikimet të detajuara me dhe pa lote, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 26

Lloji procedurës së publikuar në sistem	Numri
i	3606
Procedura prokurimi pa lote të publikuara, të anuluar	647
% që zë numri i procedurave pa lote të anuluar ndaj numri të procedurave të prokurimit të publikuara pa lote	17.9 %
Procedura prokurimi me lote të publikuara	1473
Procedura prokurimi me lote të publikuara, të anuluar	395
% që zë numri i procedurave me lote të anuluar ndaj numrit të procedurave të prokurimit të shpallura me lote	26,8 %

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet në % anulimi i procedurave sipas mënyrës së shpalljes në sistem procedura me lote/ pa lote per vitin 2021:

Grafiku 21



Sa më sipër, vërehet se lotet e anuluar zënë një përqindje më të lartë të numrit të procedurave me lote, të shpallura në sistem.

Nga analizimi i objekteve të procedurave të anuluar rezulton se, mbi 57% të anulimeve të procedurave me lote i takojnë procedurave për blerje të medikamenteve dhe materialeve të shërbimit shëndetësor, ku kryesisht janë anuluar ato lote që prokurohen për sasi me vlera të vogla të medikamenteve. Një pjesë e konsiderueshme e procedurave të anuluar i takon edhe shërbimit të transportit për mësues dhe nxënës.

Gjithashtu, rreth 52 procedura/lote janë të anuluar para afatit të fundit për hapjen e ofertave, të cilat përbëjnë rreth 5% të anulimeve në total. Këto anulime vijnë kryesisht nga gabimet në plotësimin/kryerjen e hapave të procedurës në sistem nga autoritetet kontraktore, ose nga ndryshimi i prioriteteve në punën e autoriteteve kontraktore.

Megjithëse numri i procedurave të anuluar në vitin 2021 ka ardhur në ulje, duhet të vijojë puna me Autoritetet Kontraktore që të marrin masa për të shmangur sa më shumë problematikat që çojnë në anulimin e procedurave të prokurimit, me qëllim rritjen e efikasitetit të procesit.

Nga analizimi i të dhënave rezulton se, sipas përcaktimeve të kryera në sistemin e prokurimit elektronik, nga vete autoritetet kontraktore në lidhje me anulimet për procedurat e publikuara konkurruese sipas arsyeve ligjore të përcaktuara në legjislacion:




Tabela 27

Arsyeja e Anullimit të deklaruar në sistem për procedurat e anuluar për prokurimet mbi kufirin monetar për procedurat me vlerë të vogël	Numri i procedurave të anuluar
Asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit	191
Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin e procedurës,	21
Në fazën e parë të procedurës së kufizuar dhe me negociim me shpallje paraprake të njoftimit kualifikohen më pak se 2 kandidatë	3
Nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore	128
Për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik	691
Të gjitha ofertat e paraqitura përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar	8
TOTALI	1042

Sikurse vërehet numri më i madh anulimeve, është me arsyen “Për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit” me 691 anulime, vazhdon me 191 anulime me arsyen “Asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit”, dhe më tej vazhdon me 128 anulime me arsyen “Nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore”. Sikurse e theksuam më sipër shumë anulime i takojnë kryesisht procedurave për blerje të medikamenteve dhe materialeve të shërbimit shëndetësor.

Grafiku 22



2.4 TË DHËNA MBI PROCEDURAT E PROKURIMIT ME NEGOCIM PA SHPALLJE PARAPRAKE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS

Procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sikurse parashikuar në nenin 47 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” mund të përdoret nga Autoritetet Kontraktore për plotësimin e nevojave të tyre vetëm në raste përjashtimore, në rrethana të veçanta dhe vetëm nëse plotësohen kushtet e parashikuara në këtë nen.


Kjo procedurë prokurimi zhvillohet me mjete elektronike në përputhje me nenin 17 të ligjit 162/2020 dhe VKM Nr. 384, datë 30.06.2021 “Për formën e komunikimit në procedurat e prokurimit publik”.

Në këtë seksion analizohet në mënyrë të detajuar përdorimi i kësaj lloji procedure në vitin 2021 në raport me procedurat e tjera si edhe në raport me vitet e tjera.

Konkretisht, sikurse rezulton nga të dhënat e SPE, numri total i procedurave të prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, të zhvilluara gjatë vitit 2021 është **143** ose 3,4%, i numrit total (procedura të tjera+negocim pa shpallje) të procedurave të përfunduara me fitues nga 416 të tilla të realizuara në vitin 2020.

Në grafikun e mëposhtëm jepen të dhënat krahasimore të numrit të procedurave të fituara me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës (**143 procedura**) ndaj numrit total të procedurave të prokurimit të përfunduara me fitues (**4221 procedura**) (procedura të tjera+negocim pa shpallje).

Grafiku 23





Nërkohë sa i përket vlerës së prokuruar me procedurën me negociim pa shpallje, kjo vlerë është 3,3% në raport me vlerën e prokuruar (procedura të tjera+negocim pa shpallje).

Grafiku 24



Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.

Tabela 28

Krahasime Procedurat e prokurimit negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës Viti 2020 me Vitin 2021		
Viti	2020	2021
Numri i Procedurave	416	143
Vlera totale Fondi limit	6,260,950,869	6,512,211,253
Vlera totale e Prokuruar	5,984,577,084	6,463,162,957

Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës të detajuar sipas tipit të kontratës, për vitin 2021.

Tabela 29

Procedura e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës Janar – Dhjetor 2021		
Tipi i kontratës:	Nr.	Fondi Prokuruar
Shërbime	46	1,516,023,836
Mallra	75	3,070,758,869
Punë	22	1,876,380,252
TOTALI	143	6,463,162,957

Në tabelën e mëposhtme paraqiten procedurat e prokurimit negociime pa shpallje te paraprake të detajuar sipas Bazës ligjore të përdorur nga autoritetet kontraktore:

Tabela 30

Detajimi i Procedurave me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës sipas Bazës Ligjore të përdorur				
Emërtimi	Numri i Procedurave të detajuara sipas Bazës Ligjore	% e Numrit të Procedurave të detajuara sipas Bazës Ligjore ndaj Totalit	Fondi limit detajuar sipas Bazës Ligjore	% e Fondit limit detajuar sipas Bazës Ligjore ndaj Totalit
Në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme të hapura ose të hapura të thjeshtuara nuk është paraqitur asnjë ofertë (Neni 47/1a)	3	2,2%	7,894,141	0,1%
Të drejta ekskluzive ose të drejtë autori (Neni 47/1b)	11	7,7%	37,148,409	0,6%
Nevoja ekstreme shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme (Neni 47/1c)	116	81,1%	4,724,903,400	72,6%
Lëvrime shtesë nga furnizuesi i mëparshëm (Neni 47/4)	13	9,0%	1,742,265,303	26,7%
TOTALI	143	100,0%	6,512,211,253	100,0%

Të dhënat në lidhje me numrin e kontratave të nënshkruara sipas procedurave me negociim pa shpallje paraprake të realizuara sipas muajve për vitin 2021, paraqiten si më poshtë:

Tabela 31


Njoftime kontratash të nënshkruara për procedurat me negociim pa shpallje paraprake VITI 2021			
Muaji	Numri i procedurave	Fondi limit (vlera në lekë pa TVSH)	Vlera e kontratës (në lekë pa TVSH)
Janar	15	24,226,583	24,072,077
Shkurt	15	45,112,568	44,539,919
Mars	12	125,892,509	125,297,610
Prill	39	4,544,568,930	4,537,098,932
Maj	13	69,135,295	68,529,221
Qershor	9	103,084,266	102,030,474
Korrik	4	114,670,902	114,091,228
Gusht	3	27,817,447	21,744,824
Shtator	8	79,302,262	78,708,560
Tetor	8	137,143,684	136,339,787
Nëntor	6	1,179,242,627	1,153,400,120
Dhjetor	11	62,014,180	57,310,205
TOTAL VITI 2021	143	6,512,211,253	6,463,162,957



Sikundër vërehet nga të dhënat e mësipërme numri dhe vlerat më të larta të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit janë realizuar në periudhën Janar-Prill 2021.

Nga analizimi në kontekstin historik të të dhënave mbi numrin e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit, rezulton se ky numër për 4 vitet e fundit (2018-2021) është ulur në mënyrë drastike krahasuar me periudhën paraardhëse dhe në vitin 2021 shënohet numri më i ulët i këtyre lloj procedurave që nga viti 2010.

Grafiku 25



Vlen të theksohet se, minimizimi i rasteve të përdorimit të procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës gjatë 4 viteve të fundit, është rezultat i ndërgjegjësimit të autoriteteve kontraktore.

Ky ndryshim pozitiv ka ardhur edhe si rezultat i automatizimit të procesit, duke e zhvilluar procedurën në SPE, duke filluar që nga krijimi i regjistrit, njoftimi i Operatorëve Ekonomikë, ofertimi, vlerësimi, dërgimi i mesazheve për kualifikimin, shpalljen e fituesit dhe publikimin online të njoftimit të lidhjes së kontratës.

Zhvillimi i kësaj procedure prokurimi në sistemin e prokurimit elektronik, që nga pasqyrimi në zërin përkatës të regjistrit të parashikimeve, ku autoritet kontraktore duhet të përshkruajnë edhe arsyet që detyrojnë përzgjedhjen e kësaj procedure sipas kushteve ligjore, ka rritur përgjegjësinë e këtyre të fundit në këtë drejtim.

Gjithashtu, ndikim kanë patur edhe rekomandimet dhe njoftimet e vazhdueshme nga Agjencia e Prokurimit Publik që të merren masat për publikimin e procedurave konkurruese në kohë, mundësisht Marrëveshje Kuadër për shërbime/mallra të vazhdueshme, pikërisht që autoritet kontraktore të mos gjenden pa shërbim/mall në fillim vitit.

Përsa i përket, të dhënave në lidhje me numrin e kontratave të nënshkruara me procedurën me negociim pa shpallje paraprake, ato ndahen në kategoritë kryesore si më poshtë:

Tabela 32

Negocime pa shpallje të perfunduara ne SPE , Viti 2021 duke detajuar 1.Kontratat per COVID - 19, 2.Pune emergjente, 3.Kontrata te KQZ, 4.Te tjera						
Lloji i procedurës	Nr	% ndaj totalit te Numrave te procedurave	Fondi limit	% ndaj totalit te Fondit Limit	Fondi Prokuruar	% ndaj totalit te Fondit Prokuruar
Kontrata per Covid-19	9	6,3%	47,900,207	0,7%	46,502,640	0,7%
Kontrata pune Emergjente	9	6,3%	97,050,010	1,5%	96,651,757	1,5%
Kontrata te KQZ	23	16,1%	2,904,748,191	44,6%	2,898,935,599	44,8%
Kontrata te tjera	102	71,3	3,462,512,845	53,2%	3,421,072,961	53,0%
TOTAL	143	100.0%	6,512,211,253	100.0%	6,463,162,957	100.0%

Sikurse vërehet nga tabela e mësipërme, gjatë vitit 2021 ka një ulje të ndjeshme të përdorimit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e shkaktuar nga COVID-19, dhe konkretisht këto kontrata zenë 0,7% të fondit total të shpenzuar për procedurat me negociim pa shpallje.

2.5 TË DHËNA MBI PROCEDURAT E PROKURIMIT TE KRYERA GJATE VITIT 2021 NË KUADËR TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR SHKAK TË TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Në mbështetje të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, edhe gjatë vitit 2021 autoritetet kontraktore përgjegjës (njësitë zbatuese), kanë zhvilluar procedurat e prokurimit për përzgjedhjen e fituesve të marrëveshjes kuadër për procesin e rindërtimit në sistemin e prokurimit publik.

Procedura e prokurimit e përdorur nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, është e Kufizuar dhe e Kufizuar mbi kufirin e lartë monetar, sepse keto procedura jane me afate të pritjes se ofertave me te shkurtra se procedurat e tjera, por janë të domosdoshme në procesin e rindërtimit të objekteve të dëmtuar nga tërmeti i datës 26.11.2019.

Nga të dhënat e analizuar nga sistemi i prokurimit elektronik dhe nga Buletinet e Posaçme, rezulton se:

Numri total i njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2021 në sistemin e prokurimit elektronik, në kuadër të procesit të rindërtimit për shkak të Tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, sipas tipit të kontratës, shërbim, mallra, punë është 145 procedura me fond limit 19,378,915,460 lekë pa TVSH.

Nga 145 njoftime të kontratave të publikuara, 13 procedura me fond limit 2,359,430,722 lekë pa TVSH janë anuluar, ndërsa 132 procedura me fond limit 17,019,484,738 lekë pa TVSH kanë vazhduar. Duke qenë se procedurat e anuluar janë përsëritur nga fillimi me të njëjtin fond limit, në këtë analizë do të trajtojmë vetëm procedurat e vazhduara.



Konkretisht, numri i procedurave që kanë vazhduar sipas tipit të kontratave paraqitet si më poshtë:

Tabela 33

Njoftime Procedurash të vazhduara Viti 2021					
Shërbime		Mallra		Punë publike	
Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve procedura	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve procedura	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve procedura
E kufizuar	65	E kufizuar	-	E kufizuar	64
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	-	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	1	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	2
TOTALI	65	TOTALI	1	TOTALI	66

Në tabelën e mëposhtme paraqitet fondi limit total për procedurat që kanë vazhduar sipas tipit të kontratave:

Tabela 34

Fondi limit total			Tipi i kontratës		
Lloji i procedurës	Nr procedura /lote	Fondi limit total	Shërbime	Mallra	Punë publike
E kufizuar	129	13,407,988,643	707,151,792	-	12,700,836,851
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	3	3,611,496,095	-	927,542,378	2,683,953,717
TOTALI	132	17,019,484,738	707,151,792	927,542,378	15,384,790,568

Njoftimet e kontratave për procedurat e prokurimit në kuadër të procesit të rindërtimit janë publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, por gjithashtu, janë publikuar edhe në Buletinet e Posaçme të publikuara për vitin 2021.

Ndërkohë, publikimi i njoftimeve të fituesit dhe i kontratave të nënshkruara është bërë në rrugë shkresore dhe janë publikuar vetëm në Buletinet e Posaçme, konkretisht në 140 Buletinet e Posaçme të publikuara për vitin 2021.

Nga 132 procedura me fond limit 17,019,484,738 lekë që kanë vazhduar, deri në datën 31.12.2021 janë konkretizuar me kontrata të nënshkruara 126 procedura, ndërsa procedurat e tjera janë në fazën e dorëzimit dhe vlerësimit të ofertave, të cilat do të vazhdojnë edhe në vitin 2022.

2.6 MARRËVESHJET KUADËR

Gjatë vitit 2021, autoritetet kontraktore kanë vijuar të përdorin procedurat e prokurimit për Marrëveshje Kuadër, kryesisht për mallra dhe shërbime të vazhdueshme.

Konkretisht, të dhënat në lidhje me përdorimin e këtij instrumenti, paraqiten si më poshtë:

Tabela 35

Publikime Marrëveshje Kuadër të vazhduara Janar-Dhjetor 2021		
Lloji i procedurës	Numër	Fondi total Limit i prokuruar (leke pa TVSH)
Procedure e Hapur	285	10,145,319,520
E hapur mbi kufirin e lartë monetar	45	7,610,686,580
Kërkesë për Propozim	198	683,077,678
E Hapur eThjeshtuar	210	918,600,451
Shërbim Konsulence	6	661,971,750
I Kufizuar (Jo Rindërtim)	6	770,879,530
I Kufizuar (Rindërtim)	120	15,403,754,563
I Kufizuar mbi kufirin e lartë monetar (Rindërtim)	3	3,611,496,095
TOTAL	873	39,805,786,167

Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me publikimet e Marrëveshjeve Kuadër që kanë vazhduar në sistem për vitin 2021.

Tabela 36

Marrëveshje Kuadër që kanë vazhduar Janar - Dhjetor 2021	Numri i procedurave (jo Lote)	Fondi limit total
Shërbime	289	7,906,878,070
Mallra	347	11,267,578,871
Punë publike	66	15,782,459,633
TOTAL	702	34,956,916,575



Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me publikime Marrëveshje Kuadër për vitin 2021, krahasuar me publikime Marrëveshje kuadër të vitit 2020.

Tabela 37

Krahase Publike Marrëveshje Kuadër Janar - Dhjetor		
Viti	2020	2021
Numri i Procedurave	677	702
Vlera totale Fondi limit	39,427,842,228	34,956,916,575

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat krahasuese të vitit 2021, me të dhënat e vitit 2020, respektivisht në numër dhe në vlerë.

Grafiku 26



Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me publikimet Marrëveshje Kuadër të finalizuara me njoftim fituesi në sistem për vitin 2021.

Tabela 38

Procedura prokurimi Marrëveshje Kuadër të finalizuara me fitues Viti 2021						
Lloji procedurës	Numri Proedurave	Fondi limit total (vlera në Lekë)	Fondi total i ofruar (vlera në Lekë)	% që ze fondi i ofruar ndaj fondit limit të prokuruar (vlera në Lekë)	Fondi total i kursyer	% që ze fondi i kursyer ndaj fondit limit të prokuruar
Procedurë e Hapur	273	11,376,727,667	10,510,221,036	92,4%	866,506,631	7,6%
E Hapur mbi kufirin e lartë monetar	31	9,982,835,213	9,515,624,969	95,3%	467,210,244	4,7%
Kërkesë për Propozim	192	707,505,915	606,481,961	85,8%	101,023,954	14,2%
E Hapur e Thjeshtuar	126	552,972,503	482,400,043	87,2%	70,572,460	12,8%
E Kufizuar (Jo Rindërtim)	1	48,826,042	48,826,042	0	0	0
E Kufizuar (Rindërtim)	117	13,224,346,439	13,125,872,103	99,3%	98,474,336	0,7%
E Kufizuar mbi kufirin e lartë monetar (Rindërtim)	2	8,716,203,289	8,716,203,289	0	0	0
TOTAL	742	44,609,417,069	43,005,629,444	96,4%	1,603,787,625	3,6%

Diferenca midis numrit të procedurave të shpallura me ato të përfunduara me njoftim fituesi në sistem, shpjegohet me argumentin se shumë procedura të publikuara në vitin 2020, kanë vazhduar me shpalljen e fituesit apo me lidhjen e Marrëveshjeve Kuadër në vitin pasardhës.

Lidhur me përqindjen “në dukje të ulët” të kursimit të fondit limit të evidentuar tek procedura “E Hapur mbi Kufirin e lartë monetar”, sikurse e kemi sqaruar edhe më sipër në procedurën e prokurimit “Marrëveshja Kuadër”, për efekte statistikore, vlera totale e fituar, përlllogaritjet e njëjtë me Fondin limit total të publikuar. Kjo për arsye se “Marrëveshjet Kuadër” shoqërohen me një numër të madh minikontratash sipas nevojave të autoriteteve kontraktore, ku gjatë minikonkurseve çmimet mund të ulen edhe më shumë. Gjithashtu, theksojmë se jo detyrimisht e gjithë vlera e Marrëveshjes Kuadër ezaurohet.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të dhënat statistikore në lidhje me Marrëveshje Kuadër të përfunduara me njoftim fituesi në sistem për vitin 2021, krahasuar me Marrëveshje Kuadër të përfunduara me njoftim fituesi në sistem për vitin 2020.




Tabela 39

Procedura prokurimi Marrëveshje Kuadër krahasuese të përfunduara me fitues Janar - Dhjetor		
Viti	2020	2021
Numri i Procedurave	696	742
Vlera totale Fondi limit	48,697,410,092	44,609,417,069
Vlera totale e Prokuruar	47,242,189,302	43,005,629,444

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelat e mësipërme, rezulton se numri total i procedurave Marrëveshje Kuadër të përfunduara me njoftim fituesi në sistemin e prokurimit elektronik është 742 (46 procedura Marrëveshje Kuadër më shumë krahasuar me vitin 2020 ku ishin 696 procedura perfshi edhe procedurat per termetin).

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat krahasuese të vitit 2021, me të dhënat e vitit 2020, respektivisht në numër dhe vlerë.

Grafiku 27



Përsa i përket minikontratave të nënshkruara në bazë të Marrëveshjeve kuadër, të aplikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik gjatë vitit 2021 rezultojnë të dhënat e mëposhtme:

Tabela 40

MINI Kontrata te referuara nga publikimet në SPE			
Viti 2020		Viti 2021	
Numri i Mini Kontratave	Vlera e Kontratave	Numri i Mini Kontratave	Vlera e Kontratave
803	1,586,177,832	2789	8,621,006,413

Të dhëna e trajtuara më lart janë një tregues konkret i punës dhe iniciativave të APP për të stimuluar përdorimin e Marrëveshjes Kuadër, si një instrument i rëndësishëm për përmbushjen e nevojave të vazhdueshme të autoriteteve kontraktore nëpërmjet procedurave transparente dhe konkurruese dhe, veçanërisht, në eliminimin e përdorimit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake.

Theksojme se në fund të vitit 2020 është bërë një përmiresim ne SPE, që mundëson hedhjen e të dhënave të minikontratave në sistemin e prokurimit elektronik gjatë gjithë periudhës së Marrëveshjes Kuadër.

2.7 PROCEDURAT E PROKURIMIT ME VLERË TË VOGËL

Sipas parashikimeve në legjislacionin e ri të prokurimit, Autoritetet Kontraktore përdorin procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për të blerë mallra, shërbime dhe punë, vlera e përlogaritur e të cilave gjatë gjithë vitit kalendarik është nga 100.000 lekë deri në 1.000.000 lekë pa t.v.sh.

Nërkohë, legjislacioni i mëparshëm parashikonte që kufiri monetar për prokurimet me vlerë të vogël ishte nga 100.000 lekë në 800.000 lekë. Pavarësisht se parashikimet e reja kanë filluar të zbatohen nga muaji Qershor 2021, në këtë analizë janë paraqitur të dhënat e plota për të gjitha procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, pavarësisht kufirit monetar sikundër janë të paraqitura në SPE.

Nga analizimi i të dhënave, rezulton se numri i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara gjatë vitit 2021 dhe fondet përkatëse, paraqiten si më poshtë:

Tabela 41

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël Janar-Dhjetor 2021	
Numri Total i procedurave të Prokurimit me Vlerë të Vogël të publikuara për vitin 2021	15988
Fondi total limit i publikuar për procedurat e prokurimit me Vlerë të Vogël (vlera në lekë)	5,548,395,446
Numri Total i Procedurave të papërfundura (anulluar, etj)	3692
Numri Total i procedurave të Prokurimit me Vlerë të Vogël të përfunduara me njoftim fituesi	12249
Fondi total Limit për procedurat e prokurimit me Vlerë të Vogël të përfunduara me njoftim fituesi (vlera në lekë)	4,348,492,512
Vlera totale e fituar në procedurat e prokurimit me Vlerë të Vogël të përfunduara me njoftim fituesi (vlera në lekë)	3,750,454,014
% që zë vlera totale e fituar ndaj Fondit total limit të procedurave të përfunduara me fitues	86,2%
Fondi total i kursyer (vlera në lekë)	598,038,498
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit total limit të procedurave të përfunduara me fitues	13,8%

Numri dhe vlerat e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara gjatë vitit 2021 dhe krahasimi me ato të vitit 2020, paraqiten në tabelën më poshtë.

Po të krahasojmë numrin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të përfunduara me fitues në vitin 2021 (12249), me numrin respektiv në vitin 2020 (12412), rezulton se gjatë vitit 2021 në numër janë përfunduara më pak procedura me fitues.

Tabela 42

Procedura Prokurime me Vlerë të Vogël përfunduara me Fitues Krahasime Viti 2020 me Vitin 2021		
Viti	2020	2021
Numri i Procedurave prokurim me vlerë të vogël	12412	12249
Vlera totale Fondi limit	4,057,911,371	4,348,492,512
Vlera e Prokuruar	3,468,875,376	3,750,454,014
Vlera e kursyer	589,035,995	598,038,498



Një tregues tjetër shumë i rëndësishëm që rezulton nga të dhënat në tabela, është diferenca midis fondit me të cilin janë shpallur procedurat, me vlerën me të cilin janë fituar ato dhe konkretisht kursimi është 13,8%. Gjithashtu, kursimi në vlerë absolute 598,038,498 lekë i realizuar në vitin 2021, është pak më i lartë se kursimi prej 589,035,995 lekë i realizuar në vitin 2020, edhe pse numri i procedurave të përfunduara me fitues në vitin 2020 ka qenë më i lartë se në vitin 2021.

Këto të dhëna tregojnë se nga përmirësimet e herëpashërshme që i bëhen kësaj procedure në SPE, sigurohet konkureshmëri e lartë dhe e drejtë, duke sjellë në vëmendje se kjo është e vetmja procedurë ku nuk shfaqet fondi limit, me qëllimin për të synuar ofertën sa më të përgjegjshme nga operatorët ekonomikë.

Tabela 43

Anullime Procedura Prokurim me Vlerë të Vogël Krahasime Viti 2020 me Vitin 2021		
Viti	2020	2021
Numri i Procedurave	3105	3692
Vlera totale Fondi limit	862,380,495	1,183,870,057

Nga krahasimi i të dhënave të vitit 2021 dhe atyre respektive të vitit 2020, rezulton se numri i procedurave “prokurim me vlerë të vogël” të anuluar në vitin 2021 është 3692 anulime (me fond limit 1,183,870,057 lekë) ose 23% krahasuar me numrin total të publikimeve që janë 15988 procedura të publikuara.

Ky numër anulimesh është më i madh, krahasuar me ato të anuluar në vitin 2020 ku ishin 3105 anulime (me fond limit 862,380,495 leke) ose 20% në raport me numrin total të publikimeve që ishin 15580 procedura të publikuara.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm jepen anulimet e procedurave e prokurimit me vlerë të vogël sipas arsyeve ligjore të deklaruara (selektuar) në sistem nga autoritetet kontraktore:

Tabela 44

Nr.	Arsyeja e Anullimit	Numri i Procedurave të Anulluara
1	Asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit	115
2	Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të LPP	12
3	Nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore	152
4	Për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik	3217
5	Të gjitha ofertat e paraqitura përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar	196
Totali		3692

Grafiku 28



2.8 STATISTIKA NË LIDHJE ME PROCEDURAT E KRIJUARA NË SISTEMIN ELEKTRONIK

Numri total i procedurave të prokurimit të vijara me fitues, duke përfshirë edhe prokurimet me vlerë të vogël në Sistemin e Prokurimit Elektronik për vitin 2021, është 16327, të detajuara sipas tabelës së mëposhtme:


Tabela 45

Lloji i procedurës	Numri Total i Procedurave/ lote të elektroniketë përfunduara me fitues	Vlera totale e fituar në procedurat e prokurimit të përfunduara me njoftim fituesi (vlera në lekë)
Procedura Prokurimi konkurruese mbi kufirin monetar për procedurat me vlerë të vogël	4078	178,422,510,498
Prokurimit me Vlerë të Vogël	12249	3,750,454,014
Totali	16327	182,172,964,512




Në diagramën e mëposhtme tregohet raporti i numrit të prokurimeve me vlerë të vogël, ndaj procedurave të prokurimit mbi kufirin monetar për procedurat me vlerë të vogël ku, sikurse del edhe nga treguesit e analizuar më sipër, del qartë numri që zënë procedurat e prokurimit me vlerë të vogël ndaj procedurave të tjera.

Grafiku 29



Megjithatë, pavarësisht se në raportin në numër dominojnë procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, duhet theksuar se në raportin në vlerë, dukshëm dominojnë procedurat e prokurimit mbi kufirin monetar të procedurave me vlerë të vogël, duke qenë se raporti është në të kundërt; fondi i prokuruar me procedurë prokurimi me vlerë të vogël zë rreth 2%, kurse fondi i prokuruar me procedura të tjera zë rreth 98 %.

Grafiku 30



2.9 SISTEMI DINAMIK BLERJE BILETA TRANSPORTI AJROR NDËRKOMBËTAR

Autoritetet kontraktore përdorin Sistemin e thjeshtuar Dinamik të Blerjeve, si një mënyrë për të siguruar blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar. Ky sistem është i hapur për të gjithë operatorët ekonomikë, që janë të regjistruar në sistemin e prokurimit elektronik dhe që kanë si objekt të ushtrimit të aktivitetit të tyre, shërbimin e transportit ajror ndërkombëtar.

Sikurse është parashikuar në udhëzimin përkatës të APP, autoritetet kontraktore kanë zbatuar procedurën, duke marrë në konsideratë për realizimin e shërbimit për të gjithë operatorët ekonomikë të kualifikuar. Nga analizimi i të dhënave, numri i procedurave të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar të zhvilluara gjatë vitit 2021 dhe fondet përkatëse, krahasuar me 2020 paraqitet si më poshtë:

Tabela 46

Krahasime Sistemi dinamik blerje bileta të transportit ajror ndërkombëtar		
Viti	2020	2021
Numri Total i procedurave blerje e biletave të transportit ajror ndërkombëtar	518	861
Numri Total i Procedurave të papërfunduara (anulluar, etj)	57	124
Numri Total i procedurave blerje e biletave të cilat kanë perfunduar me fitues	461	735
Vlera totale e fituar në procedurat blerje e biletave të përfunduara me njoftim fituesi (vlera në lekë)	59,332,420	124,328,925

Siç vihet re, numri i procedurave blerje e biletave të transportit ajror ndërkombëtar të shpallur për vitin 2021, është më i madh krahasuar me vitin 2020, konkretisht kemi 343 procedura më shumë (për vitin 2020 janë shpallur 518 procedura).

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm jepen në % anulimet për sistemin dinamik, bileta të transportit ajror ndërkombëtar sipas arsyeve ligjore të deklaruar (selektuar) në sistem nga autoritetet kontraktore:

Tabela 47

Nr	Arsyeja e Anullimit	Numri i Procedurave të Anulluara
1	Asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit	1
2	Nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore	18
3	Për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik	99
4	Të gjitha ofertat e paraqitura përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar	6
Totali		124



Grafiku 31



2.10 STATISTIKA NË LIDHJE ME AUTORITETET KONTRAKTORE QË KANË KRIJUAR PROCEDURA NË SISTEMIN ELEKTRONIK DHE OPERATORËT EKONOMIKË FITUES

Numri total i autoriteteve kontraktore aktivë që kanë krijuar vetem procedura prokurimi me vlerë të vogël në Sistemin e Prokurimit Elektronik për vitin 2021 është 865 autoritete kontraktore, ndërsa numri i autoriteteve kontraktore që kanë krijuar procedura prokurimi mbi kufirin monetar për prokurime me vlerë të vogël është 415 autoritete kontraktore.

Tabela 48

Lloji i procedurës së prokurimit të shpallur në SPE	Numri i Autoriteteve Kontraktore
Autoritete Kontraktore që krijojnë vetëm procedura prokurimi me vlerë të vogël	865
Autoritete Kontraktore që krijojnë procedura prokurimi me vlerë mbi kufirin monetar për procedura me vlerë të vogël	415
Totali	1,280

Më poshtë paraqiten 10 autoritetet kontraktore që kanë shpallur më shumë procedura/loje me vlerë mbi kufirin monetar për procedura me vlerë të vogël gjatë vitit 2021:

Tabela 49

Nr.	Autoritetit kontraktor	Numri i procedurave/loje me fond mbi kufirin monetar për procedura me vlerë të vogël	Numri i Procedurave/Loteve të anuluar	Numri i Procedurave/Loteve të vijuar
1.	Qendra Spitalore Universitare NënëTereza,Tiranë	254	155	99
2.	Bashkia Shkodër	210	33	177
3.	Agjencia e Blerjeve të Përqendruara	187	61	126
4.	Spitali Universitar i Traumës	112	4	108
5.	Bashkia Elbasan	94	13	91
6.	Bashkia Tiranë	89	7	82
7.	Bashkia Durrës	85	17	68
8.	Spitali Sarandë	70	0	70
9.	Ministria e Mbrojtjes	67	9	58
10.	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	65	8	57

Më poshtë paraqiten 10 autoritetet që kanë shpallur më shumë procedura prokurimi me vlerë të vogël gjatë vitit 2021:

Tabela 50

Nr.	Autoriteti Kontraktor	Numri i Procedurave të publikuar në sistem	Numri i procedurave të anuluar	Numri i procedurave të vijuar
1	Bashkia Pukë	157	62	95
2	Bashkia Maliq	144	42	102
3	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik	120	30	90
4	SHISH Shërbimi Informativ i Shtetit	105	39	66
5	Bashkia Shkodër	100	16	84
6	Drejtoria Vendore e Policisë Durrës	91	34	57
7	Bashkia Tepelenë	90	8	82
8	Drejtoria Vendore e Policisë Dibër	83	16	67
9	Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	81	25	56
10	Bashkia Korçë	77	23	54



Gjithashtu, më poshtë paraqiten të dhëna Statistike për Operatorët Ekonomikë fitues të procedurave të zhvilluara në SPE për vitin 2021:

Tabela 51

Nr.	Emërtimi	Numër procedura / lote	Fondi limit Lekë pa TVSH	Vlera e Prokuruar Lekë pa TVSH	% e Numrit ndaj totalit	% e vlerës së fituar ndaj totalit
1	Procedura/lote të fituara nga Operatorë Ekonomikë të vetëm (jo Bashkim Operatorësh) viti 2021	3263	71,674,660,950	66,403,431,799	80,0%	37,2%
2	Procedura/lote të fituara nga Operatorë Ekonomikë të Huaj viti 2021	11	24,415,339,570	22,264,555,578	0,3%	12,5%
3	Procedura/lote të fituara nga Bashkim Operatorësh 2021	804	93,065,454,939	89,754,523,121	19,7%	50,3%
Totali		4,078	189,155,455,459	178,422,510,498	100,0%	100,0%

Sikurse vërehet nga të dhënat e mësipërme, vlera më e madhe e procedurave është fituar nga Bashkime operatorësh me 50.3% të vlerës së fituar ndërkohë që Operatorët ekonomikë të huaj kanë fituar 12.5% të vlerës.

Më poshtë paraqiten të dhëna Statistike për Operatorët Ekonomikë fitues për prokurimet me vlerë të vogël të zhvilluara në SPE për viti 2021

Tabela 52

Nr.	Emërtimi	Numër Operatorësh Ekonomikë	Nr. Procedura/Lote	Fondi limit Lekë pa TVSH	Fondi i Prokuruar Lekë pa TVSH
1	Operatorë Ekonomikë të vetëm (jo Bashkim Operatorësh) të shpallur fitues viti 2021	1695	12249	4,348,492,512	3,750,454,014

2.11 STATISTIKA NË LIDHJE ME OFERTAT E KRIJUARA NË SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK PËR VITIN 2021

2.11.1 TË DHËNA MBI NUMRIN MESATAR TË OFERTAVE TË DORËZUARA

Numri total i ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë në procedurat e shpallura në sistem nga Autoriteteve Kontraktore për vitin 2021 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 53

Lloji i Procedurës	Numri i procedurave	Numri Total i ofertave të dorëzuara	Mesatarja e Ofertave/kërkesave për pjesëmarrje
Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël	15988	157289	9.83
Sistem dinamik, bileta	861	3270	3.79
E hapur	1452	4220	2.89
E hapur mbi kufirin e lartë monetar	280	511	1.82
Kërkesë për Propozim	1340	3184	2.37
E Hapur e Thjeshtuar	1758	3389	1.92
E Kufizuar mbi kufirin e lartë monetar (+ rindërtim)	3	15	5
E Kufizuar (+ rindërtim)	142	858	6.92
Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	98	536	5.46
Totali	21922	173272	7.90

Sikundër vërehet nga tabela e mësipërme, procedurat me numrin më të madh të ofertave të dorëzuara janë procedurat me vlerë të vogël me 9.83 oferta të dorëzuara, ndërkohë që më pak oferta rezulton të jenë paraqitur në procedurat e hapura mbi kufirin e lartë monetar me 1.82 oferta.

Ndërkohë, sa i takon procedurave mbi kufirin monetar për procedurat me vlerë të vogël, rezulton se numri më i madh i ofertave është dorëzuar në procedurat e kufizuara, të cilat janë kryesisht procedura në kuadër të procesit të rindërtimit me 6.92 oferta të dorëzuara.

Në mënyrë të detajuar numri i ofertave të dorëzuara në procedurat e prokurimit mbi kufirin monetar për procedurat me vlerë të vogël, në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, si dhe në procedurat e prokurimit Sistem Dinamik, Blerje bileta të transportit ndërkombëtar, jepet në tabelat e mëposhtme, konkretisht:

Në tabelën e mëposhtme tregohet numrit i ofertave të dorëzuara në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin monetar të procedurave me vlerë të vogël, nga operatorët ekonomikë sipas llojit të procedurës:



Tabela 54

Lloji i Procedurës	Tipi i Kontratës	Numri i procedurave	Numri Total i ofertave të dorëzuara	Mesatarja e Ofertave
Shërbim Konsulencë dhe Konkurs Projektimi	Shërbime	98	536	5.46
E hapur mbi kufirin e lartë	Shërbime	61	125	2.04
E hapur mbi kufirin e lartë	Mallra	205	306	1.49
E hapur mbi kuf kufirin e lartë i	Punë	14	80	5.7
E hapur	Shërbime	344	640	1.86
E hapur	Mallra	672	1351	2.01
E hapur	Punë	436	2229	5.11
Kerkesë për Propozim	Shërbime	401	908	2.26
Kerkesë për Propozim	Mallra	702	1574	2.24
Kerkesë për Propozim	Punë	237	702	2.96
E hapur e thjeshtuar	Shërbime	449	912	2.03
E hapur e thjeshtuar	Mallra	995	1516	1.52
E hapur e thjeshtuar	Punë	314	961	3.06
E Kufizuar mbi kufirin e lartë	Punë	2	11	5.5
E Kufizuar mbi kufirin e lartë	Mallra	1	4	4
E Kufizuar	Shërbime	68	414	6.08
E Kufizuar	Punë	80	439	5.48
Totali		5079	12708	2.50

Në tabelën e mëposhtme, paraqitet mesatarja e dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin monetar të procedurave me vlerë të vogël sipas tipit të kontratës:


Tabela 55

Tipi i Kontratës	Numri i procedurave	Fondi limit	Numri total i ofertave të dorëzuara	Numri mesatar i ofertave
Mallra	2575	26,420,991,944	4751	1.84
Punë	1083	98,991,980,768	4422	4.08
Shërbime	1421	23,907,447,537	3535	2.48
Totali	5079	149,320,420,249	12708	2.50

Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, mesatarja më e lartë e ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë është në tipin e kontratave "Punë" që, sikurse vërehet nga grafiku i mëposhtëm, përbëjnë pjesën më të madhe të fondit total limit të shpallur (66%).

Grafiku 32

% e fondit limit sipas tipit të kontratave



Përsa i përket procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në tabelën e mëposhtme tregohet mesatarja e dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë, sipas tipit të kontratës:

Tabela 56

Lloji i Procedurës	Tipi i Kontratës	Numri i procedurave	Numri total i ofertave të dorëzuara	Numri mesatar i ofertave
Prokurim me vlerë të vogël	Mallra	11177	129399	11.5
	Shërbime	4400	24882	5.65
	Punë	411	3008	7.31
Totali		15988	157289	9.83

Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, mesatarja më e lartë e ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë është në tipet e kontratave "Mallra" dhe "Punë" të shpallura në sistem.

Përsa i përket Sistemit Dinamik, Blerje biletash të transportit ajor, në tabelën e mëposhtme tregohet mesatarja e dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë:

Tabela 57

Lloji i Procedurës	Tipi i Kontratës	Numri i procedurave	Numri total i ofertave të dorëzuara	Numri mesatar i ofertave
Sistem Dinamik, Blerje biletash të transportit ajor	Shërbime	861	3270	3.79

Ndërkohë, në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohen të dhënat mbi numrin mesatar të ofertave në raport me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor për vitin 2020, sikurse raportuar në Raportin e Vlerësimit për Reformën në Adiministratën Publike në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi të SIGMA-s:




Tabela 58

	Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Kosova	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbia
Mesatarja e ofertave të dorëzuara	2.57	2.05	4.8	2.27	3.6	2.6

Burimi: Raportet i monitorimit të SIGMA për reformën në administratën publike në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë për vitin 2021 dhe Analiza vjetore e APP për 2020

Grafiku 33



Burimi: Raportet i monitorimit të SIGMA për reformën në administratën publike në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi për vitin 2021 dhe Analiza vjetore e APP për 2020

Sikurse vërehet nga të dhënat e mësipërme, në raport me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria qendron diku në mes të klasifikimit pas Kosovës, e cila mban vendin e parë me një mesatare prej 4.8 ofertash dhe Maqedonisë së Veriut me 3.6. Ndërkohë, Serbia dhe Shqipëria janë në të njëjtin nivel dhe pas tyre vjen Mali i Zi dhe Bosnje Hercegovina.

Ndërkohë, numrin më të ulët të ofertave në rajon e ka Bosnje-Hercegovina me 2.05 oferta të dorëzuara.

2.11.2 TË DHËNA MBI PROCEDURAT E PROKURIMIT ME NJË OFERTË TË DORËZUAR

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat në lidhje me procedurat e prokurimit për të cilat është dorëzuar një ofertë dhe të finalizuara me fitues:

Tabela 59

Lloji i onetarys së prokurimit	Numri i procedurave me 1 ofertë të dorëzuar të finalizuara me njoftim fituesi/lidhje kontrate	Numri total i procedurave	% e procedurave me nje ofertë të dorëzuar ndaj numrit total të procedurave
Shërbim Konsulence	3	98	3%
E hapur mbi kufirin e lartë monetar	43	280	15%
E hapur	302	1452	21%
Kërkesë për Propozim	333	1340	26%
E hapur e thjeshtuar	346	1758	32%
E Kufizuar	2	148	1%
Totali	1029	5,076	20%

Sikundër rezultojnë nga të dhënat e nxjerra nga sistemi i prokurimit elektronik, numri i procedurave të prokurimit mbi kufirin onetary për procedura me vlerë të vogël, me një ofertë të dorëzuar dhe të finalizuara me njoftim fituesi është 1029, ose 20% e numrit total të procedurave të publikuara. Kjo vlerë duket në rënie krahasuar me rezultatin e vitit 2020, ku përqindja e procedurave të realizuara me një ofertë ka qenë në nivelin e 23%.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohen të dhënat në lidhje me procedurat e prokurimit me një ofertë të dorëzuar dhe të finalizuara me fitues në raport me disa nga vendet anëtare të Bashkimit Europian sikurse raportuar në OpenTender.eu për vitin 2020.


Tabela 60

Shteti	% e Procedurave të prokurimit me vetëm 1 ofertë të dorëzuar, viti 2020
Shqipëri	23%
Kroaci	35.43 %
Francë	4.27 %
Gjermani	13.21 %
Greqi	10.68 %
Bullgari	14.92%
Rumani	76.44 %
Austri	40.09 %
Slloveni	26.88 %
Belgjikë	7.39 %

Burimi: OpenTender.eu dhe Analiza vjetore e APP për 2020



Grafiku 34



Burimi: OpenTender.eu dhe Analiza vjetore e APP për 2020

Ndërkohë, përsa i përket procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse tregohet në tabelën e mëposhtme, numri i procedurave me një ofertë të dorëzuar dhe të finalizuara me njoftim fituesi është 858 ose 5% e numrit total të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të shpallura.

Tabela 61

Lloji i procedurës së prokurimit	Numri i procedurave me 1 oferte te dorëzuar te finalizuara me njoftim fituesi/lidhje kontrate	Numri total i procedurave	% e procedurave me nje oferte te dorëzuar ndaj numri total te procedurave
Prokurim me Vlerë të Vogël	858	15988	5%
Sistem Dinamik, Blerje bileta të transportit	30	861	3%

2.11 STATISTIKA NË LIDHJE ME NUMRIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES ME KONCESION/PPP GJATË VITIT 2021

Gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2021, janë hapur 4(katër) procedura koncesionare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, prej të cilave 2(dy) procedura koncesionare janë anuluar, ndërsa 2(dy) procedura koncesionare të tjera janë finalizuar me fitues.

Numri i procedurave për dhënie me koncesion/PPP, të shpallura për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik dhe njoftimet e fituesit gjatë vitit 2021, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 62

Procedura për dhënie me koncesion /PPP	Numri i procedurave	Vlera e Investimit
Njoftime Kontratash	4	
Njoftime Fituesish	3	167,152,917 Euro

Sqarojmë se një prej procedurave për dhënie me koncesion/PPP, është hapur në vitin 2019 dhe finalizuar me fitues në vitin 2021.

2.12 STATISTIKA PËR PROKURIMET NË FUSHËN E MBROJTJES DHE SIGURISË GJATË VITIT 2021

Në vijim të hyrjes në fuqi të ligjit 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë” dhe miratimit të legjislacionit dytësor, për herë të parë gjatë vitit 2021 janë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike njoftime kontratash për këto lloj procedurash.

Sikurse rezulton nga tabela e mëposhtme, në vitin 2021, janë publikuar 14 procedura në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, prej të cilave 5 procedura janë anuluar, 8(tetë) procedura kanë përfunduar me fitues dhe një procedurë është në vazhdim.

Numri i procedurave të vazhdara në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë të publikuara në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe njoftimet e fituesit për vitin 2021, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 63

Procedura në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë	Numri i procedurave
Njoftime Kontratash të publikuara	14
Procedura të anuluar	5
Procedura të vazhduara	9
Njoftime Fituesish	8

2.12.1 STATISTIKA NË LIDHJE ME PROCEDURAT E ANKANDIT PUBLIK TË ZHVILLUARA GJATË VITIT 2021

Gjatë vitit 2021 janë shpallur në Buletinin e Njoftimeve Publike edhe procedura të ankandit publik, procedu- ra këto, të cilat zhvillohen vetëm në rrugë shkresore.

Konkretisht, të dhënat në lidhje me këtë procedurë paraqiten si më poshtë:

Tabela 64

Procedura të ankandit publik	Numri	Vlera e ofertuar në lekë
Njoftime Fituesish Ankandi	99	214,753,616
Njoftime Kontratash të Nënshkruara Ankandi	30	88,508,925



Të shpërndarë sipas muajve, njoftimet e fituesit të procedurave të ankandit, paraqiten si më poshtë:

Tabela 65

Njoftime Fituesish për Ankandet Janar- Dhjetor 2021		
Muaji	Numri i Procedurave	Vlera e Ofertuar në lekë
Janar	3	1,049,920
Shkurt	14	11,768,136
Mars	6	923,730
Prill	8	4,052,608
Maj	8	55,555,600
Qershor	6	5,316,117
Korrik	3	435,090
Gusht	13	81,063,525
Shtator	11	39,262,395
Tetor	3	214,973
Nentor	9	8,806,629
Dhjetor	15	6,304,893
Totali	99	214,753,616

Të shpërndarë sipas muajve, njoftimet e kontratave të nënshkuara të procedurave të ankandit, paraqiten si më poshtë:

Tabela 66

Njoftime Kontratash të Nënshkuara për Ankandet Janar-Dhjetor 2021		
Muaji	Numri i Kontratave	Vlera e Kontraktuar
Janar	3	5,781,312
Shkurt	2	1,258,123
Mars	4	2,454,000
Prill	3	445,650
Maj	1	1,430,000
Qeshor	2	279,000
Korrik	0	-
Gusht	0	-
Shtator	4	65,228,960
Tetor	3	8,382,300
Nentor	0	-
Dhjetor	8	3,249,580
Totali	30	88,508,925

Në analizimin e të dhënave të paraqitura në tabelat e mësipërme, duhet mbajtur në konsideratë fakti që në shumë raste ka rezultuar se një subjekt që është shpallur fitues në disa lote të procedurave të ankandive, ka nënshkruar një kontratë, prandaj edhe numri i kontratave të lidhura është më i vogël se numri i njoftimeve të fituesit.

3. INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2021

3.1 AKTET E MIRATUARA

Gjatë vitit 2021, me miratimin e Ligjit të ri për prokurimin publik Nr. 162/2020, i cili hyri në fuqi në 31 Mars, angazhimi kryesor i APP ka qenë hartimi i legjislacionit dytësor në zbatim të këtij ligji.

APP ka punuar për finalizimin e një sërë aktesh, të cilat plotësojnë kuadrin e ri rregullator në fushën e prokurimit publik:

- Rregullat e prokurimit publik, të miratuara me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021;
- Rregullat mbi formën e komunikimit, të miratuara me VKM Nr. 384, datë 30.06.2021;
- VKM Nr. 457, datë 30.07.2021 “Për miratimin e Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit”;
- VKM nr. 768, datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”;
- Dokumentat Standarde të Tenderit, për cdo lloj procedure prokurimi të parashikuar në ligj dhe cdo tip kontrate;
- Udhëzime dhe rekomandime, në funksion të mirëzbatimit të legjislacionit të prokurimit publik dhe orientimin e autoriteteve/enteve kontraktore mbi mënyrën e veprimit në kushtet e hyrjes në fuqi të ligjit të ri të prokurimeve publike.

Gjithashtu, me miratimin e Ligjit 36/2020 “Për Prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”, si dhe rregullave të prokurimit në këtë fushë, APP ka bashkëpunuar ngushtësisht me Ministrinë e Mbrojtjes, për hartimin e Dokumentave Standarde të Tenderit për prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Në vijim, po japim një panoramë mbi procesin e ndjekur në finalizimin e këtyre akteve dhe risitë, që sjell miratimi i tyre.

- ✓ Një nga synimet kryesore të veprimtarisë së APP në vitin 2021 ka qenë finalizimi i draftit dhe miratimi i rregullave për prokurimin publik, i hartuar në zbatim të ligjit të ri për prokurimin publik Nr.162/2020.

Në katërmujorin e parë të vitit, puna u fokusua në rishikimin dhe diskutimin e draftit të rregullave të prokurimit publik, të përgatitur nga ekspert lokal, të kontraktuar nga Sigma/OECD.

Fillimisht është diskutuar drafti në këndvështrimin e legjislacionit europian, duke marrë në konsideratë sugjerimet dhe komentet e dhëna edhe gjatë procesit të konsultimit publik të LPP, për çështje që i përkisnin legjislacionit dytësor, reflektimin e komenteve të përcjella në APP nga institucione të ndryshme, si dhe çështje, për të cilat janë konstatuar problematika gjatë procesit të prokurimit.

Më pas, ka nisur një proces konsultimi publik, ku në datë 23.03.2021 drafti i VKM është publikuar në faqen zyrtare të APP dhe janë pritur komente dhe sugjerime deri në datë 02.04.2021, në adresën e e-mailit të hapur posaçërisht për këtë qëllim.

Në muajin prill, projektvendimi ka kaluar për mendim në Ministrinë e Linjës, të cilat kanë dhënë komentet dhe sugjerimet e tyre, një pjesë e të cilave është reflektuar në draft.

Rregullat e Prokurimit Publik u miratuan me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, duke synuar arritjen e objektivave, si vijon:

- Plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit rregullator të prokurimit publik në Shqipëri, në përafrim me legjislacionin europian, duke adresuar problematika të ndryshme të hasura në praktikë gjatë procesit të prokurimit dhe kërkesa për ndryshime nga institucione të ndryshme, sipas fushave respektive të kompetencës.



- Rregulla të detajuara lidhur me procesin e prokurimit, që nga planifikimi i tij deri tek zbatimi i kontratës, strukturat e angazhuara dhe përgjegjësitë e tyre në këtë proces, procedurat e rishikimit administrativ, procedurat hetimore dhe ato të mbikqyrjes së kontratës.

Ndërkohë që, risitë kryesorë që sjellin rregullat e prokurimit publik, lidhen kryesisht me:

- Kufij të rinj monetarë, me vlera më të ulta për procedurat ndërkombëtare dhe rritje të vlerës për procedura prokurimi të thjeshtuara;
- Njoftime të reja, të cilat synojnë rritjen e transparencës në proces dhe nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve në procedurat e prokurimit;
- Detyrimi për publikim në sistemin e prokurimit elektronik, të procesverbalit të argumentimit të specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të pranimit, në funksion të rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve në hartimin e këtyre kërkesave me synimin kryesor nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- Rregulla të zbatueshme në procesin e studimit paraprak të tregut;
- Përmbajtjen e Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, ku parashikohen të gjitha kërkesat që mund të jepen në formë vetdeklarimi nga ofertuesit, me qëllim kualifikimin e tyre në procedure;
- Kërkesa të veçanta sipas tipeve të kontratave, ku vlen të theksohet se në rastin e kontratave të punëve, parashikohet një periudhë 5 vjeçare për të provuar realizimin e eksperiencave të ngjashme. Gjithashtu, për të tre tipet e kontratave, kapacitetet teknike të lidhura me numrin e fuqisë punëtore dhe mjetet e pajisjet teknike do të vetëdeklarohen në momentin e tenderimit nga ofertuesit, dhe provohet vetëdeklarimi me dokumentacionin shoqërues për subjektin fitues, përpara nënshkrimit të kontratës;
- Kritere më të lehtësuara të zbatueshme në Procedurën e Thjeshtuar të Prokurimit, duke synuar nxitjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në këto procedura;
- Parashikime mbi procedurat e prokurimit, ku përfshihen dhe procedurat e reja, sipas LPP;
- Rregullat e procesit të rishikimit administrativ, ku vlen të theksohet se ndryshe nga legjislacioni i mëparshëm, periudha e pritjes dhe afatet e ankimit në dispozicion të operatorëve ekonomikë fillon nga publikimi i njoftimit të fituesit;
- Rregulla mbi zbatimin e kontratës dhe për herë të parë detajohet procedura hetimore nga APP edhe në këtë drejtim, duke parashikuar koncepte të reja si, Plani i zbatimit të Kontratës, parashikime mbi strukturat përgjegjëse të ngarkuara në procesin e mbikqyrjes nga autoriteti dhe përgjegjësitë respektive;
- Rregulla mbi mbështetjen e operatorëve ekonomikë, në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera;
- Rregulla të reja të parashikuara për prokurimet me vlerë të vogël, si refuzimi i ofertave në rast se ato, janë ulur më shumë se 50% nga fondi limit i përlogaritur dhe e drejta e operatorëve ekonomikë për t'u ankuar në këto procedura.

- ✓ Pas miratimit të rregullave të prokurimit publik, puna vijoi me hartimin e draftit të VKM “Mbi formën e komunikimit në procedurat e prokurimit publik”, i cili u miratua me Vendimin Nr. 384, datë 30.06.2021.

Si rregull komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit bëhet në përputhje me parashikimet e LPP, sipas të cilave i gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit në zbatim të këtij ligji kryhen duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit. Pra, rregulli i përgjithshëm është që procedurat e prokurimit kryhen me mjete elektronike.

Përrjashtimisht, komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit mund të kryhen në formë shkresore, sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Rastet kur mund të përdoret komunikimi në rrugë shkresore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në këtë kuptim, erdhi si domosdoshmëri miratimi i këtij vendimi, i cili përcakton rastet konkrete të përdorimit të komunikimit në formë shkresore.

- ✓ Për herë të parë, Ligji 162/2020 parashikon Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit, si një sistem unifikues i nomenklaturave të mallrave, shërbimeve dhe punëve që aplikohet në prokurimet publike. Në këtë kuadër, vijoi puna për hartimin e projektvendimit “Për miratimin e Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit”, me mbështetje të ekspertizës së Sigma/OECD, i cili u miratua me VKM Nr. 457, datë 30.07.2021.

Përdorimi i fjalorit të kodeve nga ana e autoritetit/entit kontraktor dhe operatorëve ekonomikë, ndikon në përmirësimin e procesit të prokurimit nëpërmjet unifikimit të emërtimeve dhe specifikimeve teknike.

Sipas këtij vendimi, fjalori i përbashkët i prokurimit është sistemi unik klasifikues i nomenklaturave të mallrave, shërbimeve dhe punëve që aplikohet në procedurat për prokurimet publike dhe siguron njëtrajtshmëri me nomenklaturat ekzistuese për mallra, shërbime dhe punë.

Të gjitha autoritetet dhe entet kontraktore, të cilat do të ndërmarrin procedura prokurimi, duhet të respektojnë parashikimet e këtij vendimi, duke përzgjedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik kodin/kodet përkatëse korresponduese për objektin konkret mall/punë/shërbim, që do të prokurohet.

- ✓ Në zbatim të parashikimeve të ligjit të ri për prokurimin publik, për prokurimin shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, si dhe për shërbime, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, zbatohet një regjim juridik më i thjeshtuar. Mbi këtë bazë, me mbështetjen e ekspertëve të Sigma, u hartua projektvendimi që përcakton llojet e këyre shërbimeve, me kodet respektive dhe rregullat për prokurimin e tyre, i cili u miratua me VKM Nr. 768, datë 15.12.2021.

Në kuadër të procesit të konsultimit të projektvendimit, APP ka publikuar draft vendimin në faqen e saj zyrtare, i cili ka qëndruar i publikuar 3 (tre) javë, me qëllim marrjen e komenteve dhe sugjerimeve, si nga autoritetet ose entet kontraktore, ashtu edhe nga operatorët ekonomikë në cilësinë e organizatave jo fitimprurëse.

Gjithashtu, në kuadër të këtij procesi konsultues janë marrë komente dhe sugjerime për përmirësimin e draftit nga zyra e Delegacionit të BE në Shqipëri dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Vendimi synon të plotësojë kuadrin ligjor të prokurimit publik për shërbimet sociale dhe shërbimet e tjera specifike në Republikën e Shqipërisë, bazuar në Direktivën 2014/24, 2014/25 dhe 89/665 EFC, të Bashkimit Evropian.

Llojet dhe rregullat mbi prokurimin e këtyre shërbimeve janë përcaktuar me këtë vendim të Këshillit të Ministrave, duke ballafaquar parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi, me anekset e direktivës, ku përcaktohen këto shërbime.

Sa i takon prokurimit të kësaj lloji kategorie shërbimesh, nisur dhe nga parashikimet e direktivave të sipërcituara, LPP përcakton detyrimin e autoritetit ose entit kontraktor të bëjë publike qëllimin e tij për dhënien e kontratës publike për këto lloje shërbimesh nëpërmjet njoftimit të kontratës, njoftimit periodik ose paraprak të informacionit apo njoftimit për ekzistencën e sistemit të kualifikimit, por jo detyrimin për përzgjedhjen e një prej procedurave të prokurimit të parashikuar në ligj, duke pasur në konsideratë specifikën e këtyre lloje shërbimesh dhe ofruesit e tyre.

Në këtë kuptim, vendimi ka parashikuar një procedurë specifike të lehtësuar prokurimi për këto lloje shërbimesh, sipas kufirit monetar përkatës, në përputhje me Direktivat e BE.

- ✓ Nga zbatimi në praktikë i rregullave të reja të prokurimit publik të miratuara në muajin maj të këtij viti, përgjatë një periudhe disa mujore APP mblodhi dhe analizoi paqartësi dhe problematika të ndryshme të adresuara pranë saj nga autoritetet kontraktore, operatorët ekonomikë, shoqata të ndryshme, si dhe të evidentuara në kuadër të asistimit që i është bërë autoriteteve, gjatë fazës së hartimit të dokumentave të tenderit. Për këtë qëllim, u punua për disa shtesa dhe ndryshime në rregullat e prokurimit publik, të cilat u miratuan me VKM Nr. 710, datë 24.11.2021.



3.2 DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT

3.2.1 DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR PROKURIMET PUBLIKE

Në ushtrim të detyrave të saj, sipas parashikimeve të LPP, dhe në zbatim të pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (VKM), APP ka hartuar dhe miratuar Dokumentat Standarde të Tenderit (DST), për çdo lloj procedure prokurimi të përcaktuar në ligj dhe çdo tip kontrate.

Me hyrjen në fuqi të VKM, në muajin qershor, APP u angazhua maksimalisht për hartimin dhe miratimin në kohë të seteve të DST, të cilat do të përdoren nga autoritetet/entet kontraktore në zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Për këtë qëllim, është ngritur një grup pune, i cili ka punuar për draftimin e seteve përkatëse. Vlen të theksohet se, në këtë proces, APP ka pasur edhe mbështetjen e ofruar nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Setet e DST të miratuara synojnë të plotësojnë kuadrin rregullator të prokurimit publik, në përafrim edhe me legjislacionin europian, konkretisht Direktivat 2014/24 dhe 2014/25.

Secili prej seteve është strukturuar në katër seksione, konkretisht:

- Seksioni I, i cili përmban udhëzime për Operatorët Ekonomikë, të cilat nuk mund të modifikohen nga Autoriteti Kontraktor apo operatorët ekonomikë;
- Seksioni II, i cili përmban shtojcat, të cilët duhet të plotësohen nga Operatori Ekonomik dhe të paraqiten si pjesë e ofertës së tij, si dhe Shtojcat që duhet të plotësohen nga autoriteti kontraktor në përputhje me llojin e procedurës që prokurohet. Në këtë seksion detajohet përmbajtja e formularëve, pjesë e Dokumentave Standarde të Tenderit;
- Seksioni III, i cili përmban Termat dhe Kushtet e Kontratës që do të zbatohen për të gjitha Kontratat, Formularin e sigurimit të kontratës, si dhe formularë që duhet të nënshkruhen nga të dy palët si, draftet e marrëveshjeve kuadër, sipas llojeve të tyre;
- Seksioni IV, i cili përmban formularët standard që përdoren nga operatorët ekonomikë, në procesin e ankimit pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik (në vijim “KPP”), si dhe njoftimet që duhet të plotësohen nga autoriteti kontraktor në përfundim të procesit të prokurimit.

Informacioni i pasqyruar në DST, përkatësisht, në njoftimet, udhëzimet për operatorët ekonomikë, të gjithë formularët përkatës dhe kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, është sipas parashikimeve në nenet respektive të rregullave të prokurimit publik, Kreu V.

Gjithashtu, APP ka bashkëpunuar me KPP për hartimin e Formularit standard të ankesës dhe Formularit të paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar, pranë Autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, formularë, të cilët janë bërë pjesë e setit të DST.

APP, ka miratuar me vendimet respektive, 29 sete të dokumentave standarde të tenderit, sipas tipit të kontratës mall, punë apo shërbim, për procedurat e prokurimit:

- “Procedurë e hapur”, miratuar me vendimin Nr. 02, datë 09.06.2021;
- “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, miratuar me vendimin Nr. 03, datë 09.06.2021;
- “Shërbim konsulence”, miratuar me vendimin Nr. 04, datë 11.06.2021;
- “Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, miratuar me vendimin Nr. 05, datë 17.06.2021;
- “Procedurë e kufizuar”, miratuar me vendimin Nr. 06, datë 23.06.2021;

- “Dialogu konkurrues”, miratuar me vendimin Nr. 11, datë 02.07.2021;
- “Negociim me shpallje paraprake të njoftimit”, miratuar me vendimin Nr. 07, datë 25.06.2021;
- “Konkurruese me negociim”, miratuar me vendimin Nr. 09, datë 25.07.2021;
- “Partneritet për inovacion”, miratuar me vendimin Nr. 10, datë 02.07.2021;
- “Konkurs projektimi”, miratuar me vendimin Nr. 08 datë 25.06.2021.

3.2.2 DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR PROKURIMET NË FUSHËN E MBROJTJES DHE SIGURISË

Me miratimin e Ligjit 36/2020 “Për Prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”, si dhe hyrjen në fuqi të rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, APP nisur nga specifika e prokurimeve në këtë fushë ka bashkëpunuar ngushtësisht me Ministrinë e Mbrojtjes, ër hartimin e Dokumentave Standarde të Tenderit për prokurimet në këtë fushë.

Përgjatë këtij procesi, është marrë edhe mendim i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si institucion me kompetenca të përcaktuara në ligjin specifik, dhe pas marrjes së disa sugjerimeve nga ky institucion, APP ka finalizuar draftin përfundimtar të seteve të DST për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, për cdo lloj procedure prokurimi të parashikuar në ligj.

Setet përkatëse të dokumentave të tenderit në këtë fushë u miratuan nga APP me vendimin Nr.1 datë 07.04.2021, përkatësisht për:

- Procedurën e kufizuar;
- Procedurën Negociim me Shpallje Paraprake të Njoftimit të Kontratës;
- Procedurën Negociim pa Shpallje Paraprake të Njoftimit të Kontratës;
- Procedurën Dialogu Konkurrues.

3.3 UDHËZIME, REKOMANDIME DHE NJOFTIME TË APP

Gjatë këtij viti, përveç udhëzimeve dhe rekomandimeve të lidhura me çështje specifike në funksion të mbarëvajtjes së sistemit të prokurimit publik, APP ka punuar intensivisht për nxjerrjen e akteve të nevojshme, në ndihmë të autoriteteve/enteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë për njohjen dhe mirëzbatimin e kuadrit të ri rregullator.

Gjithashtu, janë nxjerrë njoftime të vazhdueshme për orientimin e autoriteteve/enteve kontraktore, mbi mënyrën e procedimit në periudhën tranzitore të hyrjes në fuqi të ligjit të ri të prokurimeve, në një kohë që aktet nënligjore dhe dokumentat standarde të tenderit ende nuk ishin miratuar.

Konkretisht, janë hartuar 7 (shtatë) udhëzime, 4 (katër) rekomandime dhe 24 (njëzet e katër) njoftime.

Tabela 67

Udhëzime	Rekomandime	Njoftime
7	4	24

Nëpërmjet këtyre udhëzimeve, rekomandimeve, dhe njoftimeve, APP ka pasur si qëllim asistimin dhe sqarimin e autoriteteve/enteve kontraktore hap pas hapi, pasur në konsideratë zbatimin e legjislacionit të ri për prokurimin publik.



Në këtë kontekst përmendim, udhëzimet:

- Udhëzim Nr. 1, datë 07.01.2021 “Për një ndryshim në udhëzimin Nr. 6, datë 16.01.2018 “Mbi përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar”, i cili u bë i nevojshëm, pas përmirësimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), sa i takon hapave që duhet të ndiqen për krijimin e njoftimit të fituesit dhe krijimin e njoftimit për minikontratat e lidhura.
- Udhëzimi Nr. 02, datë 09.06.2021 “Për dhënien e këshillave dhe asistencës autoriteteve/enteve kontraktore gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit”. Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri të prokurimeve publike dhe rregullave të prokurimit, në kuadër të mirëzbatimit të legjislacionit të prokurimit publik, të zbatimit në kohë të regjistrimit të parashikimit të procedurave të prokurimit publik, të dhënies së këshillave dhe asistencës për autoritetet/entet kontraktore që ndërmarrin një procedurë prokurimi, APP hartoi udhëzimin përkatës, duke udhëzuar mbi dërgimin nëpërmjet SPE të procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim. Për t’i ardhur në ndihmë autoriteteve/enteve kontraktore, u hartua edhe model tip për këtë procesverbal.
- Udhëzim Nr. 03, datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin e tyre me mjete elektronike”, i cili reflektoi referencat e reja ligjore në procesin e prokurimit të biletave të transportit ajror ndërkombëtar.
- Udhëzim Nr. 04, datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrimit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrimit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, i cili reflektoi parashikimet e reja ligjore të miratuara në rregullat e prokurimit publik në lidhje me regjistrimin e parashikimit të procedurave të prokurimit dhe realizimit të tyre.
- Udhëzimi Nr. 05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, ku u reflektuan ndryshimet e reja ligjore në zhvillimin e kësaj procedure. Ligji i ri për prokurimet publike parashikon mundësinë e ankimit edhe për këtë lloj procedure prokurimi pranë autoritetit/entit kontraktor, me afate të shkurtuara, 2 ditë, nisur edhe nga fakti se kjo është një procedurë e thjeshtuar prokurimi që ka, gjithashtu, afate të shkurtra edhe në publikim. Për këtë qëllim, në manualin që shoqëron këtë udhëzim u parashikua procedurë e detajuar, sa i takon veprimeve që do të kryhen nga autoritetet/entet kontraktore në rast të paraqitjes së një ankese. Parashikimi për herë të parë në këtë udhëzim i refuzimit të ofertave nga autoritetet/entet kontraktore në rastin kur ato, janë ulur më shumë se 50% nga fondi limit të përllogaritur, kjo, për të rritur përgjegjshmërinë në ofertim nga operatorët ekonomikë.
- Udhëzimi Nr. 06, datë 16.07.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, me të cilin, APP ka udhëzuar autoritetet/entet kontraktore mbi rastet e përdorimit të saj, sipas parashikimeve të reja ligjore të përcaktuara në nenin 47 të LPP, të lidhura kryesisht me:
 - o Parashikimi i njoftimit vullnetar për transparencën;
 - o Parashikimi për herë të parë i së drejtës për ankimin në këtë procedure.
- Udhëzimi Nr. 07, datë 30.07.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”, i cili përshkruan veprimet që duhet të ndjekin në SPE secili prej funksioneve, përkatësisht në rolin e Administratorit të AK, rolin e nëpunësit të autorizuar të Njësisë së Prokurimit, të rolit të anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, në zhvillimin e procedurave të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik.

Ndërkohë, me qëllim rritjen e performancës së menaxhimit të fondeve dhe nevojave nga autoritetet/entet kontraktore, si dhe mirëfunksionimin në tërësi të sistemit të prokurimit publik, rekomandimet dhe njoftimet e vazhdueshme të APP, kanë konsistuar kryesisht në:

- në përlogaritjen e vlerës së parashikuar të prokurimit për kontratat e punëve nga autoritetet kontraktore, si dhe në paraqitjen e analizës së çmimeve nga operatorët ekonomikë, të mbahen në konsideratë aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat përcaktojnë pagën minimale orare dhe që janë në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurës, konkretisht, VKM Nr.1025, datë 16.12.2020, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”;
- si rezultat i gjetjeve të APP gjatë monitorimit të procedurave të prokurimit për punë, mallra dhe shërbime, të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga autoritete të ndryshme kontraktore, dhe nisur nga problematikat më të shpeshta të konstatuara gjatë asistimit të procedurave të prokurimit, përsa i përket hartimit të dokumenteve të tenderit, janë orientuar autoritetet/entet kontraktore në drejtim të zbatimit të parashikimeve të reja ligjore të prokurimit publik;
- mbi miratimin e ligjit të ri të prokurimit publik, rregullave të prokurimit publik, si dhe akteve të tjera nënligjore, përfshirë këtu edhe udhëzime të APP apo Dokumentat Standarde të Tenderit, të miratuara gjatë kësaj kohe, duke sjellë në vëmendje risitë dhe ndryshimet që sjellin këto akte;
- mbi legjislacionin e zbatueshëm gjatë periudhës tranzitore, për procedurat e reja dhe ato në proces;
- orientimin mbi mënyrën e procedimit për minikontratat e lidhura gjatë marrëveshjes kuadër, pas ndryshimeve të bëra në SPE për këtë qëllim;
- me hyrjen në fuqi të rregullave të reja të prokurimit publik, në kuadër të rolit të saj në drejtim të monitorimit të kontratave, APP ka rekomanduar autoritetet/entet kontraktore në lidhje me formatin e Planit të Zbatimit të Kontratave dhe mënyrën e procedimit për hartimin dhe dërgimin e tij në APP. Gjithashtu, pas analizimit të problematikave të evidentuara nga kontratat e raportuara dhe kontratat, në institucionet ku është ushtruar kontroll, APP ka dhënë disa rekomandime me qëllim minimizimin e këtyre problematikave gjatë zbatimit të kontratave.



4. VEPRIMTARIA KËSHILLUESE DHE ASISTUESE E APP

4.1 VEPRIMTARIA ASISTUESE për autoritetet kontraktore

APP, në kuadër të zbatimit të detyrave funksionale, që lidhen me asistencën dhe këshillimin e autoriteteve kontraktore në lidhje me dokumentat e tenderit, ka vijuar punën për asistimin e procedurave të shpallura, si dhe i është përgjigjur në kohë nevojave të autoriteteve kontraktore për asistencë paraprake, duke dërguar rekomandimet përkatëse pranë autoriteteve kontraktore përgjegjëse, me qëllim garantimin e mirëzbatimit të legjislacionit në fuqi, minimizimin e rasteve që çenojnë konkurrencën dhe që sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, si dhe rritjen e efikasitetit në prokurimin e fondeve publike.

Në kuadër të këtij procesi, për periudhën **Janar-Dhjetor 2021**, nga **5079** procedura të shpallura në Sistemin e Prokurimit Elektronik, janë asistuar në total **3186** procedura prokurimi, nga të cilat **117** me kërkesë paraprake të autoriteteve kontraktore përpara publikimit dhe **3069** pas publikimit të tyre në SPE⁷. 3069 procedura që janë asistuar nga APP pas publikimit përbëjnë **60.4%** të procedurave të publikuara. Nga procedurat e asistuar, pas publikimit të tyre në SPE, 209 procedura janë anuluar dhe 2860 procedura kanë vijuar procesin e prokurimit.

Nga procedurat e asistuar që kanë vijuar procesin, rezulton se:

- 41% e procedurave të asistuar janë procedura të shpallura nga insitucionet e qeverisjes qendrore,
- 38% e procedurave të asistuar janë procedura të shpallura nga institucionet vendore,
- 14% e procedurave të asistuar janë procedura të shpallura nga shoqëritë anonime,
- 7% e procedurave të asistuar janë procedura të shpallura nga institucionet e pavarura.

Përqindja e procedurave të asistuar nga sektori, krahasuar me vitin 2020, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 68


Procedurat	Viti 2020	Viti 2021
% e procedurave të asistuar kundrejt atyre të publikuara ne SPE	53%	60,4 %

Sikurse vihet re, gjatë vitit 2021, Sektori i Koordinimit ka asistuar një përqindje më të lartë të procedurave që janë publikuar ne SPE.

⁷ Përzgjedhja e procedurave që asistohen bëhet bazuar në fondin limit të tyre, duke i dhënë prioritet procedurave me fond limit më të lartë.

Paraqitja grafike e të dhënave të mësipërme është si më poshtë:

Grafiku 35



Më poshtë paraqiten disa nga treguesit, të cilët konsiderohen si indikatorë të rëndësishëm, për të vlerësuar rezultatin e kësaj asistence të vazhdueshme.

1. Analizimi i të dhënave në lidhje me procedurat që rezultojnë pa problematika, kundrejt procedurave të asistuara

a) Analizimi i të dhënave në krahasim me vitin 2020

Nga 2860 procedura që janë asistuar pas shpalljes në SPE⁸, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021:


- 25% e procedurave të asistuara, kanë rezultuar përgjithësisht në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm për prokurimin publik apo me fushat specifike ku ekzekutimi i objektit të kontratës që prokurohet shtrin veprimtarinë e tij;
- 75% e procedurave të asistuara, kanë rezultuar me konstatime në lidhje me përmbushjen e kushteve të legjislacionit të zbatueshëm dhe për të cilat u janë dërguar rekomandimet përkatëse autoriteteve kontraktore.

8 Në analizë nuk është përfshirë numri i procedurave të anuluar



Paraqitja grafike e këtyre të dhënave është si më poshtë:

Grafiku 36



Nisur nga të dhënat e analizuara, rezulton se ka një rritje të përqindjes së numrit të procedurave që rezultojnë pa konstatime, pra me kritere që konsiderohen në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, për vitin 2021, krahasuar me vitin 2020. Konkretisht, përqindja e procedurave pa konstatime në raport me procedurat e asistuar është në nivelin 25% dhe atyre me konstatime, në nivelin 75%, ndërkohë që në vitin 2020, këto përqindje kanë qenë respektivisht në nivelet 20% dhe 80%.

Me qëllim rritjen e performances së autoriteteve kontraktore në hartimin e kritereve në procedurat e prokurimit, me ndryshimet e reja ligjore, u parashikua dhe detyrimi e autoriteteve kontraktore që të hartojnë me përgjegjësi procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta, duke argumentuar secilin prej tyre, si dhe publikimin e këtij procesverbali së bashku me dokumentet standarde të tenderit, duke e bërë atë të aksesueshëm nga çdo i interesuar.

Sikundër vihet re nga analiza e të dhënave për periudhën para hyrjes në fuqi të paketës së re ligjore dhe pas hyrjes në fuqi të saj, publikimi nga ana e autoriteteve kontraktore, i procesverbalit të argumentimit të specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të pranimit, ka patur një ndikim pozitiv në rritjen e numrit të procedurave pa konstatime për periudhën Qershor-Dhjetor 2021 ku procedurat pa konstatime përbëjnë 29.4% të procedurave të asistuar, ndërkohë që për periudhën Janar-Maj 2021 këto procedura përbëjnë 16.4% të procedurave të asistuar.

b) Analizimi i të dhënave sipas tipologjisë së autoriteteve kontraktore.


Nga analiza e raportit të procedurave që kanë rezultuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe atyre që kanë rezultuar me konstatime, kundrejt procedurave të asistuar, të ndara sipas tipologjisë së autoriteteve kontraktore, rezulton dhe renditen si më poshtë:

- Për institucionet qendrore dhe institucionet e tyre të varësisë, 38% e procedurave të asistuar, paraqiten pa konstatime dhe 62% e tyre kanë rezultuar me konstatime;
- Për institucionet e pavarura, 17% e procedurave të asistuar paraqiten pa konstatime, dhe 83% e tyre kanë rezultuar me konstatime;
- Për shoqëritë anonime me kapital shtetëror, 15% e procedurave të asistuar paraqiten pa konstatime, dhe 85% e tyre kanë rezultuar me konstatime;
- Për institucionet vendore dhe institucionet e tyre të varësisë, 15% e procedurave të asistuar paraqiten pa konstatime, dhe 85% e tyre kanë rezultuar me konstatime.

Nga të dhënat e mësipërme, rezulton se përqindja e procedurave pa problematika është në nivel më të lartë tek institucionet qendrore dhe në varësi të tyre, konkretisht 38% të procedurave të asistuar, dhe niveli më i ulët rezulton te institucionet vendore dhe në varësi të tyre, si dhe te shoqëritë anonime, konkretisht 15% të procedurave të asistuar.

Paraqitja grafike e këtyre të dhënave është si më poshtë:

Grafiku 37



2. Analizimi i të dhënave në lidhje me reagimin/reflektimin e autoriteteve kontraktore, ndaj rekomandimeve të APP

a) Analizimi i të dhënave në krahasim me vitin 2020

Nga analizimi i nivelit të reagimit të autoriteteve kontraktore kundrejt rekomandimeve që APP jep në lidhje me problematikat e konstatuara në hartimin e dokumenteve standarde të tenderit, veçanërisht të kriterëve të veçanta për kualifikim, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në pjesëmarrje/konkurim në prokurim, rezulton se për periudhën Janar-Dhjetor 2021, nga procedurat e asistuar, për të cilat APP ka dërguar rekomandimet:

- në 73% të rasteve, autoritetet kontraktore kanë reflektuar ndaj rekomandimeve të APP;
- në 27% të rasteve, autoritetet nuk kanë reaguar ose nuk kanë reflektuar rekomandimet e APP.

Në një këndvështrim krahasimor në lidhje me vitin 2020, ku përqindja e reflektimeve ka qenë në nivelin 66% dhe përqindja e mosreflektimeve në nivelin 34%, rezulton se në vitin 2021 ka rritje prej 7% të nivelit të reflektimit të autoriteteve kontraktore ndaj rekomandimeve të dhëna nga APP në lidhje me hartimin e dokumenteve të tenderit.

Më poshtë, jepen të dhënat krahasimore për vitet 2020-2021, në lidhje me numrin e procedurave për të cilat janë dërguar rekomandime nga APP dhe numrin e procedurave për të cilat AK kanë reflektuar rekomandimet, si dhe paraqitja grafike e nivelit të reflektimit ndaj rekomandimeve të APP:



Tabela 69

Procedurat	Viti 2020	Viti 2021
Procedura për të cilat janë dërguar rekomandime nga APP	1767	2157
Procedura për të cilat AK kanë reflektuar rekomandimet	1165	1579
% e procedurave me reflektime kundrejt procedurave me rekomandime	66%	73%

Grafiku 38




Për sa më sipër, rezulton se përqindja më e lartë e reflektimit është në vitin 2021, konkretisht 73% e procedurave për të cilat janë dërguar rekomandime nga APP. Ndërkohë, mesatarja e reflektimit në periudhën 4 vjeçare (2018-2021) është 67% e procedurave për të cilat janë dërguar rekomandime.

b) Analizimi i të dhënave sipas tipologjisë së autoriteteve kontraktore

Grafiku i mëposhtëm paraqet raportin ndërmjet reflektimeve dhe mosreflektimeve të institucioneve, sipas tipologjisë së tyre, kundrejt rekomandimeve të dërguara nga APP.

Grafiku 39



Sikundër vërehet nga grafiku, raporti ndërmjet reflektimeve dhe mosreflektimeve paraqitet i ndryshëm për tipologji të ndryshme institucionesh. Në këtë kuptim, rezulton se përqindjen më të lartë të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP e kanë institucionet qendrore, përfshirë institucionet e tyre të varësisë, si dhe shoqëritë anonime kanë, konkretisht 86% të procedurave me konstatime, ndërkohë që institucionet e qeverisjes vendore kanë përqindjen më të ulët të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, konkretisht, 56% të procedurave me konstatime.

Paraqitja grafike mujore e nivelit të reflektimit ndaj rekomandimeve të APP, për institucionet qendrore, gjatë vitit 2021, paraqitet si më poshtë:


Grafiku 40



Në grafikun e mësipërm vihet re Institucionet Qendrore kanë nivele të larta të reflektimeve ndaj rekomandimeve të APP, ku në muajin Nëntor shënohet pika më e lartë e reflektimeve, konkretisht 93%, ndërsa në muajin Mars shënohet pika më e ulët e reflektimeve, në nivelin 65.9%.

Paraqitja grafike e nivelit të reflektimit ndaj rekomandimeve të APP, për institucionet vendore, gjatë vitit 2021, paraqitet si më poshtë:

Grafiku 41



Nga grafiku i mësipërm vihet re se, sa i takon institucioneve vendore pika më e lartë e reflektimeve është shënuar në muajin Gusht në masën 83%, ndërkohë që muaji me përqindjen më të ulët të reflektimeve është muaji Mars, në masën 42.3%.



4.2 PRAKTIKAT E SHQYRTUARA PËR DHËNIE MENDIMESH, KËSHILLA APO UDHËZIMESH

APP, në zbatim të detyrave që i ngarkon legjislacioni në fushën e prokurimit publik, koncesioneve/ppp dhe ankandit publik, ka trajtuar një numër të konsiderueshëm praktikash, të cilat kanë pasur të bëjnë me dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve kontraktore, dhënien e mendimeve për projektvendime të ndryshme, shqyrtimin e propozimeve të autoriteteve kontraktore apo edhe të operatorëve ekonomike për përjashtimin e subjekteve të ndryshme nga e drejta për të fituar kontrata publike në fushën e prokurimeve publike, koncesioneve/ppp dhe ankandeve publike.

APP ka asistuar autoritetet kontraktore, duke trajtuar kërkesat e paraqitura prej tyre në rrugë shkresore dhe elektronike.

Problematikat e asistuar kanë pasur të bëjnë me çështje dhe paqartësi të ndryshme, gjatë procesit të prokurimit, të tilla si:

- mënyrën e procedimit në kohën kur ka hyrë në fuqi ligji i ri i prokurimit publik dhe nuk kanë qenë ende të miratuara aktet dytësore;
- mënyrën e procedimit për sigurimin e shërbimit të ruajtjes me roje private, i cili i ka kaluar Illyrian Guard sha që në vitin 2019, e në disa raste ky i fundit nuk merr përsipër këtë shërbim, duke sjellë që autoritetet kontraktore të kenë të pambuluar plotësimin e nevojave për këtë shërbim jo vetëm në fillim vitit, por edhe në vazhdimësi pas mbarimit të kontratave që ato kanë;
- përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje, për shkak të mosfinalizimit në kohë të procedurave konkurrese nga Agjencia e Blerjes së Përqendruar apo edhe për shkak të mosdaljes së një vendimi përfundimtar nga Komisioni i Prokurimit Publik;
- zbatimin të marrëveshjes kuadër;
- ankesa drejtuar APP, në lidhje me pasaktësi dhe shkelje të LPP, nga AK për procedurat e prokurimit të zhvilluara nga këto të fundit dhe sidomos për ato me vlerë të vogël.
- rastet e modifikimit të kontratave.

Gjatë vitit 2021, APP ka patur komunikime me institucione të ndryshme dhe kryesisht me:

- i. autoritete të ndryshme kontraktore dhe operatorë ekonomikë, të cilët kanë kërkuar mendime dhe sqarime për paqartësi mbi çështje në fushën e prokurimit publik dhe të ankandit publik;
- ii. institucione të qeverisjes qendrore (ministri), në kuadër të dhënies së mendimeve mbi projektvendime apo projektligje që kalojnë për miratim në Këshillin e Ministrave, në fushën e prokurimit publik/koncesioneve/partneritetit publik privat dhe ankandeve publike;
- iii. Komisionin e Prokurimit Publik, i cili ndërmjet të tjerave, në vendimet e dhëna i ka kërkuar APP, nisjen e hetimit administrativ për procedura të caktuara prokurimi, dhe veçanërisht për cënimin e fshehtësisë së procesit, në kuptim të nenit 25 të ligjit 9643/2006 (në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës).
- iv. Institucionet e Prokurorisë, në lidhje me informacione të ndryshme të kërkuara nga ana e tyre mbi procedurat e prokurimit të kryera nga autoritete të ndryshme kontraktore, studio të ndryshme ligjore, të cilat në bazë të së drejtës për informim kanë kërkuar vënien në dispozicion të dokumentave të procedurave të prokurimit apo kanë kërkuar informacion mbi procedura të caktuara prokurimi, organet e medias vizive apo gazetarë të ndryshëm, etj.
- v. operatorë të ndryshëm ekonomikë, të cilët kanë kërkuar të pajisen me vërtetime që të pasqyrojnë gjendjen e tyre, si operatorë që nuk janë përjashtuar me një vendim të APP nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik. Vlen të theksohet se, me futjen e shërbimit nëpërmjet e-albania një pjesë e mirë e kërkesave për tërheqjen e vërtetimeve vijnë nëpërmjet kësaj platforme.
- vi. Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pranë Kryeministrisë, mbi verifikimin e kërkuar për operatorë ekonomikë të caktuar, nëse ka patur një vendim përjashtimi për to nga APP.

- vii. Operatorët ekonomikë, të cilët janë ankuar në lidhje me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, por dhe për procedura prokurimi konkurruese në proces. Vlen të përmendet se ka patur një numër të konsiderueshëm ankesash, një pjesë e mirë, e të cilave, janë përfshirë në plan hetimi.

Konkretisht, numri total i praktikave të paraqitura në rrugë shkresore për mendim, sqarim apo informacione nga institucione të ndryshme, për çështje që lidhen me procesin e prokurimit publik, koncesioneve/PPP-ve, dhe ankandeve publike, gjatë vitit 2021 **është 675 praktika**.

Përveç trajtimit të kërkesave të paraqitura në rrugë shkresore, APP ka qenë e angazhuar maksimalisht për trajtimin e menjëhershëm të çdo kërkesë të paraqitur edhe në adresën e saj elektronike.

Duke ju referuar numrit të kërkesave elektronike gjatë vitit 2021 rezultojnë se, janë trajtuar rreth **600 të tilla**. Për vetë operativitetin në trajtimin e çdo kërkesë, vihet re, se vit pas viti, autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë zgjedhin gjithmonë e më tepër t'i drejtohen APP në rrugë elektronike. Përgjigjet e shpejta nga APP, të çdo kërkesë për paqartësi që autoritetet kanë gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, apo vështirësi që operatorët ekonomikë hasin gjatë procesit të prokurimit, ka bërë që në vitin 2021 numri i tyre të jetë në rritje krahasuar me vitin 2020, ku numri ka qenë përkatësisht 430 kërkesa.

Komunikimi elektronik është fokusuar kryesisht në:

- sqarimet mbi paraqitjen e certifikatave elektronike të fiskalizimit nga operatorët ekonomikë;
- hartimin e kriterëve për kualifikim;
- zbatimin e marrëveshjes kuadër;
- zbatimin e Ligjit të ri për prokurimet publike Nr. 162, datë 23.12.2020, i cili hyri në fuqi në 31 Mars 2021, dhe në këtë kuadër pyetjet më të shumta janë fokusuar në shpalljen e procedurave të prokurimit, sa i takon aplikimit të ligjit të zbatueshëm;
- afatet e ankimit për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, pas ndryshimeve të reja ligjore;
- aplikimin e dispozitave të reja ligjore të miratuara e sidomos sa i takon procesit të anulimit të një procedure dhe detyrimin e publikimit të njoftimit të kontratës në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar në një gazetë zyrtare të BE;
- veprimet e komisionit të shqyrtimit të ankesave në SPE;
- dispozitat tranzitore që do të aplikohen në kushtet kur nuk ishin miratuar ende rregullat e prokurimit publik;
- dokumentat standarde të tenderit që do të përdorin AK, pas miratimit të VKM 285/2021;
- sqarime për mënyrën e veprimit për blerjet deri në 100.000 lekë.
- sqarime mbi zbatimin në praktikë nga autoritetet kontraktore, të nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" të rregullave të prokurimit publik.
- sqarime mbi procesin e vlerësimit të artikullit të karburantit.
- sqarime mbi ndryshimet e miratuara me VKM 710/2021.
- mbi vijimin e shpalljes së procedurave të prokurimit për vitin 2022.
- mbi shpalljen e njoftimit të fituesit dhe afateve të ankimit.




Në formë tabelore, këto të dhëna janë si më poshtë:

Tabela 70

Praktikat e shqyrtuara gjatë vitit 2021	
Lloji i kërkesës	Numri
Kërkesa për dhënie mendimi/sqarimi/komunikim me institucione të tjera, në rrugë shkresore	160
Kërkesa për dhënie mendimi/sqarimi/komunikim me institucione të tjera, në rrugë elektronike	600
Kërkesa për dhënie mendimi mbi projektligjet/projektvendimet e paraqitura	22
Verifikime të kërkuara nga DSIK	10
Vërtetime të lëshuara për operatorët ekonomikë që nuk janë në proces përjashtimi	410
Kërkesa të paraqitura nga Prokuroritë e Rrethit Gjyqësor/SPAK/inst të ndryshme	25
Denoncime nga operatorë ekonomikë	24
Shkresa të adresuara gabimisht/përcjellë nga APP pranë institucioneve përkatëse	24

Grafiku 42



5. PËRJASHTIMI I OPERATORËVE EKONOMIKË

Një ndër detyrat kryesore të APP, është edhe vlerësimi i rasteve për përjashtim nga e drejta për të fituar fonde publike e operatorëve ekonomikë, raste këto të evidentuara gjatë procesit të verifikimit apo shqyrtimit të raporteve të organeve të auditimit që kryen APP, ose si rezultat i propozimeve të autoriteteve kontraktore, operatorëve ekonomikë, organeve të tjera audituese në ushtrim të funksioneve të tyre, të cilët kërkojnë përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të ofertuar në procedura prokurimi publik, koncension/partneriteti publik privat apo procedura ankandi publik, për një periudhë të caktuar kohore.

Sa i takon kërkesave të paraqitura gjatë këtij viti, siç do e analizojmë edhe në vijim, në një pjesë të konsiderueshme të tyre kanë qenë të paplota, në kuptim të kushteve ligjore që kërkon neni 13/3 i Ligjit 9643/2006 (në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës) apo neni 78 i LPP aktual, për përjashtimin e një operatori ekonomik nga e drejta për të fituar fonde publike.

Gjatë vitit 2021 janë marrë në shqyrtim **80 kërkesa për përjashtimin e operatorëve ekonomikë**, ndërkohë që nuk ka patur kërkesa për përjashtim të operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në koncensione/partneritet publik privat apo nga ankandet publike.

Në formë tabelore, po i paraqesim si më poshtë:

Tabela 71

Rastet e shqyrtuara për përjashtimin e operatorëve ekonomikë	
Raste të evidentuara gjatë monitorimit të zbatimit të kontratës/verifikimit të zbatimit të procedurave, nga APP	4
Propozime të iniciuara nga Operatorët Ekonomikë	15
Zbatim i vendimit të dhënë nga Gjykata	1
Propozime të iniciuara nga Autoritetet Kontraktore	52
Propozime të iniciuara nga Komisioni i Prokurimit Publik	4
Propozime të iniciuara nga KLSH/Inspektimi Financiar	4
TOTALI	80

Nga 80 rastet e propozuara për përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike:

- 15 raste referohen për keqinformim dhe paraqitje të dokumentave me të dhëna të rreme sipas parashikimeve të nenit 13/3/a të ligjit 9643/2006 (në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës) dhe 33 raste sipas parashikimeve të nenit 78 të LPP aktual, **në total 48 raste;**
- 9 raste referohen për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale, sipas parashikimeve të nenit 13/3/ç të ligjit 9643/2006 (në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës) dhe **21 raste** sipas parashikimeve të nenit 78/1/b të LPP aktual në total 30 raste;
- 2 raste referohen veprimeve korruptive, sipas parashikimeve të nenit 13/3/b të ligjit 9643/2006 (në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës).



Në formë tabelore, po i paraqesim si më poshtë:

Tabela 72

Rastet e shqyrtuara për përjashtimin e operatorëve ekonomikë	
Propozime për keqinformim dhe paraqitje të dokumentave me të dhëna të rreme	48
Propozime për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale	30
Propozime për veprime korruptive të përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 26 të Ligjit 9643/2006	2
TOTALI	80

Nga **80** kërkesat e administruara, ka nisur procedimi administrativ për përjashtimin nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit për **53** operatorë ekonomikë, ndërkohë që për **1 rast** është zbatuar vendimi i dhënë nga Gjykata e Lartë, duke e futur operatorin ekonomik në listën e operatorëve të përjashtuar.

Ndërkohë, **26 kërkesa**, kanë rezultuar si të paplota në argumenta ligjorë dhe prova dokumentare, ose pas verifikimeve të kryera ka rezultuar se nuk kanë qenë në kushtet e parashikuara nga dispozitat ligjore për nisjen e procedimit administrativ nga APP.

Tabela 73

Vlerësimi i kërkesave për përjashtim	
Fillim procedimi administrativ	53 kërkesa
Mos nisje të procedimit administrativ	26 kërkesa
Zbatim i vendimit të dhënë nga Gjykata e Apelit	1 rast

5.1 VENDIME PËR PËRJASHTIMIN E OPERATORËVE EKONOMIKË

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur për **53 operatorë ekonomikë** është marrë vendimi për përjashtimin nga e drejta për të fituar kontrata publike, për **24** prej tyre, sipas parashikimeve të nenit 13/3 të ligjit 9643/2006 (në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës) dhe nenit 78/1 të LPP aktual. Nga këta:

- **15 operatorë ekonomikë**, janë përjashtuar nga pjesëmarrja në prokurimet publike për shkak të keqinformimit dhe paraqitjes në tender të dokumentave që përmbajnë të dhëna të rreme, përkatësisht:
 - 11 operatorë ekonomikë janë përjashtuar në kushtet e keqinformimit;
 - 4 operatorë ekonomikë janë përjashtuar në kushtet e paraqitjes së dokumentacionit me të dhëna të rreme.
- **9 operatorë ekonomikë** janë përjashtuar për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, të LPP.

Tabela 74

Përjashtime me bazë ligjore	
Përjashtuar për keqinformim për qëllime kualifikimi (neni 13/3/a i ligjit 9643/2006/neni 78 i LPP)	11 operatorë ekonomikë
Përjashtuar për paraqitje të dokumentave me të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi (neni 13/3/a i ligjit 9643/2006/neni 78 i LPP)	4 operatorë ekonomikë
Përjashtuar për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale (neni 13/3/ç i ligjit 9643/2006 dhe neni 78/1/b i LPP)	9 operatorë ekonomikë

- Vlen të përmendet se, në rastet e përjashtimit të operatorëve ekonomikë **në kushtet e keqinformimit për qëllime kualifikimi** janë konstatuar raste, si:
 - keqinformim nëpërmjet paraqitjes në tender të deklaratës së gjendjes gjyqësore, ku shoqëria ka deklaruar se nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP, ndërkohë që nga verifikimet e kryera ka rezultuar se ortaku/administratori kanë qenë të dënuar penalisht;
 - keqinformim sa i takon paraqitjes së vetdeklarimit të dhënë në tender se, nga kontrolli i fundit i kryer nga AKU ka rezultuar se, operatori ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore, ndërkohë që nga verifikimet ka rezultuar se, operatori në fjalë nuk ushtron aktivitet në adresën e dhënë;
 - keqinformim sa i takon përdorimit të katalogut nga operatori ekonomik, përdorimi i të cilit nuk është konfirmuar nga shoqëria prodhuese;
 - keqinformim në deklaratën e dhënë që kontratat e lidhura i ka të realizuara në masën 70%;
 - keqinformim në deklaratën e dhënë sipas Shtojces 11;
 - keqinformim në deklaratën e dhënë për specifikimet teknike.
- Si raste të **konstatimit të dokumentave me të dhëna të rreme**, përmendim:
 - vërtetimin e paraqitur për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore, ndërkohë nga verifikimi i kryer ka rezultuar se, operatori ekonomik rezulton me detyrime të papaguara;
 - moskonfirmim nga inxhinieri, i nënshkrimit të marrëveshjes së angazhimit me operatorin ekonomik, e paraqitur si pjesë e ofertës;
 - paraqitja e një Raport analize me të dhëna të rreme, e cila pas verifikimeve të kryera pranë ISHP, ky i fundit ka konfirmuar se nuk e ka lëshuar;
 - Formular Vlerësimi i paraqitur në tender përmbante të dhëna të rreme, pasi nuk konfirmohet përqindja e punëve të realizuar si anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë e shprehur në këtë formular.
- Sa i takon rasteve të **mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore** rezulton se, vendimet e përjashtimit të dhëna në këto raste, kanë qenë për mospërmbushje të detyrimeve kontraktore gjatë kontratave të nënshkruara kryesisht në përfundim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, por edhe për mospërmbushje të kontratave të nënshkruara pas zhvillimit të një procedure konkurruese prokurimi.

5.2 VENDIME PËR MOSPËRJASHTIMIN E OPERATORËVE EKONOMIKË

Për **6 (gjashtë) operatorë ekonomikë** është vendosur mos përjashtimi i tyre për shkak se, nuk plotësoheshin kushtet e parashikuara në nenin 13/3 të ligjit 9643/2000 (në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës), apo nenit 78/1/a të Ligjit aktual.

Në formë tabelore, të dhënat për vendimet e mospërjashtimit:

Tabela 75

Vendime mospërjashtimi nga pjesëmarrja në prokurimet publike	
Vendime për mospërjashtim, të mbështetura në parashikimet e nenit 13/3/a të Ligjit 9643/2006 (për keqinformim dhe paraqitje të dokumentave me të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi)	4 raste
Vendime për mospërjashtim, të mbështetura në parashikimet e nenit 78/1/a të Ligjit 162/2020 (për keqinformim dhe paraqitje të dokumentave me të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi)	2 raste



5.3 PEZULLIMI I PROCEDIMEVE ADMINISTRATIVE

Gjatë procedimit administrativ të nisur për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, në mbështetje të Kodit të Procedurave Administrative, është vendosur **pezullimi i procedimit** për 7 (shtatë) operatorë ekonomikë, për shkak të procesit gjyqësor.

Vendimi për pezullimin e procedimit administrativ është marrë në kushtet kur ka rezultuar se, çështja për të cilën është nisur procedimi, ka qenë objekt i kërkesë padisë së ngritur pranë Gjykatës nga këto operatorë ekonomikë.

Në formë tabelore, paraqesim të dhëna mbi procedimet administrative, të cilat rezultojnë të pezulluara, për shkak të procesit gjyqësor, i paraqesim më poshtë:

Tabela 76

Procedime administrative që mbeten të pezulluara për shkak të vijimit të procesit gjyqësor në vitin 2020	7
---	----------

Ndërkohë që, vazhdojnë të mbeten të pezulluara, për shkak të vijimit të procesit gjyqësor që nga viti 2015-2020 edhe 17 (shtatëmbëdhjetë) procedime të tjera, për të cilat pritet dërgimi i vendimit përfundimtar të dhënë nga gjykata mbi këto çështje.

Në formë tabelore, paraqesim të dhëna mbi procedimet administrative, të cilat rezultojnë të pezulluara, për shkak të procesit gjyqësor, i paraqesim më poshtë:

Tabela 77

Procedime administrative që mbeten të pezulluara për vitin 2021	7
Në total, procedime administrative të pezulluara gjatë viteve 2015-2020	17

Kërkesa të paplota dhe në proces

Për **26 operatorë ekonomikë**, APP nuk ka nisur procedimin administrativ, pasi kërkesa e paraqitur nga propozuesit (operatorë ekonomikë/autoritet kontraktor) është konsideruar me dokumentacion të pamjaftueshëm dhe e paargumentuar për të filluar procedimin administrativ, apo pas verifikimeve të kryera ka rezultuar se nuk janë plotësuar kushtet për nisjen e procedimit administrativ sipas parashikimeve të nenit 13/3 të Ligjit 9643/2006 në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës.

Gjithashtu, procedimet administrative të nisura janë **ende në proces nga APP për 17 (shtatëmbëdhjetë) operatorë ekonomikë**.

- Në mënyrë të përmbledhur, më poshtë paraqesim në formë tabelore, trajtimin e të gjitha kërkesave për përjashtim të operatorëve ekonomikë, nga e drejta për të fituar fonde publike, gjatë vitit 2021:

Tabela 78

Trajtimi i kërkesave për përjashtim, të shqyrtuara nga APP gjatë vitit 2021	
Vendimi	Numri
Vendime përjashtimi	24
Vendime mos përjashtimi	6
Procedime administrative të pezulluara	7
Procedime administrative në proces, për marrje vendimi	17
Kërkesa të paplota	26
TOTALI	80

Duke e krahasuar me vitin 2020, trajtimi i kërkesave për përjashtimin e operatorëve ekonomikë si dhe vendimet e marra në përfundim të procedimit të nisur, kanë pësuar një rritje gjatë vitit 2021, sipas grafikut të mëposhtëm:

Grafiku 43



Ndërkohë, duke e krahasuar ndër vite për periudhën 2018-2021 rezulton se, kemi një rritje gjatë këtij viti, si të kërkesave, ashtu edhe vendimeve të marra për përjashtimin e operatorëve ekonomikë.

Tabela 79

Kërkesa për përjashtim gjatë vitit 2018	Kërkesa për përjashtim gjatë vitit 2019	Kërkesa për përjashtim gjatë vitit 2020	Kërkesa për përjashtim gjatë vitit 2021
55	50	62	80

Tabela 80

Vendime për përjashtim gjatë vitit 2018	Vendime për përjashtim gjatë vitit 2019	Vendime për përjashtim gjatë vitit 2020	Vendime për përjashtim gjatë vitit 2021
17	20	16	24



6. TREGUES TË VEPRIMTARISË SË VERIFIKIMIT TË PROCEDURAVE

Në zbatim të detyrave të ngarkuara nga legjislacioni i prokurimit publik, veprimtaria e APP fokusohet në hetimin administrativ, nëpërmjet verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit ose anulimit të procedurës.

Procesi i verifikimit iniciohet mbi këto baza:

- Kryesisht, me nismën e APP;
- Reklamim nga të tretët;
- Indicie nga raportet e organeve audituese, Komisioni i Prokurimit Publik, etj;
- Raste të evidentuara nga publikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik apo Buletini i Njoftimeve Publike.

6.1 VERIFIKIMI I ZBATIMIT TË LIGJSHMËRISË

Verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga autoritete të ndryshme kontraktore është një proces i vazhdueshëm i veprimtarisë së APP. Nëpërmjet këtij procesi synohet në ndërgjegjësimin e autoriteteve kontraktore për zbatimin me rigozitet të legjislacionit të prokurimit publik, në procedurat e prokurimit që zhvillohen prej tyre.

Në rolin e saj, si rregullator i sistemit të prokurimit publik në vend, APP fokuson procesin hetimor në evidencimin e problematikave, që lidhen me respektimin e kërkesave ligjore.

Nëpërmjet procesit të verifikimit, APP nuk ka për qëllim vetëm evidencimin e parregullsisë dhe problematikave, penalizimin e personave përgjegjës, të cilët rezultojnë të kenë kryer veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore të prokurimit, por edhe analizimin e situatave dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për shmangien e këtyre veprimeve, në të ardhmen.

Gjithashtu, analizimi i konkluzioneve të arritura në përfundim të procesit të verifikimit, mund të shërbejë si bazë për nxjerrjen e rekomandimeve përgjithësuese, të cilat i shërbejnë të gjithë autoriteteve kontraktore, dhe si bazë për përmirësime të mundshme në legjislacionin e prokurimit publik.

Sa i takon verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë gjatë vitit 2021, autoritetet kontraktore subjekt verifikimi, procedurat e verifikuara dhe masat administrative (gjobë, masë disiplinore) të vendosura nga APP, në përfundim të verifikimeve, janë sipas tëbales më poshtë:

Tabela 81

Autoritete Kontraktore, subjekt verifikimi <i>(duhet patur në konsideratë që disa autoritete kontraktore kanë qenë subjekt verifikimi më shumë se një herë në kohë të ndryshme gjatë vitit, për procedura të ndryshme prokurimi)</i>	68
Procedura prokurimi të verifikuara	137
Gjobë	102 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi
Propozim për masë disiplinore	145 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi

Në mënyrë të detajuar lidhur me veprimtarinë verifikuese gjatë vitit 2021, APP ka proceduar si vijon:

- *Verifikimi i procedurave ku hetimi administrativ është iniciuar kryesisht.*

Gjatë kësaj periudhe ka përfunduar zbatimin e Planit të Verifikimit të nisur në fund të vitit 2020, me fokus **27 autoritete kontraktore** dhe përfshirjen e procedurave të prokurimit të llojit “E hapur”, “Kërkesë për propozim” dhe “Procedurë prokurimi me vlerë të vogël”.

Konkretisht, në kuadër të këtij plani u verifikuan **28 procedura prokurimi**, për të cilat u shqyrtua i gjithë dokumentacioni i administruar në dosje për çdo fazë të zhvillimit të procedurës. Procedurat e përfshira në këtë plan janë të ndara si vijon:

- 4 procedura prokurimi “E hapur”.
- 6 procedura prokurimi “Kërkesë për propozim”.
- 18 procedura prokurimi me vlerë të vogël.

Procedurat e përfshira në këtë plan kanë qenë objekt denoncimesh nga operatorë ekonomikë në APP, me shkrim apo nëpërmjet postës elektronike, për të cilat është kërkuar kryerja e hetimit administrativ, duke parashtruar argumenta për shkelje e parregullsi në kryerjen e procedurave nga autoritetet përkatëse.

Pas evidentimit të shkeljeve/mangësive, si dhe shqyrtimit dhe analizimit të kundërshtimeve të paraqitura nga autoritetet kontraktore, është vijuar me përgatitjen dhe nxjerrjen e vendimeve përfundimtare. Në kuadër të këtij plani verifikimi, APP ka dalë me vendimet përkatëse, sipas parashikimeve të LPP.

Në përfundim të verifikimit të gjithë procedurave të prokurimit të përfshira në Plan, është përgatitur dhe publikuar në faqen zyrtare të Internetit të APP, Njoftimi Nr. 7459/4 Prot., datë 25.05.2021, në të cilin, duke marrë shkas nga shkeljet dhe mangësitë e evidentuara në procedurat e verifikuara, është sjellë në vëmendje të të gjithë autoriteteve kontraktore të mbajnë në konsideratë rekomandimet e dhëna në këtë njoftim, me qëllim mirë-zbatimin në vijim të dispozitave ligjore të prokurimit.

- Gjithashtu, në fund të muajit Nëntor, është miratuar një Plan Verifikimi, i cili ka në fokus **16 autoritete kontraktore**. Në hartimin e këtij plani verifikimi, është mbajtur në konsideratë rekomandimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, për përfshirje të procedurave, për të cilat autoritetet kontraktore nuk kanë reaguar ndaj rekomandimeve të dhëna nga APP, gjatë fazës së publikimit të dokumentave të tenderit.

Për këtë qëllim, në plan u vlerësua të përfshihen për verifikim, procedura prokurimi të zhvilluara nga autoritete kontraktore, për të cilat nga APP janë evidentuar problematika lidhur me kriteret e kualifikimit, por ka rezultuar se autoritetet përkatëse nuk kanë reaguar/reflektuar mbi këto rekomandime.

Nëpërmjet këtij procesi, synohet të identifikohet si ka ndikuar në procedure, hartimi i kritereve, për të cilat ka patur rekomandime dhe këto të fundit nuk janë reflektuar nga autoritetet kontraktore përkatëse.

Në këtë plan janë përfshirë edhe procedura të denoncuar nga operatorë ekonomikë, pretendimet e të cilëve shërbejnë si indicie për verifikim të zbatimit të ligjshmërisë.

Përzgjedhja e procedurave është bazuar kryesisht në natyrën e kontratës, duke përfshirë të tre llojet: punë, mallra dhe shërbime, si dhe vlerën e fondit limit.

Në këtë plan janë përfshirë në total **16 procedura prokurimi**, si vijon:

-
- 12 procedura prokurimi “E hapur”.
- 3 procedura prokurimi “Kërkesë për propozim”.
- 1 procedurë “E hapur e thjeshtuar”.



- **Verifikimi i drejtpërdrejtë i procedurave të reklamuar nga operatorë ekonomikë.**

Gjatë këtij viti, në pjesën më të madhe të rasteve, APP ka vijuar njëkohësisht me verifikimin e procedurave të prokurimit, direkt pas paraqitjes së denoncimeve nga operatorë ekonomikë në rrugë elektronike dhe shkresore, kur procedura ka rezultuar e përfunduar me nënshkrim kontrate. Për 2 prej procedurave në fjalë, ankesa është paraqitur në Portalin e Bashkëqeverisjes.

Konkretisht, është përfunduar hetimi administrativ dhe APP ka dalë me vendimet dhe trajtimet përkatëse për 7 autoritete kontraktore, sa i takon zbatimin të ligjshmërisë së 8 procedurave të prokurimit, nga të cilat 6 prokurime me vlerë të vogël dhe 2 të llojit “Kërkesë për propozim”.

Përveç verifikimit të të gjithë dokumentacionit të administruar në dosje, janë shqyrtuar edhe pretendimet e denoncuesve për këto procedura. Në përfundim të verifikimit, APP ka dalë me vendimet përkatëse.

Procedurat e denoncuara nga operatorët ekonomikë i përkasin kryesisht prokurimeve me vlerë të vogël, duke qenë se ligji i mëparshëm i prokurimit publik dhe që ka qenë në fuqi në kohën e zhvillimit të tyre, nuk parashikonte proces ankimi. Gjithashtu, këto lloj procedurash, për nga mënyra e zhvillimit të tyre dhe fondit limit, konsiderohen të thjeshtuara dhe si të tilla pjesëmarrja e operatorëve në to është relativisht e lartë, e si rrjedhim edhe konkurrenca ndërmjet tyre.

Ndërkohë, është kërkuar informacion nga 7 autoritete kontraktore, i cili është në proces shqyrtimi, sa i takon pretendimeve të paraqitura në Portalin e Bashkëqeverisjes për procedura të zhvilluara nga këto autoritete që kanë si objekt blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar.

- **Verifikimi i procedurave të përcjella për kompetencë në APP, nga institucione të tjera.**

Gjatë këtij viti, Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) i ka propozuar në disa raste APP, nisjen e hetimit administrativ, në vendimet e marra gjatë trajtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë në procedura të ndryshme prokurimi.

Konkretisht, kanë qenë subjekt verifikimi 9 autoritete kontraktore për 9 procedura prokurimi, nga të cilat 3 janë të llojit “E hapur”, 4 janë “Kërkesë për propozim”, 1 është “E kufizuar”, si dhe 1 procedurë është “E hapur e Thjeshtuar”.

Rastet e përcjella nga KPP kanë patur kryesisht të bëjnë me konstatime të lidhura me mos respektimin e afateve të ankimit nga ana e autoriteteve kontraktore, veprimet në sistemin e prokurimit elektronik, konfliktin e interesit dhe pretendime për cënim të fshehtësisë së procesit, sikurse parashikohet në ligjin e prokurimit publik. Për këto konstatime, është kërkuar nga autoritetet kontraktore që kanë zhvilluar procedurat e prokurimit, të dërgojnë informacion mbi veprimet e kryera dhe dokumentacionin provues lidhur me këto veprime.

Në përfundim të shqyrtimit të informacionit dhe dokumentacionit përkatës, APP ka dalë me trajtimin dhe arsyetimin ligjor, sikurse ka rezultuar nga ky shqyrtim.

Ndërkohë, APP është në proces verifikimi lidhur me konstatime të KPP për një autoritet tjetër kontraktor, lidhur me një procedurë të hapur prokurimi, për të cilën, pas propozimit të këtij institucioni, është kërkuar informacioni përkatës.

- **Verifikimi i procedurave të prokurimit që kanë si objekt administrimin e mbetjeve spitalore.**

Në kuadër të monitorimit të veprimitarisë së autoriteteve kontraktore, lidhur me zbatimin dhe mbikëqyrjen e kontratave për administrimin e mbetjeve spitalore gjatë periudhës 2020-2021, është ngritur në muajin Korrik një grup pune i përbashkët me Departamentin e Antikorrupsionit në Kryeministri, në të cilin janë përfshirë edhe specialistë të APP, për të vlerësuar zbatimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit, të zhvilluara për lidhjen e kontratave në fjalë.

Në këtë kuadër, është kryer verifikim ndaj **10 institucioneve spitalore, në cilësinë e autoriteteve kontraktore, për 10 procedura prokurimi**, në përfundim të të cilit janë përgatitur gjetjet e evidentuara dhe rekomandimet përkatëse mbi bazën e këtyre gjetjeve.

Në formë tabelore, të dhëna mbi verifikimet e kryera nga APP gjatë vitit 2021:

Tabela 82

Autoritete Kontraktore, subjekt verifikimi	41 (duhet patur në konsideratë që disa autoritete kontraktore kanë qenë subjekt verifikimi për disa procedura ose me teper se nje here)		
Vendime të nxjerra nga APP, me masa penalizuese	33		
Tërheqje vëmendje dhe orientim i përgjithshëm/mbyllje hetimi	9		
Procedura prokurimi të verifikuara	Procedura për punë publike	Procedura për mallra	Procedura për shërbime
(Total)	8	26	10
44			

Tabela 83

Lloji i procedurës së prokurimit	Numri
Procedurë e hapur	6
Procedurë e kufizuar	1
Procedurë kërkesë për propozim	12
Procedurë e hapur e thjeshtuar	1
Procedurë prokurimi me vlerë të vogël	24
TOTALI	44

Gjithashtu, në formë tabelore të dhëna mbi verifikimet e kryera në kuadër të kontrollit për administrimin e mbetjeve spitalore, gjatë vitit 2021:

Tabela 84

Autoritete Kontraktore, subjekt verifikimi	10
Procedura prokurimi të verifikuara	10

Tabela 85

Lloji i procedurës së prokurimit	Numri
Procedurë e hapur	5
Procedurë kërkesë për propozim	5
TOTALI	10



Të dhëna totale mbi verifikimet e kryera gjatë vitit 2021:

Tabela 86

Autoritete Kontraktore, subjekt verifikimi (duhet patur në konsideratë që disa autoritete kontraktore kanë qenë subjekt verifikimi për disa procedura)	50
Procedura prokurimi të verifikuara	54

6.2 SHQYRTIMI I RAPORTEVE TË ORGANEVE AUDITUESE/VERIFIKIM I INDICIEVE NGA RAPORTET AUDITUESE

Gjatë vitit 2021, veprimtaria e punës së APP në kuadër të raporteve të organeve audituese, është zhvilluar në dy mënyra të ndryshme, duke pasur parasysh që nga data 31 Mars 2021 ka hyrë në fuqi ligji i ri Nr. 162/2020, i cili sjell ndryshime të kompetencave të APP në këtë drejtim, konkretisht:

(i) Për periudhën 01 Janar-31 Mars 2021, APP ka shqyrtuar raportet e organeve audituesesi kompetencë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9643/2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

(ii) Ndërkohë, nga data 31 Mars 2021, në bazë të ligjit Nr. 162/2020, gjetjet e evidentuara nga auditimet e kryera dhe të paraqitura në institucion kanë shërbyer si indicie për verifikim, në kuadër të bashkëpunimit me organet audituese, e parashikuar në këtë ligj.

Mbi këtë bazë, gjatë këtij viti, APP ka bashkëpunuar me institucionet audituese në vend, si: Kontrolli i Lartë i Shtetit, Drejtoria e Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Audite të Brendshme të institucioneve, duke marrë në shqyrtim gjetjet për prokurimet e audituara, të përfshira në raportet përfundimtare, të dërguara në APP, nga këto institucione. Gjithashtu, në një rast, gjetjet e evidentuara për një procedurë prokurimi janë dërguar për shqyrtim nga Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar për Antikorrupsionin.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, është komunikuar me këto institucione, në çdo rast kur ka patur nevojë për plotësim të materialit të dërguar për shqyrtim në APP.

Gjatë verifikimit të gjetjeve të çdo raporti auditues, është respektuar e drejta e subjektit të audituar/personave të evidentuar si përgjegjës nga organet audituese, për të paraqitur në APP, kundërshtimet e tyre mbi gjetjet e pasqyruara në raportet përkatëse.

Ndërkohë që, raportet në fjalë kanë qenë voluminoze dhe me një numër të madh gjetjesh, APP ka konkluduar në vendimmarrjen përfundimtare, pas shqyrtimit, analizimit dhe vlerësimit me kujdes, të çdo gjetje të pasqyruar në raport, nga institucioni auditues, si dhe të kundërshtimeve, sqarimeve dhe dokumentacionit të dërguar nga autoritetet e audituara.

Gjatë këtij viti, janë verifikuar gjetjet e pasqyruara në **11 raporte auditimi**, ku subjekt auditimi kanë qenë **18 autoritete kontraktore**. Në përfundim të verifikimit, APP ka dalë me vendime për masa penalizuese.

Ndërkohë, janë në proces verifikimi gjetjet e pasqyruara në 4 raporte auditimi, të ushtruar në 4 autoritete kontraktore.

Në formë tabelore, të dhëna mbi numrin e raporteve me gjetjet e shqyrtuara, sipas organeve audituese:

Tabela 87

Institucioni auditues	Numri i raporteve
Kontrolli i Lartë i Shtetit	5
Audite të Brendshme të Institucioneve	4
Drejtoria e Inspektimit Financiar	1
Ministria e Drejtësisë në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar për Antikorrupsionin	1
TOTALI	11

Nga raportet e auditimit në total, APP ka verifikuar gjetjet për **83 procedura prokurimi/objekte/raste auditimi**, gjetje të lidhura me **kontrata shtesë**, si dhe **konstatime të përgjithshme** të lidhura me kërkesa të legjislacionit të prokurimit publik. Për një prej raporteve në fjalë, APP ka verifikuar gjetjet e evidentuara ndaj 8 autoriteteve kontraktore lidhur me shërbimin e transportit për mësuesit dhe nxënësit, të siguruar nga këto autoritete gjatë viteve 2019-2020.

Në formë tabelore, të dhëna mbi llojet e procedurave të prokurimit të trajtuara në raportet e organeve audituese, gjetjet e të cilave janë trajtuar nga APP:

Tabela 88

Lloji i procedurës së prokurimit/objektit të auditimit	Numri
Procedurë e hapur	26
Kërkesë për propozim	22
Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	3
Procedurë prokurimi me vlerë të vogël	21
Objekte të realizuara pa procedurë prokurimi	11 (raste)
TOTALI	83

6.3 GJETJET DHE PROBLEMATIKAT E EVIDENTUARA GJATË PROCESIT TË VERIFIKIMIT

Gjatë procesit të verifikimit janë konstatuar mangësi dhe shkelje të ndryshme të legjislacionit të prokurimit publik, nga autoritetet kontraktore që kanë zhvilluar procedurat e prokurimit objekt verifikimi, një përmblidje kryesore e të cilave jepet në vijim.

1. Moszbatimi i aspekteve ligjore proceduriale për përfitimin e mallrave apo shërbimeve, të cilat nuk përjashtohen nga ky ligj.
2. Në lidhje me organizimin e procedurës së prokurimit, në disa raste rezultoi:
 - Mos-specifikim i personit/ave përgjegjës dhe mos-raportim i tij në APP, sikurse përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Ndërkohë që, personi përgjegjës për prokurimin ka për detyrë ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të mbarëvajtjes së procesit të prokurimit, sipas detyrimeve që i ngarkon VKM këtij roli.



Ka rezultuar gjithashtu mospërcaktim i specialistit të fushës në procedurat e prokurimit, kryesisht për punët publike.

Disa objekte prokurimi kërkojnë njohuri të posaçme dhe veçanërisht në hartimin e kërkesave të kualifikimit që janë specifike për këto objekte. Në këtë mënyrë, specialisti i fushës i shërben hartimit të këtyre kërkesave në përputhje me objektin e prokurimit, duke mos përfshirë pjesëmarrjen e anëtarëve të tjerë të njesisë, të cilët nuk kanë kompetencën e duhur të njohurive në fushën e objektit që prokurohet dhe shpesh bëhen subjekt masash administrative për hartimin e kërkesave të veçanta të kualifikimit në kundërshtim me LPP dhe legjislacionin e fushës.

APP ka sjellë në vëmendje se, personi përgjegjës për prokurimin dhe specialisti i fushës kanë detyra të përcaktuara gjatë zhvillimit të procedurës, të cilat janë ndarë në mënyrë që jo vetëm t'a bëjnë më të lehtë dhe me efikasitet realizimin e procedurës, por edhe kontrollin e ligjshmërisë së procesit nga strukturat audituese.

- Në disa procedura prokurimi me vlerë të vogël ka rezultuar se, për zhvillimin e procedurës, autoriteti kontraktor ka ngritur dy komisione: njësinë e prokurimit dhe komisionin e vlerësimit të ofertave. Ndërkohë që, sipas legjislacionit të prokurimit publik, titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në fillim të çdo viti kalendarik ngre komisionin e prokurimit me vlerë të vogël të përbërë prej 3 (tre) anëtarësh, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Çdo hap i procedurës së prokurimit (hartimi i ftesës për ofertë, vlerësimi i ofertave të paraqitura, etj.) kryhet nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, me përjashtim të rasteve kur për hartimin e specifikimeve teknike/termat e referencës, përllogaritjen e fondit limit apo hartimin e kërkesave të veçanta të kualifikimit, janë ngarkuar paraprakisht struktura të posaçme.
- Përcaktimi në përbërjen e komisionit të vlerësimit të ofertave të personave që kanë marrë pjesë në përgatitjen e dokumenteve të tenderit, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, sipas të cilave, *personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.*

3. Lidhur me hartimin e specifikimeve teknike rezultoi:

- Mungesë e argumentimit dhe dokumentimit të specifikimeve teknike, sipas rregullave të prokurimit, të cilat kërkojnë argumentimin e specifikimeve teknike të përgatitura për procedurën e prokurimit dhe dokumentimin e tyre me procesverbal.
- Në disa procedura prokurimi me vlerë të vogël me objekt "Blerje tonera", nga autoritetet kontraktore është specifikuar që tonerat të jenë origjinale të prodhuara nga e njëjta kompani që ka prodhuar edhe pajisjen, pa përfshirë fjalët "ose ekuivalent", në kundërshtim me LPP. Në këtë mënyrë, autoritetet iu referohen vetëm kompanive prodhuese të pajisjeve, për të cilat kërkojnë tonerat, duke kufizuar pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë.
- Gjithashtu, ka rezultuar se autoriteti ka kërkuar që mallrat të jenë prodhim i Komunitetit Evropian, pa e argumentuar domosdoshmërinë e kësaj kërkesë. Kjo e fundit mund të kufizojë pjesëmarrjen e operatorëve, të cilët disponojnë mallra cilësorë, por të prodhuara nga vende të tjera.

4. Lidhur me përllogaritjen e fondit limit, mangësitë më të shpeshta të konstatuara i përkasin kryesisht:

- Mungesës së analizave teknike të çmimeve për zëra të preventivit që nuk janë parashikuar në manualin zyrtar, apo mos-dokumentimit të referencave të çmimeve të nënzërave përbërës të tyre.
- Mospërputhjes së çmimeve të zërave të preventivit me ato të përllogaritura nga hartimi i analizave teknike apo të manualeve përkatëse. Gabime aritmetike (sasi shumëzim me çmimin/njësi) për disa nga zërat e punimeve.
- Për zëra në preventivin e punimeve ka rezultuar se, emërtimi i zërit dhe çmimi i përdorur nga autoriteti kontraktor nuk përputhet me emërtimin dhe çmimin e manualit përkatës teknik.
- Në disa raste është evidentuar mungesë e argumentimit dhe dokumentimit të përllogaritjes së fondit limit, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të prokurimit. Në bazë të tyre, autoritetet duhet të dokumentojnë mënyrën e përllogaritjes së fondit limit dhe treguesit e çmimeve.

- Megjithëse në procesverbalet e mbajtura, autoritetet i janë referuar mënyrave të parashikuara në rregullat e prokurimit për përlogaritjen e fondit limit, në këto procesverbale nuk janë evidentuar çmimet përkatëse, si dhe nuk janë dokumentuar kontratat/faturat e mëparshme në rastet kur përlogaritja është bazuar në kontratat e mëparshme.

5. Lidhur me kërkesat e veçanta të kualifikimit në procedurat e verifikuara, është konstatuar kryesisht hartimi i tyre jo në përputhje me legjislacionin e prokurimeve dhe legjislacionin e fushës përkatëse. Gjithashtu, megjithëse në disa prej tyre janë dhënë rekomandime nga APP gjatë fazës së pritjes së ofertave, këto rekomandime nuk janë marrë në konsideratë.

Konkretisht, autoritetet kërkojnë në mënyrë të paargumentuar:

- kategori licence, të cilat nuk kanë lidhje me punimet objekt kontrate;
- numër punëtorësh pa hartuar analiza teknike ku të parashikohen fuqia punëtore dhe mjetet/ makineritë që nevojiten për realizimin e secilit zë punimesh, sipas afateve kohore të parashikuara në grafikun e punimeve dhe, mbi bazën e analizave përkatëse të përcaktojnë numrin minimal të punonjësve të domosdoshëm, për realizimin e punimeve objekt kontrate;
- kërkesa për mjete dhe pajisje, të cilat nuk janë të argumentuara sipas numrit dhe llojit të tyre dhe në përputhje me punimet objekt kontrate. Gjithashtu, në disa raste është kërkuar që kontrata e qirasë (kur mjeti disponohet me qira) të jetë e hartuar apo të specifikojë objektin e prokurimit. APP ka sqaruar se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që operatorët ekonomikë të disponojnë mjetet e kërkuara për realizimin e objektit të prokurimit dhe, në këtë kuptim, specifikimi në kontratën e qirasë të objektit të prokurimit konkret, nuk i shërben këtij qëllimi;
- kërkesa për staf teknik (inxhinierë) pa argumentuar domosdoshmërinë e tyre dhe numrin e kërkuar sipas nevojave konkrete të objektit të prokurimit. Gjithashtu, ka rezultuar edhe kërkesë e autoritetit kontraktor për prezencën në listpagesa të stafit të operatorëve ekonomikë për një periudhë relativisht të gjatë kohe përpara zhvillimit të procedurës, pa argumentuar këtë nevojë;
- kërkesë për certifikata ISO, pa cilësuar variantet e tyre të përditësuara në kohën e zhvillimit të procedurës. Gjithashtu, specifikohet nga autoritetet që në rastin e bashkimit të operatorëve, secili prej tyre duhet të disponojë certifikatat e kërkuara, ndërkohë që referuar parashikimeve të rregullave të prokurimit, secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë, duhet të disponojë kapacitetet teknike sipas natyrës së punimeve që ka marrë përsipër të realizojë me marrëveshjen e bashkëpunimit;
- kërkesa për certifikata apo autorizim nga prodhuesit, të cilët mund të mos jenë konkurrentë në procedurën e prokurimit. APP ka sjellë në vëmendje rekomandimin e saj "Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime", ku ndër të tjera, rekomandohen autoritetet kontraktore që, gjatë hartimit të kriterëve të pranimit që kanë të bëjnë me certifikatat që prodhuesi duhet të disponojë, të kenë në konsideratë faktin që, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi, mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit dhe e sigurojnë mallin/shërbimin nga këta të fundit ose distributorët e autorizuar prej tyre;
- kërkesa për paraqitjen e bilanceve të shoqëruara me akt ekspertizën e kryer nga eksperti kontabël, por pa specifikuar që bilancet mund të paraqiten në këtë mënyrë, nëse shoqëritë ofertuese janë në kushtet e parashikuara në nenit 41, pika "c" të Ligjit Nr. 10091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar;
- kërkesa për paraqitjen e certifikatës së origjinës në momentin e ofertimit. APP ka sqaruar se, certifikata e origjinës nuk duhet të kërkohej në fazën e dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, pasi zakonisht është një dokument që shoqëron mallin dhe rrjedhimisht autoriteti mund të kërkojë paraqitjen e certifikatës së origjinës për mallrat objekt prokurimi, në momentin e dorëzimit të tyre.
- mospërcaktimi i dokumentit konkret për t'u paraqitur nga operatorët ekonomikë në përmbushje të kriterëve të kualifikimit është një mangësi e evidentuar, çka krijon problematika apo konfuzion si në plotësimin e vet kriterit nga operatorët ekonomikë ofertues, ashtu edhe gjatë vlerësimit të ofertave.



6. Mangësi vijon të mbetet mosplotësimi i formularëve mbi gjendjen e konfliktit të interesit nga personat e përfshirë në proceset e prokurimit, sipas roleve përkatëse. Megjithëse, në pjesën më të madhe të rasteve, autoritetet i sjellin deklaratat e plotësuara në kohën e dërgimit të kundërshtimeve, me arsyetimin se janë harruar apo nuk janë fotokopjuar bashkë me dokumentacionin tjetër të procedurës, nuk krijohet bindja se këto deklarata janë plotësuar në kohën e duhur.
7. Në lidhje me ofertimin dhe procesin e vlerësimit, në procedurat e verifikuara janë konstatuar mangësi në dokumentacionin e kërkuar nga autoritetet, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, duke sjellë si pasojë kualifikim në kundërshtim me LPP dhe me këto kritere. Ndërkohë, autoritetet kontraktore duhet të vlerësojnë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse dokumentacioni i paraqitur nga operatorët ekonomikë, është në përputhje me të gjitha kriteret e kualifikimit.

Ka rezultuar gjithashtu që operatorët ekonomikë kanë paraqitur dokumentacion fotokopje, të panjehsuar me origjinalin, apo mungesë të vulës së institucionit lëshues.

Megjithëse me mangësi në dokumentacion, autoritetet kontraktore kanë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë.

Janë konstatuar edhe raste, në të cilat autoritetet kanë evidentuar mospërmbushje të kriterëve të kualifikimit, por që disa prej arsyeve të skualifikimit nuk qëndrojnë, edhe pse operatorët në fjalë mbeten të skualifikuar për arsye të tjera.

Gjithashtu, ka rezultuar mos-mbajtja e të njëjtit qëndrim gjatë vlerësimit të operatorëve ekonomikë, në të njëjtën procedurë dhe në procedura të ndryshme të zhvilluara nga autoriteti kontraktor, me anëtarë të njëjtë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

8. Në disa procedura të verifikuara nuk ka rezultuar i dokumentuar verifikimi i dokumentacionit në formë të shkruar, të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës apo mos-cilësimi i mënyrës së paraqitjes së dokumentacionit, pra nëse ky i fundit është origjinal apo fotokopje e njehsuar me origjinalin.

Sa i takon prokurimeve me vlerë të vogël, është evidentuar edhe hartimi jo i duhur i kërkesës në ftesën për ofertë për paraqitjen e dokumentacionit të operatorit ekonomik të renditur në vend të parë. Në disa raste nuk respektohet afati minimal 24 orë i parashikuar në udhëzim, në disa të tjera kërkohet që operatorit fitues të paraqitet njëkohësisht pranë autoritetit me dokumentet e kërkuara dhe mallin objekt prokurimi.

Gjithashtu, në këto lloj procedurash ka rezultuar se, autoritetet përcaktojnë zakonisht një afat shumë të shkurtër lëvrimi, pa e argumentuar këtë nevojë.

Ndërsa, lidhur me procesin e vlerësimit në këto lloj procedurash, mangësi e evidentuar është edhe refuzimi/skualifikimi për mospasje në fushën e veprimtarisë së operatorit, të objektit të prokurimit, ndërkohë që nga verifikimi në faqen e Qendrës Kombëtare të Biznesit nuk ka rezultuar diçka e tillë. Gjithashtu, autoritetet kanë skualifikuar operatorë për oferta anomalisht të ulëta, edhe pse në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël nuk zbatohen dispozitat e LPP për ofertat anomalisht të ulëta.

6.4 MASAT ADMINISTRATIVE DHE RAPORTIMI

6.4.1 MASAT ADMINISTRATIVE

- Gjatë këtij viti, nga hetimet administrative të kryera, APP ka konkluduar me vendime për masa penalizuese, konform parashikimeve ligjore në **33 raste**.

Në 2 procedura i është tërhequr vëmendja autoritetit kontraktor për shmangien e situatave të njëjta në të ardhmen, ndërsa në 6 procedura të tjera nuk është vërtetuar shkelje administrative nga ana e autoriteteve përkatëse kontraktore. Gjithashtu, për një autoritet kontraktor është mbyllur hetimi administrativ, pasi nuk kanë rezultuar shkelje të dispozitave ligjore të prokurimit, të cilat janë të penalizueshme me masa administrative sipas LPP.

Të dhënat statistikore mbi masat administrative të vendosura nga APP, në përfundim të hetimit administrativ, paraqiten në vijim:

Tabela 89

Gjobë	Propozim për masë disiplinore
për 44 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi	për 111 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi

Nisur nga roli i personit në procedurën e prokurimit të verifikuar, **të dhënat sipas numrit të autoriteteve kontraktore:**

Tabela 90

Penalizime me gjobë	
Roli i zyrtarit	Numri
Titullar i Autoritetit Kontraktor	1 Autoritet Kontraktor
Anëtar i Komisionit për përlllogaritjen e fondit limit	1 Autoritet Kontraktor
Anëtar i Njësisë së Prokurimit/Specialist fushe/Person i autorizuar për veprimet në sistem	8 Autoritete Kontraktor
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	7 Autoritete Kontraktor

Tabela 91

Propozim për masë disiplinore	
Roli i zyrtarit	Numri
Titullar i Autoritetit Kontraktor	2 Autoritete Kontraktor
Anëtar i Komisionit për përlllogaritjen e fondit limit/specifikimeve teknike	8 Autoritete Kontraktor
Anëtar i Njësisë së Prokurimit/ Person përgjegjës për prokurimin/ Person i autorizuar për veprimet në sistem	5 Autoritete Kontraktor
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	3 Autoritete Kontraktor
Anëtar i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave	1 Autoritet Kontraktor
Anëtar i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël	21 Autoritete Kontraktor



- Për të gjithë raportet e organeve audituese, gjetjet e të cilave janë verifikuar nga APP gjatë kësaj periudhe, është konkluduar për masa administrative, konform parashikimeve ligjore, për **18 Autoritete Kontraktore**.

Të dhënat statistikore mbi masat administrative të vendosura nga APP, në përfundim të shqyrtimit të raporteve të organeve audituese, paraqiten në vijim:

Tabela 92

Gjobë	Propozim për masë disiplinore
58 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi	34 punonjës në Autoritetet Kontraktore, subjekt verifikimi

Nisur nga roli i personit në procedurat e prokurimit të audituara, **të dhënat sipas numrit të autoriteteve kontraktore**:

Tabela 93

Penalizime me gjobë	
Roli i zyrtarit	Numri
Titullar i Autoritetit Kontraktor	2 Autoritete Kontraktore
Anëtar i komisionit për përlogaritjen e fondit limit	1 Autoritet Kontraktor
Anëtar i grupit të punës për përgatitjen e dokumenteve të tenderit (specifikime teknike, kritere kualifikimi)/anëtar i njësisë së prokurimit/specialist fushe	4 Autoritete Kontraktore
Anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave	6 Autoritete Kontraktore

Tabela 94

Propozim për masë disiplinore	
Roli i zyrtarit	Numri
Titullar i Autoritetit Kontraktor	9 Autoritete Kontraktore
Anëtar i komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit	1 Autoritet Kontraktor
Anëtar i njësisë së prokurimit	2 Autoritete Kontraktore
Anëtar i komisionit të prokurimit me vlerë të vogël	3 Autoritete Kontraktore
Anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave	3 Autoritete Kontraktore

6.4.2 RAPORTIMI I MASAVE

Sipas kuadrit rregullator të prokurimit publik, autoritetet kontraktore kanë detyrimin për të raportuar në APP, mbi veprimet e ndërmarra në zbatim të masave të dhëna nga kjo e fundit, në vendimet e hetimit administrativ të procedurave dhe vendimet për verifikimin e gjetjeve si rezultat i indicieve nga raportet përfundimtare të auditimit.

Vlen të theksohet se, në shumicën e rasteve autoritetet kontraktore kanë dërguar informacion mbi veprimet e marra në zbatim të vendimeve të APP, megjithëse në disa raste APP i është dashur të përsërisë kërkesën për informacion.

Raportimi i gjobave

- a) Sa i takon vendimeve të dhëna nga APP, për dënimin me gjobë të personave përgjegjës, **në përfundim të hetimeve administrative të kryera prej saj**, nga informacioni i administruar ka rezultuar se:
- është informuar APP për ekzekutim të gjobave të vendosura në **4 vendime**;
 - janë kontestuar në rrugë gjyqësore **3 vendime**;
 - janë njoftuar personat përgjegjës për **1 vendim**.
- b) Sa i takon vendimeve të dhëna nga APP, për dënimin me gjobë të personave përgjegjës, **në përfundim të verifikimit të gjetjeve të raporteve të auditimit**, nga informacioni i administruar ka rezultuar se:
- është informuar APP për ekzekutim të gjobave të vendosura në 3 vendime;
 - është kontestuar në rrugë gjyqësore 1 vendim;
 - janë njoftuar personat përgjegjës/në pritje të informacionit nga autoritetet kontraktore për 3 vendime.

Raportim i propozimeve për masë disiplinore

- a) Sa i takon vendimeve të dhëna nga APP, për propozim mase disiplinore ndaj personave përgjegjës, **në përfundim të hetimeve administrative të kryera prej saj**, nga informacioni i administruar deri tani ka rezultuar se:
- është dhënë masë disiplinore/këshillim/këshillim /tërheqje vëmendje/vërejtje/vërejtje me shkrim/gjyqësore 1/16 e pagës/paralajmërim me shkrim, në 25 autoritete kontraktore;
 - 1 autoritet kontraktor ka konkluduar për mosfillim të ecurisë disiplinore, por gjithsesi tre personave ndaj të cilëve është propozuar nga APP marrja e masës disiplinore u është tërhequr vëmendja;
 - është vendosur ndërprerja e ecurisë disiplinore nga 1 autoritet kontraktor;
 - është kontestuar në rrugë gjyqësore 1 vendim;
 - në pritje të informacionit nga **1 autoritet kontraktor**.
- b) Sa i takon vendimeve të dhëna nga APP, për propozim mase disiplinore ndaj personave përgjegjës, **në përfundim të verifikimit të gjetjeve të raporteve të auditimit**, nga informacioni i administruar deri tani ka rezultuar se:
- është dhënë masë disiplinore vërejtje/vërejtje me shkrim/vërejtje me paralajmërim/tërheqje vëmendje në 4 autoritete kontraktore;
 - është kontestuar në rrugë gjyqësore 1 vendim;
 - është informuar APP se nuk është e zbatueshme masa disiplinore për shkak të largimit nga institucioni, në 1 autoritet kontraktor;
 - në pritje të informacionit nga **1 autoritet kontraktor**.



Tabela 95

Vendime të APP për penalizim me gjobë	15 vendime total
Kundërshtuar në gjykatë	4 vendime
Informacion për ekzekutim	7 vendime
Janë njoftuar personat përgjegjës/Në pritje të informacionit nga autoritetet kontraktore	4 vendime

Tabela 96

Vendime të APP për propozim mase disiplinore	36 vendime (patur në konsideratë që ka vendime njëkohësisht me masa administrative gjobë dhe propozim për masë disiplinore)
Është dhënë masë disiplinore/këshillim/ këshillim me gojë/tërheqje vëmendje/vërejtje/vërejtje me shkrim/gjykitje 1/16 e pagës/paralajmërim me shkrim	29 autoritete kontraktore
Është informuar për mosfillim të procedimit disiplinor/vendosur ndërprerja e ecurisë disiplinore	2 autoritete kontraktore
Është informuar për masë të pazbatueshme	1 autoritet kontraktor
Kundërshtuar në gjykatë	2 autoritete kontraktore
Në pritje të informacionit nga autoritetet kontraktore	2 autoritete kontraktore

7. PUBLIKIMI I VENDIMMARRJES

Pas daljes së vendimit, në programin e transparencës, në faqen zyrtare të internetit të APP, është publikuar për të gjithë të interesuarit, formati me të dhënat përkatëse të çdo vendimi. Formatit ka pasqyruar informacionin përkatës, si: numrin dhe datën e vendimit, autoritetin kontraktor, subjekt verifikimi, numrin dhe llojin e procedurave të verifikuara, përmbledhje të gjetjeve kryesore dhe masat e dhëna nga APP, konform ligjit për prokurimin publik.

8. PËRFAQËSIMI I APP NË PROCESET GJYQËSORE

Gjatë këtij viti, APP është përfaqësuar në proceset gjyqësore si palë e paditur, nga zyrtarët e autoriteteve kontraktore të penalizuar në përfundim të procesit të verifikimit të ushtruar nga APP apo nga shqyrtimi i raporteve audituese, si edhe nga operatorët ekonomikë, ndaj të cilëve është dhënë vendimi i përjashtimit nga e drejta për të fituar fonde publike.

Tabela 97

Çështjet Gjyqësore të ndjekura nga APP sipas shkallës së gjyqimit	
Shkalla e gjyqimit	Numri
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë	52
Çështje gjyqësore në rrethe	7
TOTALI	59

Tabela 98

Çështjet Gjyqësore të ndjekura nga APP në shkallë të parë, Tiranë, sipas llojit të kërkesë padisë	
Lloji i padisë	Numri
Kundër vendimeve të APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë	18
Kundër vendimeve të APP për penalizim të zyrtarëve	30
Marredhënie pune	1
Kërkesë për pezullim të nisjes së hetimit administrativ për përjashtimin e një operatori ekonomik	3
TOTALI	52

Po të marrim në analizë vendimet e dhëna nga APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë gjatë vitit 2021, (**24** vendime) rezulton se, **18 vendime** janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Tabela 99

Vendime përjashtimi	Ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë
24	18

Nga këto **18** ankimime, Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur:

- në **8 (tetë)** çështje rrëzim i kërkesë padisë;
- në **7 (shtatë)** çështje pranim i kërkesë padisë;
- në **1 (një)** çështje është vendosur pranim i pjesshëm i kërkesë padisë, duke ulur masën e periudhës së përjashtimit.;
- **3 (tre)** çështje janë ende në proces.



Tabela 100

Çështjet Gjyqësore kundër vendimeve të APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë sipas vendimit të Gjykatës	
Vendimi i gjykatës	Numri
Rrëzuar kërkesë padia	8
Pranuar kërkesë padia	7
Pranim i pjesshëm i kërkesë padisë	1
Në proces	3

- Nga 18 ankimime në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë, në 9 prej tyre është kërkuar sigurim padie. Duhet theksuar se, **nga këto 9 ankimime** në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, këto të fundit kanë marrë në konsideratë kërkesë paditë për dhënien e masës së sigurimit të padisë ose dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm **4 raste**, duke sjellë që vendimi i dhënë nga APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë të mos zbatohet deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Tabela 101

Pranim Kërkesë Padie për dhënie të masës së sigurimit të padisë/vendim me ekzekutim të përkohshëm	Rrëzim Kërkesë Padie për dhënie të masës së sigurimit të padisë/vendim me ekzekutim të përkohshëm
4	5

Së fundmi theksojmë se, për shkak të përfundimit të gjykimit në shkallë të parë, ku Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur të pranojë kërkesën e palës paditëse për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm apo ka vendosur të ulë masën e dënimit të dhënë për operatorin ekonomik, APP ka vijuar me ekzekutimin e vendimit të dhënë. Për këtë qëllim, APP ka vijuar me **5 Vendimet** përkatëse.

Në **4 (katër) raste** është vendosur pezullimi i vendimit të dhënë për përjashtimin e operatorit ekonomik deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga gjykata për këtë çështje dhe **1 (një) rast** është vendosur ulja e masës së dënimit të përjashtimit, deri në përfundimin e gjykimit nga Gjykata e Apelit.

Gjithashtu, ka patur procese gjyqësore, të cilat kanë patur si objekt kërkesën e tyre për mosnisen e procedimit administrativ për përjashtimin e një operatori ekonomik.

Në formë tabelore të dhënat janë:

Tabela 102

Kërkesa për pezullim të nisjes së hetimit administrativ për përjashtimin e operatorëve ekonomikë	
Pranuar kërkesa	Mospranim padie
1	2

- Çështjet gjyqësore kundër vendimeve të dhëna nga APP, **për penalizim të zyrtarëve në Autoritete Kontraktore**

Nga çështjet gjyqësore kundër vendimeve të APP për penalizim të zyrtarëve, në përfundim të procesit të monitorimit apo të shqyrtimit të raporteve të auditimit, Gjykata ka vendosur:

Tabela 103

Çështjet Gjyqësore kundër vendimit të dënimit me gjobë, sipas vendimit të gjykatës	
Vendimi i gjykatës	Numri
Rrëzuar kërkesë padia	14
Pranuar kërkesë padia	4
Pranim pjesërisht i kërkesë padisë	2
Pushim çështje	1
Në proces	9
TOTALI	30

- Në përfundim, theksojmë se nga **39 çështje gjyqësore**, të cilat kanë përfunduar me dhënien e vendimit, **21 vendime janë të formës së prerë**, dhe **18 të ankimueshme**. Nga vendimet e ankimueshme, APP ka ushtruar të drejtën e ankimit për **6** prej tyre (*si vendime që kanë pranuar kërkesë padinë*) pranë gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Në formë tabelore janë si më poshtë:

Tabela 104

Formë e prerë	Të ankimueshme
21	18

Në total nga 52 çështje gjyqësore të cilat janë ndjekur në shkallë të parë gjatë këtij viti, rezultojnë sipas grafikut të mëposhtëm se, në shumicën e rasteve Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë, duke e gjykuar të drejtë vendimin e dhënë nga APP, si sa i takon përjashtimit të operatorit ekonomik ashtu edhe penalizimin e personave përgjegjës të autoriteve kontraktore, të cilët kanë rezultuar në shkelje të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik.

Nga ana tjetër, krahasuar me të dhënat e vitit 2020, gjatë këtij viti rezultojnë se kemi patur një numër më të ulët të proceseve gjyqësore në total pranë gjykatës së shkallës së parë, por një rritje të lehtë sa i takon rasteve kur Gjykata ka vendosur në favor të APP.

Grafiku 43





- Në rastin e fletëthirrjeve për t'u paraqitur si palë ndërgjyqëse në Gjykatat Administrative në Rrethe, APP iu është drejtuar këtyre të fundit me kërkesë për shpalljen e moskompetencës, sipas ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Konkretisht, kanë ardhur fletëthirrje **për 7 çështje gjyqësore nëpër rrethe**, të cilave i është dërguar kërkesa për shpalljen e moskompetencës tokësore dhe dërgimin e çështjeve për gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Tabela 105

Çështjet Gjyqësore në rrethe, sipas vendimit të gjykatës	
Vendimi i gjykatës	Numri
Pranim kërkesë për shpallje moskompetence	5
Ne proces	2
TOTALI	7

- Gjatë këtij viti **në gjykatën Administrative e Apelit Tiranë vazhdojnë të jenë** të regjistruara **48 çështje**, ku APP është cilësinë e palës së paditur apo në cilësinë e palës së tretë.

Nga kjo Gjykatë gjatë këtij viti janë depozituar **2 (dy)** vendime të marra, me anë të cilave është vendosur: a) mospranim ankimi dhe b) lënien në fuqi të vendimit të dhënë nga Gjykata e Shkallës së parë.

- Përveç çështjeve gjyqësore pranë gjykatave administrative, sikurse analizuar më sipër, APP është palë edhe në **26 çështje në Gjykatën e Lartë**, të cilat janë të mbartura nga vitet e kaluara.

9. MONITORIMI I ZBATIMIT TË KONTRATAVE

Ligji 162/2020, parashikon për herë të parë një kapitull të posaçëm për zbatimin e kontratave duke parashikuar ndër të tjera edhe një mekanizëm për ndjekjen e zbatimit të kontratës nga ana e AK që nënkupton caktimin e një personi apo grupi me detyrën e ndjekjes së kontratës si edhe detyrimin për AK që, në bashkëpunim me operatorin fitues, të hartojnë një plan për zbatimin e kontratës, i cili shërben si bazë për monitorimin e vazhdueshëm të kontratës deri në realizimin e saj.

Gjithashtu, legjislacioni i ri parashikon detyrimin e AK-ve për të raportuar në APP planet e veprimit dhe çdo veprim tjetër si edhe ecurinë e zbatimit të kontratës, përfshirë sanksione të ndryshme ndaj OE, zgjidhjen e saj, nëse është rasti, dhe përfundimin e saj me sukses.

Me qëllim orientimin e AK-ve për mirëzbatimin e legjislacionit në këtë drejtim, APP ka nxjerrë dhe udhëzime dhe rekomandime të vazhdueshme.

9.1 TË DHËNA MBI ZBATIMIN E KONTRATAVE

Në kuadër të administrimit të dokumentacionit mbi procesin e raportimit të ecurisë së zbatimit të kontratave, APP ka shqyrtuar formularët standardë të dërguar nga autoritetet kontraktore në rrugë elektronike (në adresën monitorimi.kontrat@app.gov.al) dhe në mënyrë shkresore, si dhe raportet përfundimtare të cilësisë së zbatimit të kontratës, të dërguara nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, si dhe çdo praktikë tjetër.

Gjithashtu, janë administruar dhe verifikuar planet e zbatimit të kontratave të dërguara nga AK, në zbatim të legjislacionit të ri të prokurimeve publike.

Në çdo rast, kur janë evidentuar mangësi apo pasaktësi në dokumentacionin e dërguar nga AK, është komunikuar me këta të fundit, duke u kërkuar të bëjnë plotësimet dhe saktësimet e nevojshme.

- Në vijim paraqiten të dhënat mbi numrin total të kontratave/MK të nënshkruara, gjatë vitit 2021 (Janar-Dhjetor) (sipas informacionit të nxjerrë në Sistemin e Prokurimit Elektronik), të ndara sipas tipit të kontratave (shërbim, mall, punë):
 - Numri total i kontratave/MK të nënshkruara gjatë vitit 2021, është **4328**, nga të cilat:
 - **1294** janë kontrata/MK të tipit *Shërbime*;
 - **1992** janë kontrata/MK të tipit *Mallra*.
 - **1042** janë kontrata/MK të tipit *Punë publike*.


Numri i kontratave/MK të nënshkruara, të ndara sipas tipit të kontratës, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2021, paraqitet si më poshtë, në formë tabelore dhe grafike.

Tabela 106

Kontratat/MK të nënshkruara nga Autoritetet Kontraktore gjatë vitit 2021		
Tipi i kontratës/MK	Numri i kontratave/MK të nënshkruara për vitin 2021	Numri i kontratave/MK të nënshkruara për vitin 2021, në (%)
Shërbime	1294	29,9%
Mallra	1992	46%
Punë	1042	24,1%
Totali	4328	100%



Grafiku 44




Numri i kontratave/MK të nënshkruara në vitin 2021, sipas llojit të procedurave të , , paraqitet, si më poshtë:

Tabela 107

Kontrata/MK të nënshkruara në vitin 2021, sipas llojit të procedurave			
Tipi i kontratës/MK	Lloji i procedurës së prokurimit	Numri i procedurave të zhvilluara dhe të përfunduara me kontrata/MK për 2021	Përqindja (%) e procedurave të zhvilluara dhe të përfunduara me kontrata/MK për 2021
Shërbime/Mall/ Punë	E hapur	1443	33.34%
	Kërkesë për propozim	1406	32.48%
	E hapur e thjeshtuar	846	19.54%
	Shërbim konsulence	96	2.22%
	E hapur mbi kufirin e lartë monetar	248	5.73%
	Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	143	3.31%
	E kufizuar	2	0.05%
	E kufizuar (rindërtim)	122	2.81%
	E kufizuar mbi kufirin lartë monetar	18	0.42%
	E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar (rindërtim)	4	0.1%
Totali		4328	100%

Grafiku 45



- **Të dhëna mbi raportimet e ecurisë së zbatimit dhe planet e zbatimit të kontratave/MK, të raportuara nga AK-të sipas tipit të kontratës, gjatë vitit 2021.**

Nga hyrja në fuqi e ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 8, datë 01.09.2021 "Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës", deri në hartimin e këtij akti, **196** AK, kanë dërguar **833** plane të zbatimit të kontratave/MK të nënshkruara gjatë vitit 2021, pas periudhës së hyrjes në fuqi të ligjit dhe VKM të sipërcituar.

Në tabelën më poshtë, jepen të dhëna mbi numrin e planeve të zbatimit të kontratave/MK të dërguara nga AK-të,.

Tabela 108

Planet e zbatimit të kontratave/MK të dërguara nga autoritetet kontraktore gjatë vitit 2021	
Numri i planeve të zbatimit të kontratave/MK të dërguara për vitin 2021	Numri i autoriteteve kontraktore
833	196

Përveç dërgimit të planit të zbatimit të kontratës, AK-të në përfundim të zbatimit të kontratës dërgojnë në APP edhe raportime në të cilat parashtrohet në formë të përmbledhur, nëse kontratat kanë përfunduar me ose pa problematika.

Nga totali i **4328** kontratave/MK të nënshkruara gjatë vitit 2021, **171** AK kanë raportuar për **1619** kontrata ose për **37,4%**, të kontratave/MK të nënshkruara,.



Nga AK-të nuk është raportuar për **2709** kontrata/MK ose për **62,6%** të numrit të kontratave/MK të nënshkruara gjatë vitit 2021.

Sqarim: Nga numri total i kontratatave/MK të nënshkruara gjatë vitit 2021, një pjesë prej tyre iu përfundon afati i zbatimit të kontratës përtej vitit 2021. Sa më sipër, si dhe bazuar edhe në eksperiencat e viteve të shkuara, është konstatuar se AK-të vijojnë të kryejnë raportime gjatë gjithë vitit kalendarik në vijim.

Nga totali i **1619** kontratave/MK të raportuara nga **171** AK, rezulton se:

- **1157** ose **71,46%**, janë kontrata/MK të tipit **Mall**, të raportuara nga **129** AK.
- **312** ose **19,27%**, janë kontrata/MK të tipit **Shërbim**, të raportuara nga **83** AK.
- **150** ose afërsisht **9,27%**, janë kontrata/MK të tipit **Punë publike**, të raportuara nga **53** AK.

Në tabelën dhe grafikun më poshtë jepen të dhëna në lidhje me numrin e kontratave/MK të raportuara dhe numrin e autoriteteve kontraktore që kanë raportuar për vitin 2021, të ndara sipas tipit të kontratës (*shërbim/mall/punë*).

Tabela 109

Kontratat/MK të raportuara nga autoritetet kontraktore sipas tipit të kontratave/MK, për vitin 2021			
Tipi i kontratës/MK	Numri i kontratave/MK të raportuara (përfshirë kontrata/mk të nënshkruara gjatë vitit 2021)	Numri në (%) i kontratave/MK të raportuara	Numri i autoriteteve kontraktore që kanë raportuar
Mallra	1157	71,46%	129
Shërbime	312	19,27%	83
Punë publike	150	9,27%	53
Totali	1619	100%	171

Grafiku 46



Nga totali i **1619** kontratave të raportuara nga **171** AK gjatë vitit 2021, rezulton se:


- **144** prej tyre janë *Marrëveshje kuadër*, të raportuara nga **37** AK.
- **69** prej tyre janë *Mini kontrata*, të raportuara nga **14** AK.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm jepen të dhëna në lidhje me numrin e marrëveshjeve kuadër dhe minikontratave të raportuara nga AK-të, për vitin 2021.

Tabela 109

Marrëveshjet kuadër dhe mini kontratat e raportuara nga autoritetet kontraktore gjatë vitit 2021		
Tipi i kontratave	Numri i kontratave, i MK dhe mini kontratave	Numri i Autoriteteve Kontraktore
Totali i kontratave të raportuara	1619	171
Marrëveshje kuadër të raportuara	144	37
Mini kontrata të raportuara	69	14

Grafiku 47



- **Problematika të evidentuara nga AK gjatë zbatimit të kontratave nga analizimi i formularëve standardë të raportimit të ecursisë së zbatimit të kontratave.**

Nga analizimi i formularëve standardë të raportimit të zbatimit të kontratave, të administruar në APP, rezulton se **25** AK, kanë raportuar për **30** kontrata/MK, me problematika gjatë zbatimit të tyre. Konkretisht:



Tabela 110

Kontrata/MK të raportuara me problematika, gjatë vitit 2021			
Numri i kontratave/MK të raportuara	Numri total i kontratave/mk të raportuara	Numri i kontratave/MK të raportuara me problematika	Përqindja e kontratave të raportuara me problematika
Totali i kontratave/MK të raportuara	1619	30	2%

Teksojmë se, mos raportimi i datës së likujdimit të plotë të detyrimit financiar nga AK-të, vijon të ngelet një nga problematikat e hasura më shpesh, në formularët standardë të raportimit të zbatimit të kontratës.

Sa më sipër, në çdo rast të evidentimit të mangësive të formularëve standardë të dërguar nga autoritetet kontraktore, është komunikuar në mënyrë të përsëritur në rrugë shkresore dhe elektronike (*me anë të email-it zyrtar*) me AK-të përkatëse, (rreth **110** komunikime), ku është kërkuar informacion shtesë mbi ecurinë e zbatimit të kontratave, plotësimin e mangësive respektive të formularëve, si dhe ridërgimin e tyre pas likujdimit të plotë të detyrimit financiar.

➤ **Problematika të evidentuara nga analizimi i planeve të zbatimit të kontratave.**

Plani i Zbatimit të Kontratës është një dokument i parashikuar për herë të parë nga ligji i ri i prokurimit dhe, për pasojë hartimi i tij nga ana e autoriteteve kontraktore dhe dërgimi në APP ka filluar në gjysmën e dytë të vitit 2021.

Në këtë kuptim, gjatë shqyrtimit të planeve të zbatimit të dërguara në APP janë konstatuar problematika që lidhen kryesisht me mangësi apo pasaktësi në plotësimin e të dhënave. Gjithashtu, një pjesë e AK-ve kërkojnë asistencë mbi mënyrën e plotësimit të formularit të planit të zbatimit të kontratës.

Në çdo rast të evidentimit të mangësive të formularëve standardë të sipërcituar, APP ka komunikuar në rrugë shkresore dhe elektronike (me AK-të përkatëse, (rreth **220** komunikime), ku iu është kërkuar plotësimi i mangësive të evidentuara për çdo seksion respektiv të formularëve dhe janë asistuar, sipas rastit, e mbi mënyrën e plotësimit të planit të zbatimit të kontratës.

10. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË, ZBATIMI DHE MONITORIMI I TYRE

10.1 MONITORIMI I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PROKURIMIN PUBLIK 2020-2023

Gjatë vitit 2021, APP, në cilësinë e institucionit kryesor për koordinimin dhe monitorimin e zbatueshmërisë së Strategjinë Kombëtare për Prokurimin Publik (SKPP) 2020-2023, ka bashkëpunuar ngushësisht me institucionet, të cilat janë përgjegjëse për raportimin e progresit të aktiviteteve dhe treguesve të performancës së parashikuar.

Në këtë kuadër, është ngritur struktura monitoruese SKPP, e mbikqyrur nga Komiteti Drejtues, i cili kryesohet nga drejtori i përgjithshëm i APP, duke vijuar me Grupet e Qëllimit të Politikave dhe me Sekretariatit Teknik në APP, i cili siguron mbarëvajtjen e punës. Kjo strukturë u miratua në mbledhjen e parë të KD të datës 14 Korrik 2021. Në këtë takim u diskutua gjithashtu dhe përgatitja e raportit të monitorimit për vitin 2020 dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 dhe u kërkua angazhimi i institucioneve përgjegjëse për zbatimin e masave të parashikuara.

Në këtë kuadër, Sekretariati Teknik në APP, ka komunikuar me përfaqësuesit e institucioneve, pjesë e strukturës së monitorimit, për dërgimin e informacionit për vitin 2020 dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, me qëllim hartimin e raporteve përkatëse.

Bazuar në informacionin e marrë nga institucionet përkatëse, Sekretariati Teknik ka hartuar raportet e monitorimit për këto dy periudha, të cilat janë miratuar në mbledhjen e radhës të Komitetit Drejtues të datës 23 Dhjetor 2021.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në raportin e monitorimit për vitin 2020, ka rezultuar se nga totali i 19 aktiviteteve të parashikuara për të filluar zbatimin gjatë 2020, 7 prej tyre (37%) kanë mundur të realizohen plotësisht, ndërsa 10 (53%) janë në proces dhe janë realizuar pjesërisht, dhe 2 (10%) nuk janë realizuar. Ndërkohë, nga 10 tregues performance janë nxjerrë të dhëna për 7 prej tyre. Për këta tregues, rezulton që janë realizuar në masën 100 % 6 prej tyre, ndërsa për një tregues (TKP 9) nuk është nxjerrë vlera bazë. Ndërkohë, për 3 tregues të tjerë (TKP 2, TKP 5 dhe TKP 7), nuk ishte e mundur nxjerrja e të dhënave.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në raportin e monitorimit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, ka rezultuar se nga totali i 30 aktiviteteve të parashikuara për të zbatuar gjatë kësaj periudhe, 7 prej tyre (23%) kanë mundur të realizohen plotësisht, ndërsa 19 (63%) janë në proces dhe janë realizuar pjesërisht, 3 (10%) nuk janë realizuar, dhe për 1 aktivitet (3%) nuk ka informacion.

Ndërkohë, situata sa i takon treguesëve kyç të performancës (TKP) për gjashtëmujorin e parë të 2021, situata është si më poshtë vijon:

- TKP 1 “Cilësi më e mirë e mallrave, punëve dhe shërbimeve të fituara”- në vlerën 3.2% (realizueshmëria 100%);
- TKP 2 “Promovimi i pjesëmarrjes të SME-ve në procedurat e prokurimit publik”- nuk është matur;
- TKP 3 “Promovimi i konkurrencës së tregut”- 3.61% (realizueshmëria 100%);
- TKP 4 “Përmirësimi i Planifikimit të Prokurimeve”- 0.27% (realizueshmëria 100%)
- TKP 5 “Rritja e përfitimeve mjedisore dhe sociale të shërbimeve të ofruara nga organet publike”- nuk është matur;
- TKP 6 “Rritja e efikasitetit në dhënie të kontratës”- 14.14% (realizueshmëria 100%);
- TKP 7 “Përmirësimi i cilësisë së punëve dhe shërbimeve afatgjata”-nuk është matur;
- TKP 8 “Rritja e transparencës për kontratat e koncesionit dhe PPP”- 100% (realizueshmëria 100%);
- TKP 9 “Standartizimi i shërbimeve të ofruara nga organet publike” – 2.6% (nuk është realizuar);
- TKP 10 “Rritja e efikasitetit të sistemit të ankesave nëpërmjet rritjes së shpejtësisë në vendimmarrje”- 2.1%, 11.3%, 7.4%, 9.3%, 4.1% dhe 3.7% (realizueshmëria 100% në bazë mujore).



Për sa më sipër, sqarojmë se, për gjashtëmujorin e parë të 2021, nga 10 tregues performance janë nxjerrë të dhëna për 7 prej tyre. Për këta tregues, rezulton që janë realizuar në masën 100 % 6 prej tyre, ndërsa treguesi TKP 9 nuk është realizuar. Për 3 tregues të tjerë (TKP 2, TKP 5 dhe TKP 7), nuk ishte e mundur nxjerrja e të dhënave.

Në takimin e Komitetit Drejtues është kërkuar nga institucionet kontribuese bashkëpunimi i tyre dhe marrja e masave në raportimin e aktiviteteve dhe treguesëve të performancës të pa raportuar. Konkretisht, Ministrisë së Mbrojtjes iu kërkua të ketë rol aktiv në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për ngritjen e kapaciteteve për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ndërkohë, APP u shpreh se do të zhvillojë takime më intensive me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me qëllim që të garantohet një bashkëpunim më i frytshëm, në shërbim të adresimit të problemeve që u hasën për raportimin e aktiviteteve dhe treguesve të performancës të strategjisë dhe jo vetëm

10.2 STRATEGJITË NDËRSEKTORIALE

Prokurimi Publik është gjithashtu pjesë e rëndësishme e tre Strategjive ndërsektoriale kryesore të Qeverisë Shqiptare, konkretisht, (i) Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike, (ii) Strategjia Ndërsektoriale për Luftën kundër korrupsionit dhe (iii) Strategjia për Reformën në Administratën Publike.

Në këtë kuadër, APP ka bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet e përfshira në këto strategji dhe sidomos Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si institucionet koordinuese, duke raportuar rregullisht për zbatimin e masave të parashikuara në këto dokumenta.

Duhet theksuar se, sa i takon zbatimin të masave dhe realizimit të treguesve të performancës sipas këtyre strategjive situata paraqitet shumë pozitive për vitin 2021 si më poshtë:

- (i) APP ka përmbushur të gjithë indikatorët e parashikuar në strategjinë antikorrupsion për këtë vit, si më poshtë:
 - A.2.a: Përqindja e elementëve të modifikuar në Planet Vjetore të Prokurimit- 16.1% nga 20% të parashikuar;
 - A.2.b: Përqindja e kontratave të dhëna përmes procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës-3.4 nga 10% të parashikuar;
 - A.2.c: Përqindja e kontratave të ndryshuara gjatë vitit-0.8% nga 10% të parashikuar

Përmbushja e indikatorëve të mësipërm lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me transparencën e procesit të prokurimit, mirëplanifikimin e procedurave të prokurimit dhe efikasitetin në shpenzimin e fondeve publike dhe realizimin e kontratave.

- (ii) Po kështu, janë realizuar të gjitha aktivitetet e parashikuara në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike dhe është përmbushur indikatorin i parashikuar për këtë Strategji, konkretisht:
 - Përqindja në vlerë e procedurave të realizuara me fitues për gjashtëmujorin e parë të vitit në raport me fondin total të parashikuar për këtë periudhë në regjistrin e parashikimeve ka shënuar vlerën 60.2% në vitin 2021 duke shënuar rritje krahasuar me vitin paraardhës kur kjo vlerë ka qenë 47.4%.

Në parim, realizueshmëria e lartë e procedurave të parashikuara në regjistrin e parashikimeve është një tregues shumë i rëndësishëm që lidhet me mirëplanifikimin e procedurave të prokurimit nga ana e Autoriteteve Kontraktore dhe rritjen e efikasitetit në shpenzimin e fondeve publike.

- (iii) Reforma në Administratën Publike është një reformë e ndërmarrë në nivel rajonal ku të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqia janë angazhuar për zbatimin e parimeve kryesore për Administratën Publike të përcaktuara nga SIGMA/OECD. Përmbushja e këtyre parimeve dhe treguesve përkatës monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga SIGMA dhe Bashkimi Europian në kuadër të procesit të integritetit evropian për këto vende.


Kështu, në raportin e monitorimit të SIGMA për reformën në administratën publike në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi për vitin 2021, fusha e prokurimit publik në Shqipëri është vlerësuar me nota të larta në treguesit përkatës duke marrë vlerësim maksimal në 3 prej tyre.

Tabela dhe grafiku i mëposhtëm paraqesin në mënyrë krahasimore vlerësimin për të pestë treguesit që lidhen me prokurimin publik në të gjashta vendet e Ballkanit Perëndimor.

Tabela 111

Treguesit PAR 2021-Ballkani Perëndimor						
Treguesi	Vlerësimi 1-5					
	Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Kosova	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbia
6.10.1 - Cilësia e kuadrit ligjor për prokurimin publik dhe koncesionet/PPP	5	3	3	5	5	4
6.11.1 - Kapaciteti institucional dhe administrativ në nivel qendror për të zhvilluar, zbatuar dhe monitoruar politikat e prokurimit publik në mënyrë efektive dhe eficiente	5	3	4	3	4	4
6.12.1 - Pavarësia, afati kohor dhe kompetenca e sistemit të shqyrtimit të ankesave	5	3	4	4	5	4
6.13.1 - Efikasiteti, mosdiskriminimi, transparencja dhe trajtimi i barabartë i praktikuar në operacionet e prokurimit publik	3	1	3	1	3	3
6.14.1 - Disponueshmëria dhe cilësia e mbështetjes për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomik për të forcuar profesionalizimin e operacioneve të prokurimit	3	2	2	2	2	3

Burimi: Raportet e monitorimit të SIGMA për reformën në administratën publike në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi për vitin 2021



Burimi: Raportet e monitorimit të SIGMA për reformën në administratën publike në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi për vitin 2021

Sikurse shihet nga vlerat e mësipërme Shqipëria ka një vlerësim shumë të mirë në krahasim me vendet e tjera.

Kështu, Shqipëria është i vetmi vend i vlerësuar me vlerësim maksimal në lidhje me kapacitetet institucionale në nivel qendror për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave në fushën e prokurimit në mënyrë efektive dhe eficiente.

Një vlerësim i tillë lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me punën e jashtëzakonshme të Agjencisë së Prokurimit Publik (i) për hartimin e objektivave strategjike në fushën e prokurimit me qëllim garantimin e një sistemi prokurimi eficient dhe të qëndrueshëm; (ii) për hartimin dhe miratimin e kuadrit të ri ligjor në fushën e prokurimit; dhe (iii) për monitorimin e vazhdueshëm për zbatimin e politikave dhe implementimin në mënyrën e duhur të legjislacionit të prokurimit.

Ndërkohë, sa i takon cilësisë së kuadrit ligjor në fushën e prokurimit Shqipëria qëndron në të njëjtin nivel me Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, duke marrë vlerësimin maksimal për këtë indikator.

Po kështu, Shqipëria paraqitet në të njëjtin nivel me Maqedoninë e Veriut edhe sa i takon sistemit të shqyrtimit të ankesave duke u vlerësuar me notë maksimale edhe për këtë tregues.

Sa i takon 2 treguesve të tjerë Shqipëria ka arritur një nivel mesatar sipas vlerësimit të SIGMA duke u barazuar me Serbinë, por duke pasur një vlerësim më të lartë se Mali i Zi dhe Bosnje-Hercegovina në të dy këta tregues.

Vlerësimi pozitiv i Shqipërisë në këtë raport tregues i punës së jashtëzakonshme të ndërmarrë nga APP në drejtim të përmirësimit të sistemit të prokurimit në Shqipëri.

11. INTEGRIMI EUROPIAN DHE BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E TJERA VENDASE DHE TË HUAJA

11.1 INTEGRIMI EUROPIAN

Përbushja e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian, si edhe harmonizimi i sistemit të prokurimit në Shqipëri me praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare është një nga drejtimet kryesore të veprimtarisë së Agjencisë së Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, APP, në cilësinë e kryesuesit të punës për Kapitullin V të acquis-së: “Prokurimi Publik” ka marrë të gjitha masat e nevojshme për koordinimin e aktiviteteve në drejtim të përbushjes së detyrimeve, që rrjedhin nga ky kapitull.

Konkretisht, APP ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Kryenegociatorin e Shqipërisë për procesin e anëtarësimit në BE, duke raportuar në mënyrë periodike mbi zhvillimet e ndodhura në këtë kapitull.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2021, sikurse u analizua më sipër, është punuar në mënyrë intensive për të plotësuar kuadrin ligjor në fushën e prokurimit nëpërmjet hartimit dhe miratimit të një sërë aktesh nënligjore në zbatim të ligjit të ri të prokurimit.

Këto akte jo vetëm sigurojnë zbatueshmërinë e dispozitave të ligjit të ri të prokurimit, por gjithashtu rrisin shkallën e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar në këtë fushë me acquis-në përkatëse të Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira evropiane.

Sa më sipër është vlerësuar edhe nga Komisioni Evropian në raportin e progresit për vitin 2021, sipas të cilit, “Shqipëria është mesatarisht e përgatitur dhe ka pasur përparim të mirë, sa i takon prokurimit publik, veçanërisht nëpërmjet miratimit të ligjit të ri për prokurimin publik dhe strategjisë kombëtare për prokurimin publik pas konsultimeve të gjera publike”. Gjithashtu, në këtë raport theksohet se rekomandimet e dhëna në vitin 2020 janë zbatuar në masën më të madhe.

Sa i takon përputhshmërisë së legjislacionit në fushën e prokurimit publik me direktivat e BE-së, me anë të miratimit të Ligjit të ri për prokurimin publik në 2020, të rregullave për prokurimin publik në Maj të 2021, DST-ve, udhëzimeve, VKM për format e komunikimit, VKM për kodet CPV dhe VKM për shërbimet sociale dhe shërbimet e tjera specifike është arritur një përafrim i konsiderueshëm i Direktivës 2014/24/EU dhe Direktivës 2014/25/EU.

Gjithashtu, ligji i ri i prokurimit publik dhe rregullat e prokurimit sigurojnë një rritje të nivelit të përputhshmërisë dhe përafrimit me direktivat 89/665/EEC dhe 92/13/EEC, lidhur me procesin e shqyrtimit të ankesave, pavlefshmërisë së kontratave dhe dëmshpërblimeve.

Plotësimi i kuadrit ligjor në fushën e prokurimit shënon edhe përbushjen e një prej rekomandimeve kryesore të lëna nga Komisioni Evropian në raportin e vitit 2021.

Rritja e shkallës së përputhshmërisë të legjislacionit shqiptar me acquis-në përkatëse të Bashkimit Evropian në fushën e prokurimit publik është një hap shumë i rëndësishëm edhe në kuadër të hapjes së pritshme të negociatave duke pasur parasysh që Kapitulli 5, Prokurimi Publik sipas metodologjisë së re të Komisionit Evropian është bërë pjesë e grupit të parë të kapitujve që hapen për negociim dhe progresi në këtë grup është parakusht për hapjen e negociatave në grupet dhe kapitujt e tjerë.

11.2 BASHKËPUNIMI I APP ME INSTITUCIONE TË HUAJA

Gjatë këtij viti, APP ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë me SIGMA/OECD në kuadër të nismave të reja ligjore, sa i takon fushës së të prokurimit publik në Shqipëri.



Konkretisht, SIGMA ka vijuar të jetë ndihmesë shumë e madhe gjatë procesit të hartimit të legjislacionit dytësor në fushën e prokurimit publik duke ofruar komente dhe sugjerime nga ekspertët e saj nëpërmjet komunikimeve elektronike të vazhdueshme si dhe organizimit të takimeve.

Gjithashtu, APP ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me SIGMA gjatë procesit të hartimit nga ana e tyre e raportit të monitorimit për reformën në administratën publike në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi. Sa i takon prokurimit publik, Shqipëria ka pasur një vlerësim shumë të mirë ku për 3 indikatorë është vlerësuar me vlerësimin maksimal 5 dhe për 2 të tjerë me vlerësimin 3, duke shënuar një përmirësim të dukshëm në krahasim me vlerësimin e vitit 2017.

APP ka patur një bashkëpunim shumë të mirë edhe me zyrën e OSBE në Tiranë, e cila ka dhënë asistencën e saj në hartimin e udhëzuesit për profesionalizimin e prokurimit publik në Shqipëri dhe planin e trajnimit të detajuar për këtë qëllim. Gjithashtu, OSBE ka asistuar në Hartëzimin e Riskut të Korrupsionit (CRM), i cili është një vlerësim gjithëpërfshirës i thelluar i procedurave të prokurimit për sektorë të synuar për të identifikuar shkaqet kryesore të praktikave të korrupsionit, për të analizuar boshllëqet dhe për të rekomanduar mundësi për përmirësimin e kuadrit aktual të politikave si procedurat e menaxhimit operacional

Vlen të theksohet, gjithashtu, dhe asistencën e OSBE në organizimin e sesioneve informuese për Autoritetet Kontraktore, në kuadër të hyrjes në fuqi të ligjit të ri për prokurimit publik dhe miratimit të legjislacionit të ri dytësor, me qëllim njohjen e tyre me kuadrin e ri ligjor dhe risitë e sjella prej tij.

APP ka bashkëpunuar, gjithashtu, me BERZH në kuadër të hartimit të dokumentave standarde të tenderit në vijim të hyrjes në fuqi të ligjit të ri të prokurimit.

Ndërkohë, APP vazhdon bashkëpunimin e ngushtë edhe me institucione të tjera ndërkombëtare si Banka Botërore sa i takon çështjeve që lidhen me fushën e prokurimit publik. Konkretisht, Banka Botërore ka bashkëpunuar me APP në përfshirjen e kriterëve të prokurimit të gjelbërt (green procurement) në procedurat e prokurimit publik, si dhe në hartimin e një udhëzimi për prokurimet në rastet e emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore.

11.3 BASHKËPUNIMI I APP ME INSTITUCIONE TË TJERA NË SHQIPËRI

Gjatë këtij viti, APP ka vijuar bashkëpunimin me institucionet, me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, si: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Autoriteti i Konkurrencës, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, nëpërmjet këmbimit të informacioneve respektive mbi operatorët ekonomikë fitues të procedurave të prokurimit dhe verifikimit të faktit nëse këta operatorë ushtrojnë veprimtarinë, duke zbatuar kërkesat e legjislacionit në fuqi, sipas fushave respektive, që mbulon secili prej këtyre institucioneve.

Gjithashtu, vlen të theksojmë se, APP ka nënshkruar gjatë këtij viti edhe dy memorandume bashkëpunimi, përkatësisht me:

- Institutin e Studimeve Europiane në Universitetin e Tiranës, me qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërmjet palëve në fusha me interes të përbashkët;
- ILDKPKI, me qëllim rritjen e integritetit të zyrtarëve në prokurimet publike dhe ndërgjegjësimin e tyre për zhvillimin e procedurave të prokurimit në mënyrë të pavaruar dhe të pandikuar nga interesat private.
- ❖ Në vijim të angazhimit të ndërmarrë nga Marrëveshja e Bashkëpunimit me AKU, APP ka dërguar pranë këtij institucioni çdo tre muaj, informacion mbi fituesit e procedurave të prokurimit, që kanë si objekt produktet ushqimore. Nga këmbimi i informacioneve ndërmjet dy institucioneve kanë rezultuar raste të dy operatorëve ekonomikë të listuar si fitues në procedurat e prokurimit me objekt produkte ushqimore, të cilët nuk plotësonin kushtet për ushtrimin e aktivitetit dhe vijon puna për verifikimin e mëtejshëm të tyre.

Gjithashtu në kuadër të këtij bashkëpunimi, APP ka përcjellë pranë AKU një problematikë të konstatuar gjatë ushtrimit të detyrave funksionale të saj, duke i kërkuar intensifikimin e kontrolleve ndaj opera-

torëve ekonomikë të shpallur fitues në procedurat e prokurimit për produkte ushqimore, si institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e sigurisë ushqimore në Shqipëri dhe autoriteti kompetent me funksione inspektuese për menaxhimin në nivel kombëtar të fushës së sigurisë dhe mbrojtjes së konsumatorit.

- ❖ Në vijim të angazhimit të ndërmarrë nga Memorandumi i Bashkëpunimit, me Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, APP ka dërguar pranë këtij institucioni, informacione periodike mbi operatorët ekonomikë që kanë lidhur kontrata për periudhat tre mujore, gjatë gjithë vitit kalendarik. Bashkëpunimi me këtë institucion është i vazhdueshëm në drejtim të relatimit nga APP, të operatorëve ekonomikë që kanë përfutur fonde publike, dhe verifikimit nga ISHPSHSH nëse këta operatorë kanë genë të penalizuar, për mosrespektim të kërkesave të legjislacionit të punës në fuqi.

Në këtë kuadër, nga ana e ISHPPSHSH janë relatuar pranë APP disa raste, ku subjekte të ndryshëm janë dënuar me gjobë për shkelje të legjislacionit të punës nga ky institucion. Në vijim, pas verifikimeve paraprake, APP ka nisur procedimet administrative përkatëse për përjashtimin e këtyre operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike pasi, nga verifikimet e kryera ka rezultuar se një pjesë e mirë e tyre kanë marrë pjesë dhe janë shpallur fitues në procedura prokurimi, duke deklaruar se, nuk kanë masë ligjore në fuqi.

Vlen të theksohet se, gjatë këtij viti nga ky bashkëpunim institucional dhe raportim i ndërsjelltë kanë nisur 6 procedime administrative për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike për keqinformim për qëllime kualifikimi në procedurat e prokurimit.

Nga këto procedime, njëri është mbyllur me vendim mospërjashtimi, për shkak se nga hetimi administrativ është provuar se subjekti në fjalë e ka paguar masën e gjobës para se të marrë pjesë në procedurën e prokurimit të hetuar, dhe për 5 raste të tjera, hetimi administrativ është në proces.

- ❖ Në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me Autoritetin e Konkurrencës, APP ka komunikuar me këtë institucion, duke i përcjellë për hetim disa raste të denoncuar nga subjekte të ndryshëm, me pretendime për marrëveshje të fshehta në oferta, duke vënë theksin se, nxitja e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, në procesin e prokurimit publik është një nga parimet kryesore të këtij procesi, në funksion të mirëpërdorimit të fondeve publike, dhe rritjes së efektivitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik.

Në këtë kuptim, APP vlerëson mjaft të rëndësishëm pengimin e marrëveshjeve të fshehta ndërmjet ofertuesve, të cilat ngushtojnë dhe deformojnë konkurrencën në procesin e prokurimit publik.

Për këtë qëllim, APP ka vlerësuar bashkëpunimin dhe angazhimin e Autoritetit të Konkurrencës për hetimin e rasteve, të cilat mund të rezultojnë në deformim të konkurrencës.

- Vlen të theksohet se bashkëpunimi me institucionet e sipërpërmendura dhe vendosja e mekanizmave kontrollues në procesin e prokurimit për operatorët ekonomikë, luajnë një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin e këtyre operatorëve për respektimin e kërkesave të legjislacionit të punës, kërkesave ligjore në fuqi për subjektet që tregtojnë produkte ushqimore, si objekte sensitive, dhe legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës. Nëpërmjet mekanizmit të vetdeklarimit, si një kërkesë detyruese për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedura prokurimi, se respektojnë kërkesat ligjore në fushat e sipërcituara, arrihet të gjurmohen dhe identifikohen raste kur këto kërkesa nuk zbatohen në praktikë.
- ❖ Në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me Komisionin e Prokurimit Publik (në vijim "KPP"), si dhe të neneve 94 dhe 99 të VKM 285/2021, APP ka bashkëpunuar me KPP për hartimin e formularit standard të ankesave dhe Formularit të paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë Autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, formulari standard i ankesave të operatorëve ekonomikë që i drejtohet njëkohësisht autoriteteve/enteve kontraktore dhe KPP, si dhe Formulari i paraqitjes së argumentave nga



operatorët ekonomikë të interesuar pranë Autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik është bërë pjesë e setit të DST.

- ❖ Gjatë këtij viti, APP përveç bashkëpunimit me institucionet në kuadër të marrëveshjeve përkatëse, si kurse referuar më sipër, ka komunikuar e bashkëpunuar edhe me institucione të tjera shtetërore për të adresuar problematika të ndryshme të konstatuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, me qëllim shmangien e tyre në procesin e prokurimit në të ardhmen, konkretisht APP ka komunikuar me:
 - Ministrinë e Mbrojtjes për draftimin e dokumentave të tenderit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.
 - Shoqërinë “Illyrian Guard” në adresimin e vazhdueshëm të problematikave të konstatuara për pamundësinë e sigurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike nga autoritetet kontraktore, ku kësaj shoqërie i është kërkuar marrja e masave të nevojshme për të siguruar zbatimin e legjislacionit në fuqi, për ofrimin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, për institucionet dhe subjektet publike.
 - Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ku i është referuar një rast për t’u trajtuar në fushën e kompetencave të saj. Konkretisht, gjatë një procedimi administrativ, APP ka konstatuar një nga drejtuesit teknik të një shoqërie ishte i punësuar edhe në një institucionin shtetëror, në kundërshtim parashikimet e VKM Nr.759, datë 12.11.2014 *“Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjen e kolaudimin e punimeve të zbatimit në ndërtim”*, i ndryshuar. Për këtë qëllim, ka vlerësuar t’i drejtohet këtij institucioni duke i referuar për kompetencë këtë rast, për të vlerësuar dhe gjykuar më tej, sipas parashikimeve ligjore.
 - Marrë shkas nga problematikat e konstatuara gjatë shqyrtimit të raporteve audituese të KLSH, APP i është drejtuar MIE, duke i sugjeruar që gjatë përditësimit të Manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit, në përllogaritjen e kostos për shpenzime punëtorie, sa i takon pagës bazë minimale orare vlerësohet se duhet të përdoret terminologjia *“sipas legjislacionit në fuqi”*, në mënyrë që manuali të mos pësojë ndryshime sa herë që pëson ndryshime VKM-ja përkatëse që rregullon pagën minimale.
 - APP ka adresuar pranë MIE problematikën e përcjellë nga disa shoqëri që operojnë në fushën e hidrokarbureve, ku këta të fundit kanë parashtruar shqetësime në lidhje me kriterin e vlerësimit në bazë të çmimit më të ulët, pasi sipas tyre ky mall kuotohet me bursë dhe çmimi i tij ka luhatur çdo ditë në varësi të bursës. Për këtë qëllim, APP ju drejtua MIE, në cilësinë e institucionit kompetent që mbulon ndër të tjera edhe sektorin e hidrokarbureve, për një mendim të specializuar për problematikën e sipërcituar.
 - Në mbështetje të Ligjit Nr. 112/2015 *“Për inspektimin financiar publik”*, APP i është drejtuar Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik në cilësinë e institucionit që ka si mision garantimin e zbatimit të ligjshmërisë fondeve publike, duke i referuar për kompetencë një rast të denoncuar nga një subjekt gjatë ushtrimit të detyrave të saj, ku pretendohet se, AK ka shpallur procedurën pa vendimarrjen e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë për kontratën aktuale, si dhe ka kryer disa veprime për ndryshimin e objektit të kontratës së lidhur me shoqërinë ankuese që e ka ende në proces.

12. TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE DHE PUBLIKIMIN

Ligji i ri i prokurimit publik përcakton APP si institucion përgjegjës për menaxhimin e bazës së të dhënave të Sistemit të Prokurimit Elektronik, përpunimin e tyre dhe përgatitjen e statistikave në lidhje me prokurimin publik në Shqipëri.

Gjithashtu, ligji i mësipërm e përcakton APP si institucion përgjegjës për hartimin dhe publikimin e Buletinit të Njoftimeve Publike.

Për sa më sipër, në këtë seksion trajtohet në mënyrë të detajuar veprimtaria e APP në këto drejtime.

12.1 VEPRIMTARIA E PUBLIKIMIT

Në kuadër të publikimeve që lidhen me zhvillimin e procedurave të prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, APP luan një rol të posaçëm në drjetin të kontrollit të zërave të regjistrave të parashikimit të procedurave të prokurimit publik duke miratuar apo refuzuar elementët në sistemin elektronik të prokurimit të cilët nuk janë publikuar në përputhje me parashikimet ligjore dhe kanë mangësi.

Gjithashtu, APP verifikon të gjithë njoftimet që dërgohen në sistem nga autoritetet kontraktore për publikim me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit dhe më pas kryen publikimin e tyreverikon dhe publikon njoftimet për procedurat e prokurimit publik/procedurat konkurruese të koncesioneve/ppp/ ankandet të zhvilluara nga AK, si dhe verifikon dhe publikon në Buletinin e APP çdo informacion tjetër që paraqitet pranë APP-së për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Në këtë kuadër, gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2021 janë përgatitur për publikim në total 192 Buletine të Njoftimeve Publike, nga të cilët 140 kanë qenë Buletine të Posaçëm në lidhje me procedurat e prokurimit publik për Rindërtimin, me një numër faqe në total prej 36.960 faqe ose mesatarisht 3080 faqe për muaj.

12.1.1 PUBLIKIMI I NJOFTIME NË SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK

Gjatë vitit 2021 janë verifikuar dhe publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe më pas në Buletinin e Njoftimeve Publike të rradhës:

- **5079** Njoftime Kontratash të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimimit;
- **4078** Njoftime Fituesish të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimimit;
- **4185** Njoftime Kontratash të Nënshkruara për procedura të kryera në Sistemin e Prokurimit Elektronik;
- **143** Njoftim fituesi për procedurat me negociim pa shpallje paraprake,
- **143** Njoftime Kontratash të Nënshkruara për procedurat me negociim pa shpallje paraprake, përfshi këtu edhe shtesat e kontratave, për plotësimin e nevojave të vitit 2019;
- **1042** Njoftime Anullimi të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimimit.
- **145** Njoftime Kontratash në kuadër të rindërtimit, të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke reflektuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm njoftimet për të cilat janë respektuar afatet e ankimimit;
- **13** Njoftime Anullimi për procedurat në kuadër të rindërtimit, të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave si dhe
- **126** njoftim fituesi dhe lidhje kontrate të publikuara në Buletinet e posaçme, etj.



12.1.2 PUBLIKIMI I NJOFTIME PËR ANKANDE PUBLIKE NË BULETININ E NJOFTIMEVE PUBLIKE

Gjatë vitit 2021 janë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike për procedurat e ankandeve publike:

- 338 Njoftime për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 99 Njoftime Fituesish për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 30 Njoftime Kontratash të Nënshkruara për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 115 Njoftime Anullimi për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 129 Njoftime për qera.

12.1.3 NJOFTIME PËR KONCESIONE/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT DHE TË NJOFTIME TË TJERA

Gjatë vitit 2021 janë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike:

- 4 Njoftime Kontratash për Procedura Koncesioni.
- 15 Njoftime për Procedura konkurruese për dhënie leje minerare
- 671 Njoftime të tjera.

12.1.4 PUBLIKIMI I ELEMENTËVE TË REGJISTRIT NË SISTEM

Gjatë vitit 2021 janë përpunuar rreth 44432 elementë të regjistrave (zera të rinj dhe ndryshimet e kryera gjatë vitit nga autoritetet kontraktore) në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, nga të cilat rreth **36926** janë elementë të publikuar ndërsa 44432 janë elemente të refuzuar për shkak të mos plotësimit të të dhenave sakte nga autoritetet.

Tabela 112

Numri i elementëve të trajtuar nga Sektori i Publikimit	
Numri i elementëve të publikuar	36926
Numri i elementëve të refuzuar	7506
Totali	44432

Gjatë kësaj periudhe, vlen të citohet gadishmëria e treguar për publikimin e elementeve sipas emergjencave të paraqitur 24 x 7 ditët e javës.

12.1.5 PRAKTIKAT E SHQYRTUARA

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021 janë trajtuar 2637 praktikat të detajuara si më poshtë:

Tabela 113

Lloji i kërkesës	Numri:
Shkresa të trajtuara dhe të arkivuara	2259
Shkresa të trajtuara dhe kthyer pergjigje	378

12.2 ADMINISTRIMI I TË DHËNAVE NË SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK

Gjatë vitit 2021 APP ka vijuar punën në këtë drejtim duke u kujdesur për mirëfunksionimin e ndërfaqes së APP, asistencës teknike për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë, zgjidhjen e problematikave të ndryshme si edhe përgatitjen e manualeve të ndryshme teknike.

12.2.1 OBJEKTIVAT E LIDHURA ME ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE DHE STATISTIKAVE

Në kuadër të funksionit dhe kompetencave të APP si Administrator i bazës së të dhënave në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe përpunimit të tyre për efekt të përgatitjes së Statistikave që lidhen me funksionimin e prokurimit publik në Shqipëri, më poshtë analizohen objektivat kryeore në këtë drejtim dhe realizimi i tyre.

- **Përmirësimi i vazhdueshëm dhe optimizimi i ndërfaqes, me qëllim përmirësimin dhe lehtësimin e punës së përdoruesve.**

Në vijim të miratimit dhe hyrjes në fuqi të kuadrit të ri ligjor, lind nevoja për përmirësime dhe shtim funksionalitetesh në sistemin elektronik, me qëllim reflektimin e të gjitha ndryshimeve dhe risive të përfshira në legjislacion për të garantuar implementimin e tyre. Kështu, gjatë vitit 2021 në Sistemin e prokurimit Elektronik, është komunikuar me AKSHI-n për të realizuar përmirësimet e mëposhtme:

- Unifikim i kodeve CPV sipas legjislacionit të ri të prokurimit publik
- Ndryshim i afateve të ankimimit për procedurat e prokurimit konkurruese sipas ndryshimeve të legjislacionit të prokurimit publik
- Ndryshim i kriterëve të vlerësimit “Oferta ekonomikisht më e favorshme e bazuar në çmim” dhe “Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto”, sipas legjislacionit të ri.
- Ndryshime në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, duke shtuar fazën e afatit të ankimimit dhe njoftimin e operatorëve ekonomikë në momentin që fillon afati i ankimimit.
- Gjatë kësaj periudhe janë kryer përmirësime në shfaqjen e fushave apo informacioneve të nevojshme për zbatimin e detyrave të përditshme të përdoruesve si:
 - Përmirësime në ndërfaqet e Rolit e Publikuesit, duke shtuar fusha për të shfaqur informacionin nëse procedura është e krijuar si Marrëveshje kuadër apo jo, etj.
 - Përmirësime në ndërfaqet e Rolit të Audituesit, duke shtuar tek raportet që gjenerohen nga sistemi datën e ngarkimit të dokumentave nga nëpunësi i autorizuar, duke bërë pjesë të këtyre raporteve informacionin në lidhje me procesverbalet elektronike për rastin e prokurimit me vlerë të vogël dhe sistemin dinamik për biletat, etj
 - Përmirësim në ndërfaqet e Rolit të Audituesit, duke mundësuar shfaqjen e kërkesave të dërguara nga operatorët ekonomikë edhe në rastin kur procedura është e arkivuar.
 - Përmirësime në Raportet që gjenerohen nga sistemi për rolin Analist prokurimesh, etj.
- Ndryshim i formatit të vërtetimit të mospërgjashtimit të dërguar drejt operatorëve ekonomikë, gjatë aplikimit në e-Albania për t’u pajisur me vërtetim mospërgjashtimi.
- Ndryshim i Programit të Transparencës në faqen zyrtare të APP, sipas kërkesës nga Koordinatorin për të drejtën e Informimit.
- Dergimi i njoftimit të anëtarëve të njëjësive të prokurimit dhe anëtarëve të KVO me anë të e-mail 24 orë përpara hapjes dhe vlerësimit të ofertave si dhe me anë të sistemit.
- Ekspozimi i të dhënave me Sistemin elektronik të ankesave dhe Komisionin e Prokurimit Publik
- Integrimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik me AFMIS
- Realizimi i Open data në kuadër të transparencës



Të gjitha ndryshimet e mësipërme janë shoqëruar me përgatitjen e manualeve teknike përkatëse, konkretisht:

- Manual teknik për krijimin e elementëve të regjistrit pas ndryshimeve ligjore
 - Manual teknik për krijimin në Sistemin e Prokurimit Elektronik të marrëveshjes kuadër dhe të minikontratave
 - Manual mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar
 - Manual mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël
 - Manual për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike
 - Manual për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistem
 - Manual teknik për integrimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik me Thesarin
- **Garantimi në kohë dhe me cilësi i ecurisë së punës për të gjithë përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) dhe Sistemit të Arkivës Elektronike (SAE) si dhe garantimi i konfidencialitetit të ofertës ekonomike duke bërë enkriptimin dhe dekriptimin çka ka bërë që informacioni me ndjeshmëri të lartë të jetë i përdorshëm vetëm për ata persona që janë të autorizuar ta shohin ose ta përdorin atë.**

Sistemi e Prokurimit Elektronik është mbajtur “online”, 24 orë në 7 ditë të javës, përveç rasteve kur nxjerrja e tij “offline” për një periudhë shumë të kufizuar, ka qenë e nevojshme për kryerjen e shërbimeve përkatëse, apo shtimin e funksionaliteteve të reja, proces për të cilin paralajmërohet me anë të një njoftimi, pa cenuar në asnjë moment afatet e procedurave të prokurimit të shpallura në sistem.

Rezultati i punës së APP në këtë drejtim ka qenë administrimi i sigurt i një totali baze të dhënash sipas tabelës së mëposhtme:

- 5,25 TB (5,253,253,685,248 bytes) të Sistemit të Prokurimit Elektronik,
- 10,6 TB (10,679,372,873,728 bytes) të Sistemit të Arkivës Elektronike të re.
- 11.68 TB (11,684,030,087,168 bytes) të Sistemit të Arkivës Elektronike të vjetër.

Tabela e kapaciteteve të bazës së të dhënave për vitin 2021 krahasuar me 2020:

Tabela 114

Nr.	Viti	2020	2021
1	Sistemi i Prokurimit Elektronik (në bytes)	4,981,300,359,168	5,253,253,685,248
2	Arkiva Elektronike e Re (në bytes)	8,470,879,912,960	10,679,372,873,728
3	Arkiva Elektronike e vjetër (në bytes)	11,684,030,087,168	11,684,030,087,168
	Totali (në bytes)	25,136,210,359,296	27,616,656,646,144
	Totali (në Terabyte)	25	27,6

- **Zgjidhja e problematikave të ndryshme hardware dhe software, gjatë punës së përditshme duke garantuar ecurinë normale të prokurimit elektronik.**

Gjatë vitit 2021, është realizuar upgrade storage të infrastrukturës së Sistemit të Prokurimit Elektronik, me qëllim rritjen e performancës së sistemit live. Gjithsesi, duke parë ecurinë e rritjes së kapacitetit të të dhënave është e nevojshme shtim kapacitetesh në infrastrukturën hardware dhe në infrastrukturën network të Sistemit të Prokurimit Elektronik dhe të Sistemit të Arkivës Elektronike, me qëllim përmirësimin e performancës dhe disponueshmërisë së SPE.

- **Dhënia e asistencës teknike për përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik**

Detyrat kryesore të APP në kuadër të funksionit të saj për garantimin e asistencës teknike janë fokusuar në drejtimet e mëposhtme:

- Garantimi i asistencës teknike për të gjitha autoritetet kontraktore, si dhe të gjithë operatorët ekonomikë të huaj dhe vendas të cilët përdorin sistemin e prokurimit elektronik, nëpërmjet e-mail-ëve, telefonit apo dhe konsultimeve në ambientet e APP. Këtu vlen të përmendet se numri i lartë telefonatave apo e-maileve.

Në këtë kuadër janë dërguar rreth 4856 e-maile në total, si më poshtë:

- sqarime dhe udhëzime të karakterit juridik për autoritetet kontraktore;
 - sqarime dhe udhëzime të karakterit teknik për autoritetet kontraktore;
 - sqarime dhe udhëzime për operatorët ekonomikë (për konfirmimin e regjistrimeve të bëra online, për rikthim të fjalëkalimit në gjendjen fillestare);
 - dërgim të dhënash dhe informacionesh institucioneve të tjera
- Garantimi i asistencës teknike për llogari audituese për çdo auditues të Autoriteteve Kontraktore si dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.
- Pasurimi i portalit të APP me informacione të përditësuara në lidhje me procesin e prokurimit si, (i) akte ligjore dhe nënligjore të miratuara apo ndryshuara; (ii) udhëzime, rekomandime, njoftime, sjellje në vëmendje etj për AK dhe OE; (iii) dokumentat standarde të tenderit; (iv) vendime për verifikimin e procedurave, (v) vendime për përjashtimin e OE; (vi) dokumenta për konsultim etj.
 - Sigurimi i back-up ditor, javor dhe mujor i Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) dhe Sistemit të Arkivës Elektronike (SAE), si dhe ruajtja tek AKSHI.
 - Hartimi i specifikimeve teknike për kontratat që APP ka lidhur me të tretët.
 - Krijimi, azhurnimi, si dhe mbyllja e llogarive të Sistemit të Prokurimit Elektronik
 - Monitorimi i procedurave të prokurimit të lëna pezull në sistem dhe tërheqja e vëmendjes ndaj personave përgjegjës konform legjislacionit në fuqi.
 - Arkivimi i të gjitha procedurave të lëna pezull nga Autoritetet Kontraktore. Ky proces bën të mundur që sistemi operacional, në të cilin kryhen të gjitha procedurat e prokurimit publik, të lehtësohet ndjeshëm duke ulur gjithmonë e më shumë numrin e procedurave që ndodhen në të dhe, për pasojë, duke lehtësuar punën e përdoruesve të sistemit (Autoritete Kontraktore, Operatorë Ekonomikë, Auditues).
 - Përgatitja e Statistikave për APP.

APP në cilësinë e institucionit përgjegjës për administrimin dhe përpunimin e të dhënave nga SPE është angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për përgatitjen e Statistikave që lidhen me tregues të ndryshëm.

Konkretisht, gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2021 janë nxjerrë statistika si më poshtë:

- Statistika periodike në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik dhe përmbushjen e indikatorëve për këtë Strategji;
- Statistika periodike në kuadër të raportimeve të APP për Strategjitë e tjera ndërsektoriale dhe përmbushjen e objektivave dhe indikatorëve që lidhen me prokurimin publik si Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit dhe Strategjia për Menaxhimin Financave Publike;
- Statistika në kuadër të raportimit për procesin e vlerësimit të SIGMA në kuadër të përgatitjes së raportit të vlerësimit për zbatimin e reformës në administratën publike për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, që u publikua në muajin Nëntor 2021.
- Statistika në kuadër të memorandumëve të bashkëpunimit të nënshkruara nga APP me institucione të tjera lidhur me Operatorët Ekonomikë që kanë fituar kontrata në periudhën Janar- Dhjetor 2021,



- Statistika për Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi procedurat e prokurimit të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues dhe kontrata për periudha të ndryshme.
- Të dhëna të tjera për Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit mbi procedurat e prokurimit të fituara nga subjektet e ndryshme objekt kontrolli.
- Statistika të ndryshme për Bankën Botërore, BE, SIGMA dhe institucione të tjera kombëtare apo ndërkombëtare sipas kërkesës.

12.2.2 PRAKTIKAT E SHQYRTUARA NË KUADËR TË ADMINISTRIMIT TË TË DHËNAVE DHE STATISTIKAVE.

Gjatë vitit 2021, nga APP janë trajtuar 1020 shkresa dhe memo në total, të cilat lidhen me aktivitetin e saj në drejtim të Administrimit të të Dhënave dhe Statistikave ku përfshihen:

- Krijim/ Mbyllje llogarie në rolin CA Admin dhe Operator Ekonomik, si dhe rikthim fjalëkalimi në gjendje fillestare (602);
- Shkresa sqaruese me Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë (375);
- Memo të brendshme dhe memo për bashkëpunim me Drejtoria Juridike, Verifikimit dhe Integritimit në APP (156);
- Shkresa për persona përgjegjës 43,

Tabela 115

Praktikat e shqyrtuara gjatë vitit 2021 sipas llojit të kërkesës	
Lloji i Kërkesës	Numri
Kërkesa për mbyllje llogarie/ ndryshim fjalëkalimi	602
Kërkesa për asistencë teknike/sqarime dhe për dërgim të dhënash dhe bashkëpunim me institucionet e tjera	375
Shkresa për arkivim dhe persona përgjegjës	43
Totali	1020

Siç shihet edhe nga të dhënat e mësipërme numrin më të lartë të shkresave të dërguara dhe të trajtuara e zënë kërkesat për krijim llogarie përdoruesi, ndryshim fjalëkalimi, të cilat kryhen nga Administratori i Menaxhimit të përdoruesve.

Tabela 116

Kërkesat për ndryshim fjalëkalimi dhe pajisje me llogari përdoruesi në SPE	
Kërkesat për Ndryshim fjalëkalimi	436
Kërkesat për Krijim llogarie përdoruesi	103
Kërkesa të tjera (bllokim llogarie, riaktivizim, etj)	63
Totali	602

12.2.3 KRIJIMI I PËRDORUESVE TË RINJ PËR VITIN 2021

Për vitin 2021 në sistemin e prokurimit elektronik janë krijuar 4776 përdorues të rinj, dhe përkatësisht:

Nga APP gjatë vitit 2021 janë krijuar 26 llogari të reja në rolin “Administrator i Sistemit” për Autoritetet Kontraktore. Ndërsa nga llogaritë e Administratorëve të Autoriteteve Kontraktore janë krijuar në total rreth 4750 përdorues të rinj.

Në tabelën e mëposhtëm paraqitet numri i përdoruesve të Sistemit të Prokurimit Elektronik, brenda Autoriteteve Kontraktore, të krijuar përkatësisht në vitin 2021.

Tabela 117


Roli i Llogarisë	Llogarive të Përdoruesve të krijuar gjatë vitit 2021
Administrator i Sistemit për AK	26
Njësi Prokurimi	2238
Komisioni i Vlerësimit të Ofertave	2142
Auditues i AK	366
Auditues	4
Totali	4776

Në tabelën dhe në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i përdoruesve të Sistemit të Prokurimit Elektronik, të krijuar përkatësisht në vitin 2021, sipas muajve.

Tabela 118

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Numri i përdoruesve	543	554	511	327	351	424	328	250	331	384	337	293

Grafiku 49



Gjithashtu, në sistem rezultojnë rreth 41551 llogari përdoruesi në rolin e njësisë së prokurimit, anëtarët të KVO, auditues etj në statusin joaktiv dhe 28787 llogari përdoruesi në rolin e njësisë së prokurimit, anëtarët të KVO, audituesit në statusin aktiv. Ndërsa në rolin e Administratorit të Sistemit për autoritetin kontraktor janë 707 në statusin joaktiv dhe 1743 në statusin Aktiv.



Tabela e mëposhtme paraqet statusin i llogarive të përdoruesve nga Autoritet Kontraktore në Sistemin e Prokurimit Elektronik:

Tabela 119

Roli i Llogarisë	Llogari përdoruesi Aktive	Llogari përdoruesi joaktive
Administrator i Sistemit për AK	1743	707
Njësi Prokurimi	12551	17688
Komisioni Vlerësimit të Ofertave	14820	20859
Auditues i AK	1398	2977
Auditues i KPP	18	27

Përsa i përket, llogarive të përdoruesve në rolin e operatorëve ekonomikë, për vitin 2021 në Sistemin e Prokurimit Elektronik janë regjistruar 17834 operatorë ekonomikë të rinj, nga të cilët 123 janë operatorë ekonomikë të huaj, krahasuar me vitin 2020 ku kishim 14495 operatorë ekonomikë të rinj.

Pajisja e operatorëve ekonomikë me llogari përdoruesi kryhet nga APP, si dhe falë shërbimit të ndërveprimit me sistemin e Qendrës Kombëtare e Biznesit, ku automatikisht çdo operator ekonomik i regjistruar në QKB pajiset me llogari përdoruesi në SPE.

Tabela 120

Roli Muaji \	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qer-shor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Economic Operator nga APP	7	9	2	7	8	5	4	1	5	1	7	8	64
Economic Operator automatikisht nga QKB	1714	1376	1454	1433	1649	1667	1259	1156	1745	1599	1429	1289	17770
Operator ekonomike te huaj aprovuar nga portali	19	9	11	10	10	8	27	7	5	9	7	1	123
Totali	1730	1394	1477	1450	1667	1680	1290	1164	1755	1609	1443	1298	17957

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i Operatorëve Ekonomikë të rinj të Sistemit të Prokurimit Elektronik, sipas Muajve:

Grafiku 50



Më poshtë paraqitet statusi i operatorëve ekonomik në Sistemin e Prokurimit Elektronik:

Tabela 121

Statusi i Operatorëve ekonomikë për vitin 2021	Numri
Operatorë ekonomikë aktivë	245864
Operatorë ekonomike me statusin të përjashtuar	24
Operatorë ekonomikë joaktivë QKB	41531

12.2.4 STATISTIKA TË TJERA NË LIDHJE ME PËRDORIMIN E SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK

Në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për vitin 2021 në total kemi 384,112,855 klikime (krahasuar me vitin 2020 kemi më pak klikime), 303,903,940 shikime të faqes së internetit dhe 2,480,401 vizitorë.




12.2.4.1 AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS KLIKIMEVE, SHIKIMEVE DHE VIZITORËVE

Tabela 122


Përdorimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik	2020	2021
Klikimet Total	541,984,976	384,112,855
Klikimet sipas Vizitor	541,321,636	383,262,478
Mesatarja Klikimet ne dite	1,480,833	1,046,629
Mesatarja Klikimet per Vizitor	213.93	154.52
Shikimet e faqes Total	450,921,097	303,903,940
Mesatarja e Shikimeve te faqes ne dite	1,232,024	828,076
Mesatarja e Shikimevetefaques per Visitor	178	122.52
Total Visitors	2,530,333	2,480,401
Mesatarja Visitors per Day	6,913	6,758
Total Unique IPs	116,004	121,177

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet shpërndarja e klikimeve, dhe vizitorëve për vitin 2021.

Grafiku 51



Grafiku 52



Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është gjatë periudhës Mars-Prill dhe Tetor- Nentor.

12.2.4.2 AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS KLIKIMEVE, SHIKIMEVE DHE VIZITORËVE SIPAS 24 ORËVE.


Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohet shpërndarja e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas 24 orëve:

Tabela 123

Shpërndarja e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas 24 orëve 2020			
Orët	Hits	Page View	Visitors
00:00 - 00:59	3,642,793	2,756,073	19,054
01:00 - 01:59	3,170,277	2,399,895	65,506
02:00 - 02:59	2,970,099	2,251,399	10,848
03:00 - 03:59	2,976,670	2,263,363	26,362
04:00 - 04:59	2,965,039	2,244,046	12,966
05:00 - 05:59	3,193,224	2,397,806	15,592
06:00 - 06:59	4,709,972	3,484,616	39,246
07:00 - 07:59	15,136,254	11,400,564	154,340
08:00 - 08:59	31,251,448	24,285,863	238,210
09:00 - 09:59	39,677,714	31,534,070	228,809
10:00 - 10:59	40,333,647	32,430,926	208,327
11:00 - 11:59	37,957,624	30,746,769	193,705
12:00 - 12:59	35,923,416	29,159,456	200,812
13:00 - 13:59	34,480,488	27,995,648	179,866
14:00 - 14:59	32,241,223	26,154,130	163,239
15:00 - 15:59	25,448,810	20,533,971	136,594
16:00 - 16:59	15,957,133	12,653,158	107,081
17:00 - 17:59	10,610,491	8,189,624	93,339
18:00 - 18:59	8,742,566	6,615,785	84,932
19:00 - 19:59	7,988,783	5,967,279	80,302
20:00 - 20:59	7,471,333	5,548,554	75,603
21:00 - 21:59	6,823,394	5,068,669	64,422
22:00 - 22:59	5,825,396	4,350,707	49,215
23:00 - 23:59	4,615,061	3,471,569	32,031
Total	384,112,855	303,903,940	2,480,401



Grafiku 53



Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, vërehet aktivitet i përdoruesve përgjatë 24 orëve dhe piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është gjatë orarit 08:00-15:00.


12.2.4.3 AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS KLIKIMEVE, SHIKIMEVE DHE VIZITORËVE SIPAS DITËVE TË JAVËS.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohet shpërndarja e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas ditëve të javës:

Tabela 124

Aktiviteti sipas ditëve të javës 2021			
Ditë	Hits	Page View	Visitors
E Hënë	14,238,203	10,344,694	122,456
E Martë	68,374,863	53,989,826	430,976
E Mërkurë	70,789,123	56,307,931	442,341
E Enjte	72,949,652	58,174,165	456,523
E Premte	71,134,874	56,645,145	442,878
E Shtunë	63,727,299	50,714,813	409,788
E Diel	22,898,841	17,727,366	175,439
Total	384,112,855	303,903,940	2,480,401

Grafiku 54



Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, gjatë javës është nga e Hëna në të Premte por nuk mungojnë klikimet dhe vizitorët e sistemit edhe gjatë fundjavave.


12.2.4.4 AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS KLIKIMEVE, SHIKIMEVE DHE VIZITORËVE SIPAS MUAJVE TË VITIT.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohet shpërndarja e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas muajve:

Tabela 125

Aktiviteti sipas Muajve të vitit 2021			
Muaji	Hits	Page View	Visitors
Janar	29,064,635	23,322,491	183,773
Shkurt	32,340,719	25,687,861	199,394
Mars	36,730,123	29,026,885	224,331
Prill	33,084,567	26,175,823	206,629
Maj	27,407,307	21,515,156	187,741
Qershor	30,845,469	24,419,686	207,761
Korrik	28,536,419	22,462,381	204,058
Gusht	25,050,880	19,571,370	185,937
Shtator	29,822,199	23,448,712	198,233
Tetor	37,511,558	29,733,878	227,957
Nentor	36,600,157	29,242,361	222,406
Dhjetor	35,105,385	27,643,810	220,885
Total	384,112,855	303,903,940	2,480,401

Grafiku 55



Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, piku i shpërndarjes së klikimeve dhe vizitorëve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është periudha Shkurt-Mars dhe më pas periudha Tetor – Nëntor.



12.2.4.5 AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS NDËRFAQEVE MË TË KLIKUARA NË PORTALIN E APP.


Tabela dhe Grafikët e mëposhtëm pasqyrojnë ndërfaqet më të kërkuara në internet për aksesimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik:

Tabela 126

Ndërfaqet më të kërkuara në internet	Visitors
http://www.app.gov.al/	1,516,955
http://www.app.gov.al/ ASP.Net/System/Notify/ Service.aspx/Check/	221,712
http://www.app.gov.al/ e-prokurim/	125,860
http://www.app.gov.al/ ASP.Net/System/PortalService.aspx/ Ping/	103,320
http://www.app.gov.al/ ASP.Net/System/ScriptModuleService.aspx/ ResolveTabHandler/	93,244
http://www.app.gov.al/ GetData/DownloadDocument/	47,876
http://www.app.gov.al/ umbraco/RenderMvc/	32,680
http://www.app.gov.al/ njoftimi-i-kontratës-së-shpallur/	32,608
http://www.app.gov.al/ Api/notice/	28,022
http://www.app.gov.al/ bundles/master/	26,861
http://www.app.gov.al/ GetData/DownloadDoc/	18,513
http://www.app.gov.al/ të-tjera/arkiva/arkiva-e-buletinit-të-prokurimit-publik/	17,131
http://www.app.gov.al/ prokurimet-me-vlere-te-vogel/	16,574
http://www.app.gov.al/ legjislacioni/prokurimi-publik/ ligji/	11,772
http://www.app.gov.al/ njoftimi-i-fituesit/	10,200
http://www.app.gov.al/ legjislacioni/prokurimi-publik/ udhëzime/	6,802
http://www.app.gov.al/ të-tjera/arkiva/arkiva-e-buletinit-të-prokurimit-publik/ arkiva-e-buletinit-te-prokurimit-publik-2021/	6,635
http://www.app.gov.al/ ep/2016_Arkiva_e_Buletineve.aspx	6,202
http://www.app.gov.al/ legjislacioni/prokurimi-publik/vkm/	5,984
http://www.app.gov.al/ regjistri-i-parashikimeve/	5,679
http://www.app.gov.al/ njoftime/njoftime-2021/	3,776
http://www.app.gov.al/ legjislacioni/prokurimi-publik/ dokumentet-standarte-të-tenderit/	3,223
http://www.app.gov.al/ bundles/masterjs/	2,822
http://www.app.gov.al/ njoftime/	2,700
http://www.app.gov.al/ të-tjera/trajtime/pyetje-të-shpeshta/	2,491
http://www.app.gov.al/ contract-notice/	2,469
http://www.app.gov.al/ gabim-i-përgjithshëm/	2,403
http://www.app.gov.al/ ASP.Net/FM/DataViewer/ ScriptModuleService.aspx/ Navigator_Content/	2,228
http://www.app.gov.al/ home/	2,224
http://www.app.gov.al/ njoftime/njoftime-2020/	1,761
http://www.app.gov.al/ e-procurement/	1,754
http://www.app.gov.al/ bundles/homejs/	1,736

http://www.app.gov.al/ të-tjera/arkiva/arkiva-e-buletinit-të-prokurimit-publik/ arkiva-e-buletinit-te-prokurimit-publik-2020/	1,635
http://www.app.gov.al/ bundles/masterS/	1,557
http://www.app.gov.al/ legjislacioni/koncesionetppp/ ligji/	1,530
http://www.app.gov.al/ të-tjera/kontakte/	1,467
http://www.app.gov.al/ ASP.Net/FM/DataViewer/ ScriptModuleService.aspx/ ResolveHandler/	1,348
http://www.app.gov.al/ ASP.Net/System/Component.aspx	1,281
http://www.app.gov.al/ ErrorHandler.html	1,231
http://www.app.gov.al/ njoftimi-i-lidhjes-së-kontratës/	1,212
http://www.app.gov.al/ regjistri-i-realizimeve/	1,202
http://www.app.gov.al/ legjislacioni/prokurimi-publik/ sjellje-në-vëmendje-të-ak/	1,147
http://www.app.gov.al/ bundles/searchNoti/	1,051
http://www.app.gov.al/ të-tjera/arkiva/manualet-e-prokurimit/	1,037
http://www.app.gov.al/ ep/ContractNoticeSV.aspx	1,009
http://www.app.gov.al/ EconomicOperatorAccount/ EconomicOperatorAccount.svc/ EconomicOperatorAccount/	938
http://www.app.gov.al/ getdata/downloaddoc/	933
http://www.app.gov.al/ ep/default.aspx	930
http://www.app.gov.al/ ASP.Net/FM/DataViewer/ DataService.aspx/Navigator_Generate/	904
http://www.app.gov.al/ ASP.Net/FM/DataViewer/ Profile/CountService.aspx/Get/	880

Grafiku 56





Grafiku 57



Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, interesi kryesor është tek ndërfaqja e logimit në sistemin e prokurimit elektronik, arkiva e buletineve të prokurimit publik, VKM, Njoftim të kontratave të shpallura etj.


12.2.4.6 AKTIVITETI I PËRDORUESVE SIPAS FJALËVE KYÇ MË TË PËRDORURA PËR KËRKIMIN E PORTALIT TË APP.

Tabela dhe Grafiku i mëposhtëm pasqyrojnë fjalët e përdorura më shpesh për të kërkuar në internet portalin e APP dhe Sistemin e Prokurimit Elektronik:

Tabela 127

Shprehjet/fjalët kyç	Visitors
app	114
app.gov.al	85
prokurimi elektronik	60
seksioni i operatorit ekonomik	44
agjencia e prokurimit publik	31
eprokurimi	16
www.app.gov.al	16
buletini publik	10
prokurimi elektronik shqiperi	9
sesioni i autoritetit kontraktor	6
app	114
app.gov.al	85
prokurimi elektronik	60
seksioni i operatorit ekonomik	44
agjencia e prokurimit publik	31
eprokurimi	16
www.app.gov.al	16
buletini publik	10
prokurimi elektronik shqiperi	9
sesioni i autoritetit kontraktor	6

Grafiku 58



12.2.4.7 AKSESIMI I SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK SIPAS SHFLETUESVE DHE SISTEMEVE OPERATIVE.

Tabela dhe Grafiku i mëposhtëm pasqyron aksesimin e Sistemit e Prokurimit Elektronik sipas shfletuesve të kërkimit:


Tabela 128

Browser	Hits	Visitors	% of Total Visitors
Google Chrome	307,385,951	1,908,749	72.01%
Mobile Safari	8,137,424	259,266	9.78%
Firefox	23,585,144	129,552	4.89%
Microsoft Edge	13,589,953	99,192	3.74%
Internet Explorer	5,869,969	38,861	1.47%
Opera	3,166,177	27,896	1.05%
Others	4,342,864	26,724	1.01%
Safari	1,134,437	25,029	0.94%
cortex/1.0	8,268	8,060	0.30%
Subtotal	380,094,159	2,591,341	97.77%
Total	383,262,478	2,650,550	100.00%

Sic shihet nga të dhënat e mësipërme Sistemi i Prokurimit Elektronik, aksesohet dhe funksionon normalisht nga të gjitha llojet e shfletuesve si GoogleChrome, MozillaFirefox, etj. Gjithashtu, vërehet se GoogleChrome mbetet shfletuesi më i përdorur për aksesimin e sistemit të prokurimit.




Grafiku 59



Më poshtë paraqitet aksesimi javor i sistemi të prokurimit elektronik nga versionet e internet explorer dhe microsoft edge.

Grafiku 60



12.2.4.8 AKSESIMI I SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK SIPAS SISTEMEVE OPERATIVE DHE LLOJIT TË PAJISJEVE MË TË PËRDORURA NGA PËRDORUESIT

Tabela dhe Grafiku i mëposhtëm pasqyrojnë aksesimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik sipas sistemeve operative të përdorura nga përdoruesit:

Tabela 129

Hits	Hits	Visitors	% of Total Visitors
Windows 10	196,161,692	954,938	38.50%
Windows 7	131,502,364	645,697	26.03%
Android OS	12,103,353	375,697	15.15%
iPhone	9,751,101	298,157	12.02%
Others	5,077,710	73,468	2.96%
Mac OS	2,967,380	47,643	1.92%
Windows 8.1	4,627,609	30,071	1.21%
Windows XP	3,302,119	24,656	0.99%
Linux	4,006,584	17,979	0.72%
Windows 8	1,536,395	6,667	0.27%
Chrome OS	12,105,382	1,685	0.07%
iPad	68,530	1,583	0.06%
Windows Vista	38,366	1,408	0.06%
Total	383,262,478	2,480,401	100.00%

Grafiku 61



Më poshtë paraqitet aksesimi i sistemit të prokurimit elektronik sipas sistemeve operative që përdorin përdoruesit e SPE.



Grafiku 62




Tabela dhe Grafiku i mëposhtëm pasqyron aksesimin Sistemit e Prokurimit Elektronik sipas llojeve të pajisjeve të përdorura nga përdoruesit:

Tabela 130

Device Type	Hits	Visitors	% of Total Visitors
Desktop	361,333,876	1,804,773	72.76%
Mobile	21,381,357	651,244	26.26%
Tablet	547,245	24,384	0.98%
Total	383,262,478	2,480,401	100.00%


Grafiku 63



Sistemi i prokurimit elektronik mund të aksesohet nga çdo pajisje elektronike duke iu lehtësuar punën përdoruesve të saj si dhe mundësuar aksesimin në çdo kohë dhe në çdo moment ku ndodhen.

Më poshtë paraqitet aksesimi javor i sistemi te prokurimit elektronik sipas llojeve të pajisjeve që përdorin përdoruesit e SPE.

Grafiku 64




Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, Sistemi i Prokurimit Elektronik, më së shumti aksesohet nga pajisjet kompjuterike (desktop) si dhe nga pajisjet mobile.

12.2.4.9 PËRDORIMI I APLIKACIONIT MOBILE

Përdorimi i aplikacionit mobile për platformat kryesore iOS dhe Android dhe mundësimi i ofertimit për procedurat me blerje të vogël me anë të tij për operatorët ekonomikë, rezulton se është rritur gjatë vitit 2021. Konkretisht, më poshtë është pasqyruar Aktiviteti i përdoruesve të aplikacionit sipas muajve.


Grafiku 65





Sikurse rezulton, nga grafiku i mësipërm gjatë vitit 2021, periudha ku ka gjetur përdorim më të madh aplikacioni është muaji Janar, Shkurt, Prill dhe Dhjetor, pasi gjatë kësaj kohe autoritetet kontraktore kanë shpallje më së shumti procedura prokurimi me vlerë të vogël.

Grafiku 66



13. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCËS

13.1 MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Gjatë vitit 2021, APP e ka ushtruar veprimtarinë e saj nëpërmjet një strukture me 3(tre) drejtori dhe 1(një) sektor në varësi direkte të Drejtorit të Përgjithshëm, bazuar në Urdhrin Nr. 54, datë 15.03.2019 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik”, konkretisht (i) Drejtoria Juridike, e Verifikimit dhe Integritimit me 3 (tre) sektorë: Sektori Juridik, Sektori i Verifikimit të Procedurave dhe Sektori Integritimit, (ii) Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit me 2 (dy) sektorë: Sektori i Koordinimit dhe Sektori i Monitorimit të Kontratave, (iii) Drejtoria e Administrimit të të Dhënave dhe Publikimit me 2 (dy) sektorë: Sektori i Administrimit të të Dhënave dhe Statistikës dhe Sektori i Publikimit, si dhe (iv) Sektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore.

Numri total i punonjësve është 44. Gjithashtu, vijim të Udhrit Nr. 149, datë 28.12.2021 të Kryeministrit është miruar struktura dhe organika e re e institucionit të APP.

13.2 AUTORITETI PËRGJEGJËS PER KONFLIKTIN E INTERESIT

Gjatë vitit 2021, në Agjencinë e Prokurimit Publik, bazuar në Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të nëpunësve publikë” dhe Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave gjatë ushtrimit të funksioneve publike”, kanë pasur detyrimin për deklarimin e interesave private periodike/vjetore për vitin 2020, 4 punonjës të APP në pozicionet si vijon (i) Drejtor i Përgjithshëm, (ii) Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të të Dhënave dhe Publikimit, (iii) Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit dhe Monitorimit, dhe (iv) Drejtor i Drejtorisë Juridike, të Verifikimit dhe Integritimit.

Të gjithës subjektet e mësipërme përgjegjëse kanë plotësuar dhe dorëzuar brenda afateve *Deklaratën e Interesave Private/Periodike* pranë Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave përkatësisht:

Sa i takon identifikimit dhe regjistrimit të rasteve të konfliktit të interesave, gjatë vitit 2021 nuk janë regjistruar raste të tilla në APP.

13.3 KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në kuadër të detyrimit ligjor që rrjedh nga Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dhe në funksion të informimit të publikut, APP u ka kthyer përgjigje, brenda afateve të parashikuara nga legjislati në fuqi, kërkesave të shumta për informacion të qytetarëve, të paraqitura në formë shkresore ose në formë elektronike, në varësi të përzgjedhjes që kanë bërë këta të fundit.

Gjatë vitit 2021, janë trajtuar 20 kërkesa për informacion drejtuar Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, duke përcjellë informacionin e kërkuar, elektronikisht apo në rrugë shkresore. Në një vështrim krahasimor me vitin 2020, ku APP ka marrë në shqyrtim 22 kërkesa për informim, rezulton se ka një ulje të vogël të numrit të kërkesave në kuadër të të drejtës së informimit.

Pjesa më e madhe e kërkesave për të drejtën e informimit të paraqitura pranë APP, kanë qenë të iniciuara nga gazetarë apo media, por vihet re edhe një rritje e numrit të kërkesave të paraqitura nga individët (persona fizikë). Konkretisht, nga 20 kërkesa të paraqitura pranë APP për periudhën Janar-Dhjetor 2021, 12 prej tyre janë kërkesa të paraqitura nga media apo gazetarë dhe 8 kërkesa janë paraqitur nga individët (persona fizikë). Kërkesa e vazhdueshme për informacion është një tregues pozitiv, që ka të bëjë me ndërgjegjësimin lidhur me efektivitetin e ligjit për të drejtën e informimit.

Gjatë vitit 2021, nuk i është kufizuar apo refuzuar dhënia e informacionit ndonjë subjekti të caktuar.

Në zbatim të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, APP mban dhe bën publik Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen zyrtare të APP.



Në mbështetje të transparencës, me qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion publik, APP ka vijuar punën për përmirësimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesave për të drejtën e informimit, duke bërë të mundur që informacioni i kërkuar, të bëhet i disponueshëm në mënyrën më praktike të mundshme për të gjithë subjektet e interesuar.

13.4 AKTIVITETET NË DREJTIM TË FUQIZIMIT TË KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE TË STAFIT TË APP DHE SPECIALISTËVE TË PROKURIMIT PUBLIK PRANË AUTORITETEVE KONTRAKTORE

13.4.1 PJESËMARRJA E STAFIT TË APP NË AKTIVITETE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

Në kuadër të procesit të Integritetit dhe prioriteve mbi përmirësimin e sistemit të prokurimit në Shqipëri në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe europiane, APP është bërë pjesë e një sërë takimesh dhe workshopesh të organizuara nga organizma dhe institucione të ndryshme vendase dhe të huaja pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Tabela 131

Nr	Tema	Organizator	Data	Drejtori/Sektor	Nr. pjesëmarrjes
1	Bazat e Tregut Evropian	ASPA	20.01.2021	Sektori i Integritetit	1
2	Green Public Procurement-New opportunity for Ukraine	Banka Botërore	04.02.2021	Sektori i Integritetit Sektori i Koordinimit	3
3	Addressing National Security Risks in International Transactions	Departamenti Amerikan I Shtetit	04.03.2021 05.03.2021	Sektori i Integritetit	2
4	Dealing with fraud and infringements during pre- and post- conclusion of the public procurement contract with the recommendation report.	EU Twinning	8.03.2021 12.03.2021	Sektori i Integritetit Sektori i Koordinimit	2
5	Post COVID-19 Risk Management	SIGMA/OECD	10.03.2021	Sektori i Integritetit	1
6	Support to the EU Integration process of Albania)	Projekti SEI	6.05.2021	Sektori i Integritetit	1
7	Forum i Rajonal i Ohrit	UNODC	21.06.2021- 23.06.2021	Sektori i Integritetit	1
8	EU Acquis in Procurement Law Area	EURALIUS	05.07.2021- 06.07.2021	Sektori i Integritetit	2
8	Towards EU accession negotiations: preparing for bilateral screening	Projekti SEI	08.07.2021	Sektori i Integritetit	2
9	Kuadri ligjor e strategjik dhe udhëzimet e Komisionit Evropian IPA III	ASPA	27.07.2021	Sektori i Integritetit	1

9	Procedurat e prokurimit të lidhura me rastet e fatkeqesive natyrore	Banka Botërore	29.09.2021	Sektori i Integritimit	2
10	Aplikimi i kriterëve për prokurimin e gjelbër në Shqipëri (Green Procurement)	Banka Botërore	29.09.2021	Sektori i Integritimit Sektori i Monitorimit të Kontratave	3
11	Për prioritet në harmonizimin e ligjit të prokurimit	Projekti SEI	04.11.2021	Sektori i Integritimit	1
12	Ndryshimet që sjell ligji i ri i prokurimit	SIGMA/OECD KLSH	04.11.2021.	Sektori i Integritimit Sektori i Koordinimit	2
13	Ambasadës së Francës në Shqipëri dhe Shkolles Franceze të Administratës (ENA) u zhvillua “Zbulimi i mashtrimit në tenderat publike”	Ambasada e Francës në Shqipëri dhe Shkolla Franceze të Administratës (ENA)	02.12.2021 03.12.2021	Sektori i Integritimit Sektori i Koordinimit Sektori i Monitorimit të Kontratave	4
14	“SME Policy Index 2022: Western Balkans and Turkey”	OECD	06.12.2021	Sektori i Integritimit	2
15	“Reformat e Mirëqeverisjes dhe Administrimit Publik”	SIGMA	10.12.2021	Sektori i Integritimit	2
16	“Law approximation in the Albanian context “	Projekti SEI	13.12.2021	Sektori i Integritimit	1
17	“Climate Responsive Public Financial Management Framework Clinics”	Banka Botërore	14.12.2021	Sektori i Integritimit	2
18	“Mainstreaming strategic public procurement to advance regional development”	OECD	15.12.2021	Sektori i Integritimit	1
18	“Managing Corruption Risks on Public Procurement and Contract Execution in the Western Balkans and Turkey”	Këshilli i Europës	15.12.2021 17.12.2021	Sektori i Integritimit	2

Në kuadër të aktiviteteve të mësipërme kanë marrë pjesë 18 nëpunës civilë nga APP, përkatësisht 3(tre) nga Sektori i Financës dhe Burimeve Njerëzore, 8(tetë) nga Sektori i Verifikimit të Procedurave, 2(dy) nga Sektori i Administrimit të Dënave dhe Statistikës, 2(dy) nga Sektori i Integritimit, 2(dy) nga Sektori Juridik, 1(një) nga Sektori Publikimit për 18 tema të ndryshme.



13.4.2 TRAJNIMET PËR LEGJISLACIONIN E PROKURIMIT PUBLIK

APP bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me ASPA me qëllim sigurimin e trajnimit të punonjësve të autoriteteve kontraktore mbi legjislacionin e prokurimit.

Ndërkohë, me hyrjen në fuqi të legjislacionit të ri të prokurimit, përveç ASPA-s, APP ka bashkëpunuar edhe me OSBE për të organizuar sesione informuese në lidhje me risitë e legjislacionit të ri të prokurimit.

Duke pasur parasysh që ligji i ri ka hyrë në fuqi në 31 mars 2021 dhe është bërë i zbatueshëm nga muaji qershor 2021, në këtë seksion do të paraqiten edhe të dhëna që lidhen me trajnimin e punonjësve nga ASPA sipas moduleve të trajnimit mbi legjislacionin e mëparshëm të prokurimit.

Konkretisht, tabela e mëposhtme paraqet të dhënat në lidhje me trajnimet e organizuara nga ASPA për vitin 2021:

Tabela 132

	Moduli	Autoritete Kontraktore	Nr. Pjesëmarrësve				Gjinia	
			Nëpunës civilë		Kod Pune		Mashkull	Femër
1	Risitë e legjislacionit të ri të Prokurimit Publik	Qendor Vendor Të Pavarur	439	Totali 890	61	Totali 187	290	114
			223		64		272	97
			228		62		225	79
2	Prokurimi Publik (I)	Qendor Vendor Të Pavarur	284	Totali 465	13		355	123
Totale			1355		200		1142	413
1555								

Sikurse vërehet nga tabela për periudhën Janar-Dhjetor 2021 janë regjistruar 1555 pjesëmarrës, nga 214 autoritete apo ente kontraktore, nga të cilët 1077 janë trajnuar në lidhje me risitë e legjislacionit të ri të prokurimit përfshirë ndryshimet në sistemin e prokurimit elektronik dhe 478 kanë qenë pjesëmarrës në trajnim mbi prokurimin publik përpara hyrjes në fuqi të legjislacionit të ri.

Në trajnimet e organizuara kanë marrë pjesë 1355 nëpunës civilë dhe 200 punonjës me Kod Pune nga të cilët 413 janë femra dhe 1142 meshkuj.

Në kuadër të legjislacionit të ri të prokurimit publik janë organizuar 12 sesione informuese online për autoritetet dhe entet kontraktore në bashkëpunim me prezencën e OSBE në Tiranë, kanë marrë pjesë 203 institucione qendrore, vendore, të pavarura dhe 404 pjesëmarrës.

Sikurse tregohet nga tabela e mëposhtme në total janë trajnuar 1481 punonjës të autoriteteve/enteteve kontraktore në lidhje me risitë e legjislacionit të ri të prokurimit.

Tabela 133

Risitë e legjislacionit të ri të Prokurimit Publik	
Institucioni organizues	Numri i pjesëmarrësve
APP+ASPA	1077
APP+OSBE	404
Totali	1481

Po kështu, në bashkëpunim me Bashkimin Tregtar të Shqipërisë është organizuar 1 sesion online informues me 17 përfaqësues nga 9 subjekte biznesi.

13.4.3 REALIZIMI I FONDEVE BUXHETORE

Realizimi i fondeve buxhetore si 12/mujor për vitin 2021 paraqitet si me poshtë:

Tabela 134

Nr.	Artikujt	Plani vjetor	Plani 12/mujor Lekë	Fakti 12/mujor Lekë	Diferenca si 12/mujor Lekë	Realizimi (%)	Numri i punonjësve	
							plan	fakt
1	600	41 400 000	41 400 000	39,761,948	1,638,052	96.04		
2	601	7,200,000	7 200 000	6,568,170	631,830	91,22		
3	602	8,080,000	8,080,000	3,294,002	4,785,998	40.76		
4	606	220,000	220 000	94,093	125,907	42.76		
5	231	1,000,000	1,000,000	38,000	962,000	3.8		
Totali		57,900,000	57,900,000	49,756,213	8,143,787	85.93	44	35

Nisur nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se si 12/mujor realizimi i shpenzimeve në total, kundrejt planit 57,900,000 lekë, është 49,756,213 lekë ose **85.93 %**.

Numri i punonjësve në organikë i miratuar me ligjin e buxhetit për vitin 2021 është 44 punonjës, dhe fakti në fund të vitit është 35 punonjës. Gjatë vitit numri i punonjësve në organikë ka pësuar ndryshime për shkak të largimeve, nëpërmjet procedurave të pezullimit të statusit dhe lirimit nga shërbimi civil.

13.4.4 ANALIZA E ZËRAVE TË SHPENZIMEVE .

- Për zërin Paga Personeli, artikulli 600, realizimi i planit si 12 mujor është 39,761,948 lekë nga 41,400,000 lekë në plan, ose 96.04 %.
- Në zërin sigurime shoqërore artikull 601, realizimi si 12 mujor është 6,568,170 lekë nga 7,200,000 lekë në plan, ose 91.22 %.
- Në zërin “Shpenzime operative” artikull 602, realizimi i planit si 12-mujor është 3,294,002, lekë nga 8,080,000 lekë të planifikuar ose 40.76 %, me mosrealizim prej 4,785,998 lekë ose 59.24%.
- Në zërin “Trasferime të tjera” artikull 606, realizimi i planit si 12 mujor është 94,093 lekë nga 220,000 lekë të planifikuara, ose 42.76%
- Në zërin “Shpenzime për investime” artikull 231, realizimi i planit si 12-mujor është 38,000 lekë nga 1,000,000 lekë të planifikuara ose 3.8%.



14. PRIORITETET E AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2022

Me gjithë arritjet e pasqyruara në këtë dokument, APP vazhdon të mbetet e fokusuar në punën e saj në drejtim të garantimit të një sistemi prokurimi eficient dhe të qendrueshëm sikurse parashtruar edhe në Strategjinë e Prokurimit Publik.

Në këtë kuadër, objektivat kryesore për vitin 2022 paraqiten si më poshtë:

1. Nxitja e mirëzbatimit të legjislacionit të ri të prokurimit nga ana e autoriteteve/enteteve kontraktore:

Në këtë kuadër APP do të vazhdojë punën e saj duke ofruar asistencë të vazhdueshme për autoritetet/entete kontraktore, duke nxjerrë rekomandime dhe udhëzime që u shërbejnë atyre për të kuptuar dhe zbatuar më mirë dispozitat ligjore si dhe duke monitoruar ex-post ligjshmërinë e procedurave, sipas kompetencave ligjore përkatëse.

2. Nxitja e mirëzbatimit të kontratave nga ana e autoriteteve/enteteve kontraktore:

Në mbështetje të kompetencave të reja të dhëna në ligjin i ri dhe të udhëzimeve të nxjerra gjatë vitit 2021 për autoritetet/entete kontraktore APP do të intensifikojë punën për monitorimin e zbatimit të kontratave duke nxitur autoritetet/entete kontraktore për të përgatitur dhe dërguar në kohë planine zbatimit të kontratës dhe raportet e realizimit të kontratës.

3. Përmirësimi i sistemit elektronik të prokurimit;

Me qëllim garantimin e funksionimit 24 orë të sistemit të prokurimit elektronik, APP bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me AKSHI-n për të siguruar përmirësimet e nevojshme teknike në përpunime me ndryshimet ligjore apo në vijim të problematikave të hasura në praktikë nga përdoruesit.

4. Bashkëpunimi me Shkollën e Administratës Publike për ngritjen e kapaciteteve të Autoriteteve Kontraktore;

Bashkëpunimi me ASPA dhe me DAP është shumë i rëndësishëm edhe në kuadër të profesionalizimit të prokurimit në Shqipëri që është një nga objektivat kryesore në fushën e prokurimit.

5. Koordinimi dhe monitorimi i aktiviteteve në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik;

Koordinimi i vazhdueshëm me institucionet kontribuese dhe bashkëpunuese për SKPP është një nga objektivat kryesore të APP me qëllim garantimin e realizimit të aktiviteteve dhe objektivave të parashikuara me qëllim krijimin e një mjedisi eficient dhe të qendrueshëm prokurimi në Shqipëri.

6. Koordinimi i aktiviteteve në kuadër të procesit të integritetit evropian;

Përcaktimi i Kapitullit 5 "Prokurimi Publik" si një nga kapitujt kryesorë për hapjen e negociatave dhe vijimin me sukses të tyre shton përgjegjësinë e APP-së si institucion drejtues i këtij kapitulli për të punuar intensivisht në drejtim të përgatitjes për zhvillimin e procesit negociator në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha institucionet anëtare të GNPIE për këtë kapitull.